

Botuesit e e veprës së G. G. Márquez nga e gjithë bota u mbledhën në Panairin e Librit të Frankfurtit, stenda e Penguin Random House ku agjentja e autorit prezantoi romanin e lënë në dorëshkrim prej tij, i cili do të botohet në të gjitha gjuhët (përfshirë edhe shqipen, nga “Onufri”, të përkthyer nga Mira Meksi) me datë 6 mars 2024.

Në Frankfurt, ku në Panairin e Librit u prezantua romani i lënë në dorëshkrim, i nobelistit Gabriel Garcia Márquez



Nga Andreas Dushi



(fq. 6)

Nëpërmjet letrave dhe shënimeve të arkivit vetjak, në shtëpi, Lenggies (Gjermani)

PORTRET PSIKO-LETRAR I MARTIN CAMAJT

Nga Bashkim Kuçuku

Shkrimtarët në mërgim, ndryshe nga shkrimtarët në atdhe, jetojnë një realitet dhe përjetojnë njëherësh dy realitete, për mjedisin ku janë dhe atdheun. Ndonëse, fillojnë jetë dhe përvojë tjetër, ndjekin a marrin pjesë në dukuri dhe ndodhi të atjeshme, nxënë kulturë, veçanërisht letrare, rrallë ndodh të frymëzohen e të shkruajnë për ato mjedise.



Shkrimtarit të shquar Ismail Kadare iu dha të hënën titulli i Oficerit të Lartë të Legjionit të Nderit, nga Presidenti francez Emmanuel Macron, “për veprat e tij, kurajon e tij për t’u ngritur ndaj një sistemi diktatorial dhe si një mbrojtës i lirisë, një shkrimtar i madh për njerëzimin”.

SHËNIME MBI LIBRAT

Shënime për botimin në arabisht “DAULLJA PREJ LETRE” I BESNIK MUSTAFAJT: NJË PËRKUFIZIM I JETESËS NËN TIRANI

Nga Sumer Shehadeh (fq. 15)

Për librin me tregime “Asgjëja ime” të Laura Olldashit

ANKTHET E KOHËS

QË JETOJMË

Nga Migena Kapllani (fq. 10)

“Peizazhi lingvistik i Tiranës”

i Elsa Skënderi Rakipllarit, botim i Albas

STUDIMI I PARË I PLOTË PËR PEIZAZHIN GJUHËSOR TË TIRANËS

Nga Rrahman Paçarizi (fq. 13)

Romani “Pushteti i kancerözëve” i autorit Kleo Lati

THARJA KULTURORE PREJ REGJIMIT KORRUPTIV

Nga Aleksandër Çipa (fq. 11)

E MARTË 24 TETOR
NË ORËN 18.00, EUROPE HOUSE,
Con altre parole

Bisedë me ANILDA IBRAHIMI (fq. 18)

QASJE TË NDRYSHME
NDAJ RAPORTIT TË
PERSONAZHIT ME REALEN
Nga Floresha Dado (fq. 4)

MILAN KUNDERA
ARTI I TË SHKRUARIT
ROMAN POLIFONIK

Intervistë për Paris Review

Përktheu Granit Zela (fq. 21)



BIBLIOTEKË

Mehmet Kraja (fq. 18)

Rrëfim për Lizën dhe realizmin socialist

Roland Gjoza (fq. 16)

Amerika e grave

Viktor Eftimiu (fq. 19)

Tre musketierët

Shqiponja Axhami (fq. 23)

Baba...

Feride Pappleka (fq. 14)

Buzë detit

Lali Michaeli (fq. 20)

I dashuri im sekret, ti

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Shënime për botimin në italisht të “Diktatori në kryq”

DITËT E FUNDIT E
DIKTATORIT NË LIBRIN
E RI TË MIRA MEKSIT

Nga Anna Latanzi (fq. 8)

Një përkujtimore e paimagjinueshme për Migjenin

LOTËT E OLLGËS,
MOTRËS SË MIGJENIT

Nga Uran Butka (fq. 12)

Një sfond i përgjithshëm

Agjentja e Márquezit, Maria-Pau Roca dërgoi pranë redaksisë së “Onufri”-t lajmin se nobelisti kolumbian kishte shkruar edhe një libër tjetër, *En Agosto Nos Vemos*, i mbetur në dorëshkrim dhe i cili, më në fund do të botohej me dakordësinë e djemve të tij. Nëpërmjet ftesës së mëposhtme, ftohej edhe botuesi shqiptar për të marrë pjesë në konferencën për shtyp ku ky lajm do të jepej për publikun e gjerë dhe bashkë me të, do të prezantohej kopertina që romani do të ketë në botimin spanjoll.

Po atë ditë, kur u konfirmua pjesëmarrja, sollën edhe materialin të cilin e mori menjëherë shkrimtarja dhe përkthyesja Mira Meksi, ndërtuesja më e njohur e urës nëpër të cilën Márquez erdhi dhe vazhdon të vijë në gjuhën tonë. Pasi e lexoi, e lumtur për një tjetër roman të autorit të saj të dashur, mori përsipër përkthimin e tij.

Dhe ne, Enxhi, drejtoresha e “Onufri”-t dhe unë, redaktori përgjegjës i “ExLibris” vajtëm në ngjarjen më të bukur letrare ku ndonjëherë kishim pasur mundësinë të ishim, ditën e mërkurë me datë 18 tetor, 2023.

Por pak më përpara

Në ceremoninë e çeljes së panairit, mes të tjerëve foli edhe filozofi i njohur sloven, Slavoj Žižek, fjala e të cilit u prit si s’kishte më keq, me disa prej të pranishëmve që lanë sallën. Vështrimi i njëanshëm i asaj çfarë po ndodh në Lindjen e Mesme dhe vendimi për të shtyrë ndarjen e një çmimi të rëndësishëm letrar për autoren palestineze Adania Shibli, u cilësua prej tij, me tone shumë të ashpra, si një formë e *cancel culture*. Kjo shkaktoi zemërim dhe fjala iu lexua si manifest për relativizimin e terrorizmit. Por kaq ishte, konflikti në Lindjen e Mesme nuk e ndikoi më panairin, të paktën jo në optikën time, paçka se mediat që e mbulojnë ngjarjen, si për shembull DW, nuk vonuan të shkruanin për të kundërtën.

Të nesërmen, ditën e mërkurë, në një prej sallave kryesore të ambienteve ku panairi mbahet, drejtori ekzekutiv i Penguin Random House, Nihar Malaviya qe i ftuar në një bisedë me Porter Anderson, kryeredaktor i *Publish Perspectives*, revistë e cila merret vetëm me çështje të industrisë ndërkombëtare të librit. Diskutimi jashtëzakonisht interesant sillte në vëmendje tema të reja, krejt të parrahura e të padëguara në diskutimet e zakonshme që bëhen për librin në vendin tonë. Mes të tjerash, Malaviya tha se periudha e karantinës e rriti ndjeshëm numrin e lexuesve, rritje e cila vijon të ndihet akoma dhe sot, tre vjet pasi e gjitha ka marrë fund. Sipas tij, njerëzit lexojnë sot më shumë se më parë dhe mbi të gjitha, çdo histori ka të drejtë të tregohet dhe çdo lexues ka të drejtë t’u qaset atyre historive. E thënë kjo nga dikush që drejton botuesin e mbi gjashtëmbëdhjetë mijë titujve në vit, nuk mund të shihet si statistikë rastësore. Aq më tepër, në një kontekst politiko-social që në vende të ndryshme, shumë më ndjeshëm në Amerikë, po ndalohen libra të ndryshëm si të papërshtatshëm, diskriminues apo racistë. Lëvizje kjo e grupimeve të ekstremit të majtë që konsiston edhe në rrëzimin e statujave të personave me sjellje raciste e të tjera e të tjera...

Botuesit e Márquez nga e gjithë bota u mblodhën në Panairin e Librit të Frankfurtit, stenda e Penguin Random House ku agjentja e autorit prezantoi romanin e lënë në dorëshkrim prej tij, i cili do të botohet në të gjitha gjuhët (përfshirë edhe shqipen, nga “Onufri”, të përkthyer nga Mira Meksi) **me datë 6 mars 2024**, në datëlindjen e 97 të autorit.

Në Frankfurt, ku në Panairin e Librit u prezantua romani i lënë në dorëshkrim, i nobelistit G.G. Márquez

Nga Andreas Dushi



Penguin
Random House
Grupo Editorial

18/10
12.15h

Stand 5.0 C113

Nuria Cabutí, CEO de PRHGE, se complace en invitarle al brindis para anunciar la portada y la próxima publicación de **En agosto nos vemos**, obra inédita del premio Nobel colombiano **Gabriel García Márquez**.

Nuria Cabutí, CEO of PRHGE, requests the pleasure of your company to raise a glass for the publication of **En agosto nos vemos**, the posthumous novel of **Gabriel García Márquez** and to share the cover and the publication date.

RSVP: carlota.delamo@penguinrandomhouse.com

Po ashtu, interesante ishte edhe udha editoriale që ndjek botuesi më i rëndësishëm i botës: Me mbi 350 *imprint*-e anë e mbanë, drejtori Malaviya tha se secili syresh kishte lirinë e vet editoriale, pasi nuk ndodh që një libër shumë i njohur në një vend, shumë i shitur në një gjuhë të ketë të njëjtin fat edhe në vende apo gjuhë të tjera. Në perspektivën e botuesve shqiptarë, kur vihet përherë në krye *Bestseller Nr#1 në New York Times*, apo *Libri më i shitur në ... vend*, ky mund të konsiderohet si një leksion me vlerë. Po njëllot për lexuesit, që shpesh mund të zhgënjehen nga libra me këto mbitituj... Nuk është faji i tyre, edhe në globalizëm, veçanësitë i dallojnë kulturat e ndryshme.

Shumë bukur u trajtua çështja e të drejtës së autorit kur flasim për *Inteligjencën Artificiale*. IA trajnohet,

mësohet dhe kjo ndodh nëpërmjet librave. Praktikisht, kjo inteligjencë tejçon të dhëna që i ka marrë nga disa tekste paraprake të shkruara. Po mirë, me ç’të drejtë e bën këtë? Me çfarë tagri, sipas cilës kontratë riprodhon pjesë nga to në mënyra nga më të ndryshmet e thujse të pamundura për t’u zbërthyer aq sa të arrihet në zbulimin e teksteve burimore? Por pavarësisht kësaj, sipas Malaviya-s, kur flasim për temën e inteligjencës artificiale, nuk kemi të bëjmë me një diskutim të llojit makineritë përballë njerëzimit, por makinëritë në dobi të njerëzimit. Bota e industrisë, çfarëdolloj industrie qoftë, po punon apo duhet të punojë për ta vënë në zbatim këtë.

Thjeshtësia e CEO-së së Penguin Random House-s, gatishmëria e tij për biseda të shkurtra, mungesa e një shpure shoqëruese që i vente nga pas, lehtësia



për të qëndruar vetëm, në një cep, me celular në dorë teksa të tjerët, kryesisht punonjës të tij në ndonjë prej 350 imprinteve në shtatë kontinente, që jo domosdoshmërisht e njihnin, e gjitha çka e karakterizonte tregonte një lloj kulture të veçantë, larg, shumë larg dëshirës për të qenë në qendër të vëmendjes, dhe tërësisht në përmbushje të misionit kryesor që ka një botues: kthimin e syve, mendjeve dhe zemrave të sa më shumë njerëzve drejt autorit, duke u shmangur vetë sa më larg, sa më fshehurazi për ta bërë këtë punë pa pretendime personale, pra për ta bërë këtë punë mirë.

Në Press Release

Bashkë me Enxhin, ishim më të rinjtë. Një zonjë e moshuar, botuese e Márquez në një gjuhë që nuk e morëm vesh, na pyeti nga ishim. Shqipëria, iu përgjigjëm. “Vërtetë? Sa mirë që të rinjtë punojnë me Márquez-in atje tek ju.” S’di të them nëse kishte të drejtë, por vërtetë u ndjemë pak në siklet, sidomos gjatë takimeve, përshëndetjeve, shkëmbimeve të kartvizitave, Enxhi kryesisht me të tjerë botues, ku diskutohej edhe për autorët shqiptarë, të panjohur në shumicë dërrmuese, dhe theksohej se ishte shumë e vështirë të njiheshin për aq kohë sa nuk përfaqësohen prej një agjenti letrar, koncept inekzistent në Shqipëri. U përpoqëm edhe ne, disi, ta bënim këtë punë, ashtu sikurse dinim, a më mirë sikurse s’dinim, duke parë të tjerët çfarë bënin, por për këtë do të shkruaj në fund, si problem dhe shqetësim, mund të them edhe turp, pse si shqiptarë në atë hapësirë të pafundme me më shumë se katërmijë e pesëqind stenda, ndiheshim jetimë, pa një hapësirë kuq e zi ku të uleshim, dhe po mos të ishte për mikpritjen e stendës së Kosovës, shumë sinqerisht, s’do të kishim ku të pushonim, përveç kafeneve, tamam si shqiptarë që gjithçka synojnë ta bëjnë në kafe.

Para fillimit, punonjës në stendë na ftuan të afroheshim për nga një gotë verë. Pak çaste më pas na u bashkua Maribel Luque, drejtoresha e agjencisë letrare *Carmen Balcells*, agjencia e shkrimtarëve kryesorë të botës hispanike, mes të cilëve edhe gjashtë nobelistë, Gabriel García Márquez, Mario Vargas Llosa, Julio Cortázar, Pablo Neruda, Carlos Fuentes, Álvaro Mutis, Camilo José Cela dhe Miguel Ángel Asturias. Kur Enxhi u prezantua si botuesja e “Onufri”-t, Luque e njohu dhe shprehu kënaqësinë e ndërsjelltë për takimin. Më bëri shumë përshtypje

mirinformimi i saj, menjëherë na pyeti, për t’u siguruar, nëse kishim botuar nëntë libra të Márquez, tha dhe titujt e tyre si dhe nuk e fshehu entuziasmin për takimin e asaj dite.

Drejtoresha e Penguin Random House Grupo Editorial¹, Nuria Cabutí e çeli takimin duke u ndalur për një çast në historinë e gjatë mes Márquez-it dhe *Random House*, histori e cila zë fill këtu e pesëdhjetë e pesë vjet më para, me botimin nga kjo shtëpi botuese të *100 vjet vetmi*. Mandej foli pak për historinë e romanit të ri. Dorëshkrimi, tha, gjendej bashkë me dorëshkrimet e tjera të autorit në arkivin e Universitetit të Teksasit. Pas disa bisedave me djemtë e autorit, Rodrigo dhe Gonzales, vendosën bashkë me agjencinë, *Carmen Balcells Agency*, se tanimë kishte kuptim ta botonin këtë vepër të rëndësishme dhe t’ua mundësonin lexuesve gëzimin e zbulimit të një tjetër libri nga ati i tyre. Ata e kishin rilexuar librin dhe ishin tanimë të bindur se bëhej fjalë për një roman që meritonte të ndahej me të gjithë botën.

Më pas, së bashku me Malaviya-n zbuloi kopertinën e botimit në spanjisht, për t’ia lënë kështu radhën ngritjes së gotave, fotografimit të saj nga gjithë të pranishmit dhe në fund, drejtoreshës së agjencisë, zonjës Luque. Ajo e quajti veprën si një eksplorim i feminitetit, seksualitetit dhe dëshirës, ndjelljes, si një vepër e cila rri shumë mirë në vendin ku përket, mbyllje përfundimtare e udhëtimit letrar të Márquez-it. Prologu, shkruar nga djemtë e tij, Gonzalo dhe Rodrigo, është një homazh për gjuhën poetike të atit të tyre, narrativës mbërthyesë dhe kuptimit të thellë të genies njerëzore që ai arrin nëpërmjet letërsisë së tij.

Dhe kaq, duartrokitje sërish, shprëndahen fletëpalosje me kopertinën e sapozbuluar, jetën e Márquez-it, disa të dhëna për librin dhe emrat e gjithë botuesve në botë, që tanimë kanë marrë të drejtat për këtë libër. Mes tyre, secili nxiton të gjejë veten, edhe Enxhi të gjejë “Onufri”-n, me gëzim për pranimë mes emrave të tjerë, shumë të rëndësishëm në tregun botëror të librit si “Mondadori”, “Knopf”, “Random House” etj..

Mbarojmë gotat, edhe bisedat, përshëndetemi, me kolegë, gazetarë e botues, shumë punonjës të *Penguin*-it dhe ngadalë, shpërndahemi, secili shkon në stendat e shtetit të vet, përveç nesh, sigurisht, e thashë, nuk e kemi një stendë.

Dhe pak më pas

Vizitojmë panairin, ashtu të stërmadh, kemi bërë mbi njëzet mijë hapa, kudo janë stenda të mëdha, korridore me botues privatë që kanë në krye stendën e vendit të vet. Aty të drejtojnë, këtu gjendet kjo apo ajo shtëpi botuese, orientuar drejt këtij apo atij lloj libri, pak më tej janë agjentët e shkrimtarëve, takojmë disa, me të cilët Enxhi bisedon për të drejtat e librave që ka parë qysh më përpara. Po stenda juaj ku është, pyesin në ndonjë rast, kur u mungon, fjala bie, një libër që ne e kërkojmë, libri vjen të dielën, thonë, dhe jua sjellim aty. Në siklet, i themi se do të vijmë vetë ta marrim atë ditë, duke e fshehur disi mungesën e një stende shqiptare, ose i orientojmë te e Kosovës.

1 Për ta qartësuar: Nihar Malaviya është drejtor ekzekutiv i Penguin Random House *worldwide*, pra në të gjithë botën, ndërkohë secili vend ka grupin e vet editorial, ku përfshihen imprints në atë vend dhe në atë gjuhë. Për grupin e botuesve në spanjisht që janë nën ombrellën Penguin Random House, drejtoresha ekzekutive është Nuria Cabutí.

Drejtoresha e Penguin Random House Grupo Editorial, Nuria Cabutí e çeli takimin duke u ndalur për një çast në historinë e gjatë mes Márquez-it dhe *Random House*, histori e cila zë fill këtu e pesëdhjetë e pesë vjet më para, me botimin nga kjo shtëpi botuese të romanit "*100 vjet vetmi*". Mandej foli pak për historinë e romanit të ri. Dorëshkrimi, tha, gjendej bashkë me dorëshkrimet e tjera të autorit në arkivin e Universitetit të Teksasit. Pas disa bisedave me djemtë e autorit, Rodrigo dhe Gonzales, vendosën bashkë me agjencinë, *Carmen Balcells Agency*, se tanimë kishte kuptim ta botonin këtë vepër të rëndësishme dhe t’ua mundësonin lexuesve gëzimin e zbulimit të një tjetër libri nga ati i tyre. Ata e kishin rilexuar librin dhe ishin tanimë të bindur se bëhej fjalë për një roman që meritonte të ndahej me të gjithë botën.

Vendet e vogla, ose me letërsi jo shumë të njohur, nxitojnë të na japin katalogje me autorët e tyre, ku ka një biografi në anglisht, përmbledhje po në anglisht të librave dhe mënyra për t’i kontaktuar. Në shumë raste, po ashtu gjen edhe pjesë të shkurtra të përkthyer, të cilat shërbejnë për të krijuar një ide të përgjithshme. Ndërsa vendet e mëdha, presin, kanë me dhjetra tavolina në hapësirën e tyre, ku ne të tjerët ndihemi të ftuar se mund të ulemi, të flasim, të diskutojmë për çështje nga më të ndryshmet.

Vend i ftuar sivjet si vend mik është Sllovenia. Njëlloj sikurse ishte Shqipëria vend mik në Torino. Por stenda e Sllovenisë nuk mburret me autorë të përkthyer në gjermanisht, nuk i fton gjithë këto autorë të flasin përpara një publiku (e kush është në publik?!), por ndan me agjentët e botuesit ndërkombëtar katalogje, libra, mënyra të llojllojshme për të prezantuar veten, autorët e saj, letërsinë e re që po shkruhet. Stenda e tyre është konceptuar si një zgjua blete, çka ngjalli dhe sarkazmën e Zizek-ut kur tha se ishte budallallëk një stendë e tillë, pasi s’ka shoqëri më diktatoriale se ajo e bletëve, ndaj ky konstrukt i bie ndesh temës së panairit. Por askush s’u zemërua me të, vetëm vunë buzën në gaz dhe ashtu, shumica, e miratoi.

Sigurisht, vendin kryesor aty e ka Drago Jančar, autori më i njohur slloven, por ai shërben si magnet për të treguar se Sllovenia ka letërsi interesante, ka nxjerrë Jančar-in, ejani zbuloni dhe të tjerët.

Më vjen keq pse Shqipëria nuk përfaqësohet zyrtarisht nga institucionet e saja, asnjëherë nuk ka ndodhur, kanë qenë vetëm iniciativa




private të botuesve, për vite me radhë. Tek ecnim në njërën nga sallat, Enxhi tha se këtu e kishte “Onufri” stendën, dhjetë vjet rresht. Vinim si botues të letërsisë shqipe, dhe prezantonim autorët e saj, tha, ashtu sikurse mundeshim. Po një shtëpi botuese, apo dy, tre, pesë, ndonëse asnjëherë nuk kanë qenë kaq shumë, i kanë mundësitë e kufizuara e po ashtu, mund të tejçojnë vetëm një pjesë të shijeve letrare, shkrimtarëve apo letërsisë së vendit të tyre. Atëherë, kush pra do t’i sjellë, përfaqësojë, mbështesë shkrimtarët shqiptarë në ngjarje të atilla?

Sepse shteti, Shqipëria, po, merr pjesë

në panire, por jo në ata me nivele të tilla prezantimi, ku vërtetë mund të bësh shumëçka për letërsinë shqipe. Këtë e them me bindje, sivjet e kam shoqëruar në secilin panair ndërkombëtar ku vendi jonë ka qenë, në Leipzig ku isha i ftuar prej Qendrës së Librit dhe në Torino ku vajta vetë, dhe meqë i vura në dijeni organizatorët se do të shkoja, u realizua një takim bashkë me dy miq e kolegë, Liridonin e Tobiasin, për një antologji në atë gjuhë, pjesë e së cilës jemi me tregime. Dhe kaq.

Këtu në Frankfurt, sheh stenda të stërmëdha, me logot e Qendrave të Librave, Shoqatave të Botuesve, Ministrive të Kulturës nga çdo vend, nga çdo anë, por nuk sheh gjekundi logo të institucioneve shqiptare. Po pse? Pse as sivjet kur në Tiranë erdhi edhe drejtori i Panairit të Frankfurtit, u takova dhe unë me të. Shqiptarët i kanë të shenjta këto gjëra, s’mund të merrnin pjesë qoftë edhe veç për t’i kthyer vizitën mikut?

Gjithë ajo energji e shpenzuar në agorën e letërsisë shqipe për shumëçka tjetër, por jo për këtë... Në shtëpinë e Goethe-s, këtu në Frankfurt, shkrep foto e mëposhtme, dhe m’u kujtua debati për poetin laureat, që mesa di unë, quhet i tillë nga *lari*, *dafina* në standard, me të cilën thuret kurora mbi kokën e tij. Po a ia vlen gjithë ai debat, gjithë ajo prani në media, gjithë ato sulme e kundërsulme, deklarata e kundërdeklara, investim shtetëror dhe sherrues, i lodhshëm, gjithë kjo pra për një gjë të tillë, për një detyrë të tillë me funksion jo dhe aq të qartë? Dhe a ia vlen, a ka kuptim që kjo të marrë më shumë vëmendje e angazhim, kur funksioni pra s’është dhe aq i qartë, sesa prania e



(Vijon në faqen 5)

Interpretimi i kësaj marrëdhënieje, që kur u trajtua teorikisht për herë të parë nga Aris-toteli e në vazhdim nga teoricienë të kohës moderne, dëshmon rëndësinë që ka patur dhe ka kjo çështje në poetika të ndryshme, deri në teoritë që e shkëputën atë si referim të realitetit. Dihet se *kuptimi* në veprën narrative është marrëdhënie midis dy botëve: *botës trilluese* të krijuar nga autori dhe *botës reale*. Kur themi se e përrjetojmë, na pëlqen personazhi, kjo do të thotë se kemi kuptuar raportin metaforik midis këtyre dy botëve, që, gjithashtu, është raport i figurshëm. Problemi më i ndërlikuar është *natyra e marrëdhënies*. A synon figura-personazh të jetë një përballje me realitetin, apo thjesht të na risjellë një aspekt të tij, apo të përcjellë një përshtypje tërësore mbi botën reale? Këto çështje kanë qenë në themel të interpretimit të rolit të personazhit në letërsi, rreth të cilave ka pikëpamje që i kanë bashkuar teoricienët, sikurse ka dhe kuptime që kundërshtojnë njeri tjetrin.

Gjatë rrjedhës letrare të shek XIX mbi-zotëronte parimi estetik sipas të cilit narratori zhvillonte artistikisht shkaku e veprimit të personazhit dhe të rrethanave të këtij veprimi, personazhi konceptohej në rrëfim si shfaqje e qenies sociale. Në këtë shekull personazhi njo-hu një përpunim të jashtëzakonshëm në lidhjen me realitetin, ai u konceptua si promotor në raportet e aksionit, si nxitës dhe faktor për zhvillimin e intrigës. Ai ishte një marrëdhënie 'e hapur' ndaj lexuesit, ishte një 'qenie' e organizuar, që i nënshtrohej lëvizjes, ndryshimit... Më pas, në gjysmën e dytë të shekullit XX, një parim tjetër teorik mbi marrëdhënien e fjalës me realen, mbështet kuptimin e letërsisë si *shenjë* në karakterin arbitrar të saj (Sosyri), jashtë marrëdhënies me objektin e pasqyrimin. Në letërsi nuk synohet të justifikohen, sipas mënyrës realiste, veprimet e personazhit, përkundrazi theksohet arbitrariteti në emër të vërtetësisë së tyre të pjesshme ose të së drejtës për imagjinatë. Në këtë kuptim të ri edhe letërsia reagoi dukshëm: të çliruar nga pushteti i 'reales' romanet moderne nuk u japin rëndësi lëvizjeve të personazheve, as shkaqeve që diktojnë veprimet e tyre. Në vend të heroit vjen 'një qenie pa konture', e papërcaktueshme dhe e pakapshme, një 'unë' anonim... Në qasjen semiologjike personazhi shihet si ekzistencë gjuhësore, dhe, mbi këtë bazë teorike, koncepti strukturalist e zbërthen atë si një krijesë-skemë, duke zbehur iluzionin referencial të tij. Kështu, kish ndodhur që fillim të shek. XX në romanin e letërsive evropiane dhe anglo-amerikane të shfaqej *kriza e personazhit*. Ky aktor i rëndësishëm i prozës konceptohet tashmë ndryshe, në një funksion të veçantë, si në thelbin e strukturës shpirtërore e mendore, të veprimit, të raporteve me mjedisin dhe faktorë të tjerë, ashtu dhe në mënyrat e formësimit të jashtëm të tij. Ky shekull, me ndryshimet e rëndësishme në jetën social-kulturore, solli *metamorfозën e figurës-personazhit*, thelbi i së cilës ishte, siç e karakterizon Ph. Hamon¹, që personazhi bëhet një efekt semantik i shpërndarë; kuptimi i tij mund të nxirret vetëm duke abstraktuar. Ky ndryshim thelbësor e bëri personazhin një dukuri komplekse, në studimin e të cilit mund të kryqëzohen disa disiplina, si: semiologjia, linguistika, psikanaliza, sociologjia...

Në romanin modernist, që u rishfaq në një formë edhe më specifike në romanin post-modernist, siç shkruante N. Sarrot, personazhi shfaqet si 'një qenie pa konture, e papërcaktueshme, e pandjeshme dhe e pakapshme, një 'unë' anonim, që është gjithçka dhe nuk është asgjë'. Veç kësaj, intriga kalon në plan të dytë, personazhi nuk krijon ngjarjet, nuk është gjithnjë subjekt i vullnetshëm dhe me logjikë të brendshme të zhvillimit, siç ndodhte në romanin realist. Përmbysjet raportit i personazhit me realen. Kjo reflektohet drejtpërdrejt edhe në evoluimin e teknikave narrative.

Në romanin shqiptar u ruajt formësimi tradicional, realist i personazhit deri në vitet '80 të shekullit XX, por, ndonëse personazhi mbeti element i rëndësishëm i prozës sonë, nën ndikimin e letërsisë së huaj dhe të rrethanave specifike social-ideore të realitetit shqiptar, sidomos në lirinë e krijimit, në disa romane të dhjetëvjeçarëve të fundit u shfaq një personazh i pazakontë, dhe raporte të tjera, në vështrim të jashtëm, shfaqen me realen. Zhvillimi i letërsisë sonë ka dëshmuar qasje të ndryshme lidhur me raportin ëndërr (trillim)-realitet.

1 Roland Barthes, Philippe Hamon, Wolfgang Kayser, Wayne C. Booth: *Poétique du récit*, 1977.



QASJE TË NDRYSHME NDAJ RAPORTIT TË PERSONAZHIT ME REALEN

(Pjesë nga studimi në proces)

Nga Floresha Dado

Kjo marrëdhënie herë është e dukshme, personazhi e deklaron mbas një situatë përjetimi të jashtëzakonshëm, herë është e brendshme, e shkrirë me rrëfimin gati të padallueshëm. E gjejmë këtë dukuri poetike te Z. Çela ('*Gjysma e Xhokondës*'), ku personazhi është midis ëndrrës dhe halucinacionit, te M. Meksi ('*Diktatori në kryq*', '*Puthja e Amazonës*') ku ëndrrat përjetohej me sy hapur. Në romanet e këtij lloji rrëfimi ndërton një marrëdhënie specifike midis reales dhe ireales; trillimi artistik krijon universin e vet, ku faktorë të tillë si e *ndaluar*, e *detyrueshmja* dhe e *lejueshmja* ndërthuren, ku personazhet janë aktorë dhe viktimë në to.

Cili është pozicioni i tyre midis *reales dhe fantazisë*, plotësimi të dëshirës, konvencionit që të bën të besosh? Si produkte të një ligji *imitues specifik*, ata, dhe të tjerë personazhe të letërsisë sonë, janë një mirëkuptim midis së *vërtetës dhe trillimit, reales dhe imagjinare*, duke qenë, në thelbin e tyre, referencë realitetesh (qoftë ky social-politik, qoftë historik-psikologjik). Askush nuk do të kishte të drejtë të gjykojë nëse personazhe si Doruntina, Gjergj Elez Alia, personazhe të M.Krajës apo B.Shehut, etj. janë, apo jo, figura më pak reale sesa personazhe të tjerë në letërsinë tonë, sepse, marrëdhëniet e fjalës artistike me botën së cilës i referohen, janë konvencionale, sepse trillimi artistik ka specifikën e vet të dallueshme nga çdo lloj tjetër i përdorimit të fjalës. Në stilin e A.Tufës përdoret ëndrra, për të risjellë përjetimet e personazheve në moment dramatik apo të një dëshire të papërmbytur... Kombinimi i reales me vizionet ëndërrrore, thekson situatën dramatike, ose thellon njohjen e thelbit të personazhit. Te '*Mërkuan e zezë*' personazhi është midis reales dhe halucinacionit, fantazisë, situatash që shkrijnë të mundshmen me të pamundurën... S'ka rëndësi sa reale apo e mundshme është ajo çka fotografohet në perceptimin e lexuesit, përballë kuptimit të brendshëm që mbartin personazhet.

Te M. Kraja ('*Edhe të çmendurit fluturojnë*', '*Net bizantine*') thyerja e marrëdhënies së personazhit me realen është gjithashtu e paimagjinueshme, por ka brenda vetes përjetime të fuqishme emocionale. Tek '*Im atë donte Adolfin*', në fund të romanit, autori shkruan

mbi fatin e mëtejshëm të personazheve, që lidheshin me atin... Kjo mënyrë krijon një raport interesant midis reales dhe trillimit. Duket sikur romani është një histori e vërtetë, ku secili personazh ka fundin e vet...

Këtë parim 'rënues' të raportit personazh/reale e përdor dendur R. Qosja në '*Vdekja më vjen prej syve të tillë*', '*Nata ish dita jonë*', '*Një dashuri dhe shtatë faje*' etj... apo V.Zhiti në '*Funerali i pafundmë*', e të tjerë autorë. Por e rëndësishme është të kuptojmë se, si rezultat i marrëdhënies midis *figurës-trillim dhe reales*, në dukje thyer keqazi, krijohet një 'reale' tjetër, më tronditëse, më emocionuese për lexuesin.

Në përgjithësi, kur raporti midis *trillimit dhe reales* është ekstremisht i cënuar, ndodh kjo dukuri: vizatimi i pamjes së jashtme humbet rëndësinë, prandaj pothuajse zhduket, sepse vepron jo personazhi real, por botëvështrimi i veçantë i tij, dalin në plan të parë arsyetimet me nëntekste jo aq të lehta; mbizotëron një komunikim virtual përmes ideshë, ndikimesh që vinë nga jashtë, dhe që, në një farë mase përplasen në përjetimet e personazhit. Në stilin e *Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë*, ndonëse Meksi është mjeshtrë në vizatimin e pamjes së jashtme, detaji nuk i përket më reales, së dukshmes, por imagjinatës së ardhur prej përtej shekujve. Thyerja është më e veçantë. Mënyra se si e ka konceptuar V.Koreshi ('*Një grua me të verdha në pyllin e Buddha-s*') botën e imagjinuar, 'cënon' mënyrën referencialë, ndonëse duket se i referohet historisë. Konceptimi mitik shprehet pikërisht në ndërtimin simbolik të realitetit, por një simbolizëm që lëviz. Është konceptim mitik sepse qëllimi i veprës nuk është zgjidhje për një ose disa probleme, por *rrezatim iluzor mbi atë realitet*.

Nisur nga ky parim estetik kuptimi i romaneve 'nuk është i vërtetë', ai është kuptim i konfiguruar, është iluzion dhe pritje e ankthshme e lexuesit. Shkrimtarët, duke ndër-tuar personazhet imagjinare, kodojnë një realitet imagjinar. Prandaj, në forcën emocionale të karakterit metaforik, veprat bëhen *më reale se realiteti*, të cilin i referohen. E *vërteta e faktit, e vërteta e idesë dhe e vërteta artistike* janë të lidhura, për të krijuar një metaforë të madhe, thelbin e së cilës autorët e realizojnë përmes formësimit dhe fatit të personazhit në aspekte dramatike dhe tragjike të jetës, përplasjes me

realitetet sociale, me enigmën e fatit etj.

Në gjithë trajtimet ka rëndësi fakti që një lexim fanatik i personazhit si 'real', do të na e bënte atë antipatik, madje do të na distanconte prej tij. Strukturalistët shkuan në një drejtim fare ekstrem, kur kritikuan romancierët realistë për pasqyrimin e botës, sepse, sipas tyre (R.Bart), romanet realiste paraqesin vlerat njerëzore sikur të ishin attribute universale të një natyre të pandryshueshme njerëzore. Sipas teoricienëve të narratives, Robert Scholes dhe Robert Kellogg² lidhja midis botës reale dhe fiksonale është "një spektër i dominuar nga tre ngjyime: a- ai që i përgjigjet *faktit specifik*, b-paraqitjes së *asaj që i ngjan faktit specifik* dhe c- paraqitjes së *tipeve të përgjithshëm të aktualitetit*". Një karakterizim i tillë i shkon drejtpërdrejtë ndërtimit të figurës-personazh në raport me realen e jetës.

Personazhi, iluzion i reales

Personazhi është kuptim, vizion, apo shkrimje e tyre?

Figura-personazh, si një shenjë që formësohet gradualisht, mbetet e paplotësuar përfundimisht deri në fund të librit. Ajo ndërtohet si qenie njerëzore gjatë procesit progresiv rrëfimitar dhe ky proces luan një rol të madh në *iluzionin referencial* mbi të. Në këtë proces formësimi, krahas veprimeve e marrëdhëniesve të jashtme të personazhit, një teknikë e rëndësishme në krijimin e përfytyrimit si person real është përqendrimi në botën e brendshme të tij. Teksti, duke i dhënë akses të drejtpërdrejtë zbulimit të fluksit të errët dhe duke ndriçuar mendimet e personazhit, krijon ndijesinë e një aktiviteti psikologjik kaq kompleks, që është vet jeta dhe jo pasqyrimi i saj i thjeshtëzuar.

Gjatë leximit të një romani lexuesi krijon edhe *iluzionin e autonomisë*, që realizohet nga një seri teknikash. Autori shpesh synon të krijojë iluzionin se nuk është ai krijuesi i personazhit por një vëzhgues i thjeshtë. Kjo ndjehet në disa romane të M.Krajës, R.Dibrës etj ku personazhi shfaqet si i pavarur nga autori-rrëfimtari. Sipas G.Lukacs nuk ka rëndësi nëse synimi në veprën e artit është vizatimi i së tërës së shoqërisë, ose vetëm e një ngjarjeje të izoluar artificialisht; synimi do të jetë, gjithsesi, të vizatojë *pafundësinë intensive* (nënvizimi im) të subjektit. Kjo do të thotë se ai do synojë të përfshijë, në mënyrë krijuese në fiksonin e tij, gjithë faktorët e rëndësishëm të cilët, në realitetin objektiv, sigurojnë bazën për një ngjarje të veçantë ose kompleksitetin e ngjarjeve. Kjo përfshirje artistike do të thotë që të gjithë këta faktorë do të shfaqen si cilësi, tipare personale të *personave në veprim*, aksion, si cilësi specifike të situatave të vizatuara, etj.

Nëse ndalemi në *formën e modelimit* të figurave-personazh në botën narrative vemë re se ky proces lëviz midis kufijve të *lejuara, të detyrueshme dhe të ndaluar*. Këto tre qasje bëjnë që imazhi dhe lëvizjet e personazheve të duken herë të natyrshme, herë sikur 'dhunojnë' normalen, dhe herë në alternimin e këtyre dy mundësive. Personazhet, që vihen në lëvizje nga mbizotërimi i një tipari apo pasioni të fuqishëm, (romanet e R.Qosjes, V.Zhiti), demonstrojnë përplasjen me normat e përgjithshme, duke sjellë transformim në komunikim dhe sjellje të zakonshme; në shumë raste trillimi artistik i personazheve vjen si rezultat i kombinimit të së *vërtetës me dhunimin* e saj. Madje shkohet më tej: në brendësi të figurës që krijojnë, për shembull M.Kraja, Z.Çela, projektohet edhe trillimi ynë, në ndjekim lëvizjet e personazheve, duke hyrë në iluzionin e një bote reale. Pa e kuptuar bëhemi 'viktimë' të iluzionit që na imponojnë autorët. Në strukturën e figurave, kufiri midis veprës dhe jetës krijon te lexuesi hapësirën për të ndjerë e për të parë diçka më shumë se ç'shpohet me fjalë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Tek '*Ora e ligë*', e Tom Kukës (E. Demit), ngjarjet tragjike e kapërcejnë realen, marrin përmasa të tjera; kjo sepse nuk ka rëndësi sa është i vërtetë zhvillimi i ngjarjeve, por përmasat që këngëtarit popullor i jep tragjedisë. Po ashtu, te '*Puthja e Amazonës*', të M.Meksit, e gjithë linja e amazonave është përtej reales, por efekti kuptimor, në paralelizmin me personazhin kryesor (dhe të vetëm), është sa metaforik, aq dhe i fuqishëm.

Shkrimtarët postmodernistë nuk e pranojnë doktrinën e realizmit, sipas tyre, letërsia krijon iluzionin e *realitetit* vetëm për ta prishur atë. Narratori fshin dallimin midis botës reale dhe

2 The Natyre of Narrative, New Jork, 1968.

botës fiktive. Teoricieni J. Baudrillard³ e lidhte postmodernizmin me ‘humbjen e reales’, që ‘historia’ dhe ‘realiteti’ janë bërë ‘të tekstualizuara’ në botën tonë hiperreale të imazheve dhe të zëvendësuar nga ‘simulacra’. Ai e paraqet hiperrealitetin si fazën e fundit të simulacrum, ku një shenjë ose imazh nuk ka lidhje me një realitet çfarëdo, por është ‘thjesht një simulacrum i tij’.

Nën ndikimin e filozofisë ekzistencialiste në narrativen postmoderne nocioni i realitetit është konsideruar një çështje e diskutueshme: ‘shfaqja përballë realitetit’ si një paradigmë është zëvendësuar nga ‘shfaqja përballë zhdukjes’. Realiteti iluzor i botës fikzionale është shkatërruar dhe në vend të tij na ofrohet *jo-bota reale*, ose të paktën *një botë reale*... Sipas kësaj teorie, autori shkatërron konturet rreth botës së tij dhe nxjerr në plan të parë një realitet jo të zakonshëm, ai çrregullon pamjen e realitetit, duke nxjerrë në plan të parë strukturën ontologjike të tekstit dhe të botës funksionale. Të gjitha pikëpamjet mbeten të diskutueshme në teorinë e raportit të personazhit me realen.

Figura-personazh-sintezë e dy realiteteve

Është thënë se letërsia ‘shtrembëron’ më tepër se sa imiton. Personazhe të tillë si të ‘Përbindëshi, I. Kadaresë, të ‘Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë’ i M. Meksit’.... etj. janë imazhe, perceptime iluzore, sepse nuk i korespondojnë konkretes, janë përpunim fjalor që i përgjigjen një ‘realiteti të munguar’, janë, pra, një ‘mashttrim’, i cili vë në lëvizje perceptimin tonë. Në qoftë se ne arrijmë t’i shohim këta personazhe, në të vërtetë, kemi krijuar *iluzionin* se ata janë para nesh, dhe kjo ‘pamje’ ka të bëjë gjithmonë me një tërësi, me një sistem përbërësish të strukturuar së brendshmi, në mënyrë intuitive-artistike. Në korpusin narrativ të Z. Çelës kemi një botë të trilluar ku flitet se personazhet ngrihen nga varri, kapërcejnë hapësira kohore e hapësina etj., pra dhunojnë ligjet e natyrës. Kjo botë supernatyrle merr vlerën e së mundshmes dhe të domosdoshmes, për të krijuar një sistem të tërë veprimesh dhe kundërveprimesh midis personazheve dhe realitetit që lëviz në shtresat e brendshme kuptimore. Sikurse në gjithë letërsinë, edhe në veprat e këtij autori (dhe të tjerëve) realizohet njëkohësisht rrëfimi i së vërtetës dhe ‘mashtrimi’ logjik. Ndërkaq lexuesi, ndonëse kupton dallimin midis këtyre dy aspekteve, e jeton iluzionin e reales, ndjek me emocion, madje me ankth, personazhet si figura shumë më tepër të sofistikuara se një trillim i thjeshtë; ai reagon ndaj tyre si ‘fakte’ të reales.

Shpesh ndodh që realiteti iluzor i botës fikzionale të na ofrojë një botë jo reale, por që, lexuesi e di se, në thelbin e saj, ajo i referohet një bote reale. Romancieri duket sikur shkatërron konturet e kësaj bote, duke nxjerrë në plan të parë një realitet jo të zakonshëm. Kjo bën që në disa vepra të dy dhjetëvjeçarëve të fundit, personazhi të kapërcejë iluzionin e realitetit dhe pikëvështrimi themelor të jetë superreal. Domethënë, figura zhytet në një rrjet imazhesh dhe shenjash pa referues të jashtëm, ku ajo që paraqitet është prezantim në vetvete; është, pra si kopje apo imazh pa referencën e një origjinali.

Personazhi midis realitetit dhe shpirtit, prekshmërisë dhe vegimit është një kod original i ndërtimit të figurës në romanin ‘Ulku dhe Uilli’, të V. Koreshit. Vrana ngjitet nëpër faqet e murit, kalon nëpër hatullat e nëpër vrimat e çatisë... (filozofia e triumfit të dëshirës!), ai arrin atë që s’mund të bëhet! Fshihen kufijtë midis realitetit dhe ireales, të mundshmes dhe të pamundshmes, sepse për autorin s’ka rëndësi ç’është reale, por çfarë quan shpirti njerëzor të mundshëm. Në këtë kuptim koncepti i reales merr një përmbajtje të veçantë. Realizmi në letërsi dhe e vërteta e jetës janë nocione që s’mund të identifikohen, për të mos rënë në banalizim të artit

Tek ‘Përbindëshi’ sinteza e dy realiteteve të ndryshme, i tekstit dhe problematikës reale, krijon metaforën e mishëruar në psikologjinë e figurës: ndërsa të ‘Koncert në fund të stinës’ figura e Maos-metaforë endet midis reales dhe irreal, herë e kapshme e herë e pakapshme, herë njerëzore e herë jashtëtokësore. Tek ‘Qorrfermani’ i I. Kadaresë, realiteti tekstori dhe realiteti njerëzor janë në një raport krejt të veçantë: fjala krijon imazhin e diçkaje që, ndonëse nuk shfaqet si personazh, merr përmasat dhe gati

konfigurimin e një figure “Një gjë e njohur, disi e harruar që prej disa vitesh, nisi të jetonte në erë: frika... E akull, pa përmasa, me një zbrazëti të madhe teipërtej, por që mbushte, megjithatë gjithçka, ditë për ditë e orë pas ore, ajo nisi të përfshinte në qerthullin e saj qindra mijra njerëz”.

Figura të tilla, në distancën midis *iluzionit dhe reales*, mbartin metafora të rralla për nga forca e përfytyrimit njerëzor. Ato fitojnë konkretësi, ndonëse përmasat e figurës metaforike janë jashtë hapsirave normale: “do të shuaj llampën e botës” thotë personazhi Ali Pasha, duke fshirë kufirin midis njerëzores dhe të mbinatyrshmes. Në hapësirën trilluese të Kadaresë personazhi dhunon ligjet e natyrës dhe krijon brenda vetes një botë superreale.

Raporti: *e vërteta-reale* dhe *artistikisht e vërteta*, që lidhen me sintezën brenda figurës-personazh, shtrun pyetjen e diskutuar shpesh: çfarë është *reale* në një vepër dhe çfarë është *personazhi* në të ?

Figura-personazh si konvencion

Problemi i konvencionit është aspekti themelor i estetikës letrare ; është kategori e rëndësishme që përcakton raportin e brendshëm midis artit dhe dukurive të jetës. Në letërsi vetë nocioni i së *vërtetës artistike përfshin* në vetvete *nocionin e konvencionit*, si mjet dhe kusht i shndërrimit të së *vërtetës së jetës në të vërtetë artistike*. Kur perceptojmë figurën-personazh si konvencion kjo nuk do të thotë se e kuptojmë atë thjesht si element të formës, por as si heqje dorë nga realja.

Dimë se teksti realist zbaton konvencione letrare që ndahen midis autorit dhe lexuesit në një mënyrë të tillë që lexuesi nuk e vë në pikëpyetje mjeshtërinë e trillimit, nuk shqetësohet se është reale, e vërtetë figura, në kuptimin e gjerë të saj. Kështu konvencionet letrare, në mënyrë të heshtur, janë pranuar midis autorit dhe lexuesit; ato e përgatisin lexuesin që të pranojë botën e trilluar si reale. Por në disa raste nocioni që realiteti dhe e vërteta janë *ndërtim* më tepër sesa realitet, sjell një *marrëdhënie tjetër të autorit me lexuesin*. Ndërsa trillimi realist mbështet pikëpamjen që realiteti është një eksperience e përbashkët, që mund të ndahet midis autorit dhe lexuesit, ndodhi që romane të Qosjes, Shehut, Çelës dhe disa autorëve më të rinj që në dy-tre dhjetëvjeçarët e fundit preferuan poetikën postmoderniste, sfiduan këtë raport. Në thelb, ky parim estetik shkon më tej, duke pasqyruar një botë ku ‘realiteti ose historia janë të përkohshëm, jo një botë e të vërtetave reale.

Personazhi si konvencion, do të thotë që pranojmë se realja e jetës mbetet e vërtetë në veprën letrare, figura-personazh perceptohet edhe si art/trillim edhe si reale, prandaj proceset e zhvillimit brenda strukturës artistike duken po të besueshme sa dhe ato të jetës. Problemi i kuptimit se *sa personazhi është konvencion letrar dhe sa është realitet*, tingëllon i dyfishtë: nga njera anë kemi pranuar se fikcioni është gjë tjetër nga realiteti, por, në të njëjtën kohë, çka duket si kontradiktore, kemi pranuar edhe se realiteti është lënda, burimi i fiksonit, dhe, megjithatë, e kemi të qartë se fikcioni ka një natyrë të ndryshme nga realiteti. Nisur nga fakti që rrëfimet janë ndërtime verbale, teoricienët kanë nxjerrë dy konkluzione polemike. Përderisa marrëdhënia midis fjalëve dhe botës është konvencionale, dhe konvencioni varion, disa thonë se nuk ka arsye për ta menduar një karakter më realist se një tjetër. Fakti që pasqyrimi (faktual ose fikcional) është konvencional sjell një vëzhgim të vlefshëm: ne mund ta shohim çdo konvencion në raportin e vet të referencës....

Në thelbin konvencional të figurës-personazh, në romanet më të realizuara të letërsisë së sotme, figurat-personazh sikur janë rrethuar nga një sferë e ndërmjetme – asociative - që zgjeron mundësitë e perceptimit të tyre. Pikërisht në këtë sferë ngjizet, zhvillohet dhe zbulohet një formë e tillë komplekse e konvencionit të personazhit, (të Qosjes, Kadaresë, Krajës, Çelës, Tufës, Meksit etj.) përmes nëntekstit të figurave, realizohen mendimet që fshihen dhe që duhet të lindin në ndërgjegjen dhe përfytyrimin e lexuesit.

Thelbi i kësaj veçorie shprehet në pohimin e Todorovit⁴, sipas të cilit në roman bëhet fjalë për dy histori, nga të cilat njera mungon, por është reale, tjetra është e pranishme, por

e parëndësishme. Kjo prani dhe kjo mungesë shpjegon ekzistencën e dy historive në vazhdimësinë e rrëfimit. Si ndodh që figurat-personazhe të Kadaresë, M. Krajës, V. Zhinit e të tjerë, duke qenë trillime artistike, vijnë në përfytyrimin tonë ‘realë’, ndikojnë në emocionet tona, kur dihet që marrëdhëniet midis fjalëve që përdor shkrimtari dhe botës që na rrethon janë konvencionale dhe madje të variueshme në konvencionalitetin e tyre?

A janë figurat njëlloj ‘imitimi’ të një realiteti? Në disa romane ky raport është më i drejt-përdrejtë, më i qartë (*‘Dimri i madhi’, ‘Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut’* etj.). Por, ka edhe figura që krijojnë në një botë, realiteti i së cilës nuk ekziston (*‘Kush e solli Doruntinën’, ‘Triumfi i Gjergj Elez Alisë’,* etj.) A ka ndonjë diferencë konvencionale në formësimin e figurave-personazh në këto dy kategori perceptimesh artistike? Mendoj se edhe ka, edhe nuk ka. Sigurisht nuk ka, sepse figura, duke qenë mishërim i asaj që nuk ekziston, në thelbin e saj është realizimi i thelbit të letërsisë dhe natyra konvencionale është boshti i ekzistencës së saj. Por, në rastin e shembujve të sapo përmendur, shkalla e konvencionit ka një përmasë më të theksuar, metafora shkon në kufijtë më ekstremë të saj.... Është e dukshme që disa personazhe duken sikur janë në pole të kundërta mes tyre, si Ljuba (*‘Ngjizja e papërlume’*) dhe Doruntina (*‘Kush e solli Doruntinën’*, por ajo çka i bën ato të afërta është thelbi konvencional, ndonëse në përmasa jo të njëjëllojta. Përderisa marrëdhënia midis veprës dhe botës së pasqyruar është konvencionale, më duket shumë e drejtë pikëpamja, sipas së cilës nuk ka arsye të mendojmë se një pasqyrim i personazhit është më realist se një tjetër.

Që *letërsia ‘shtrembëron’ dhe jo thjesht imiton realitetin*, ky është parimi universal i saj. Personazhe të tillë si Xhexhoja, kapërcimet epokale (*‘Përbindëshi’*), Vasiliqija (*‘Pashallëqet e mëdha’*), etj. janë imazhe, *perceptime iluzore*, sepse nuk i korespondojnë konkretes, janë përpunim fjalor që i përgjigjen një ‘realiteti të munguar’, janë, pra, një ‘mashttrim’, një konvencion artistik, që ve në lëvizje perceptimin tonë. Në korpusin narrativ të disa romancierëve kemi botë të trilluar, ku flitet se personazhet ngrihen nga varri, kapërcejnë hapësira kohore e hapësina etj. Megjithatë, kjo botë supernatyrle bëhet e mundshme dhe e domosdoshme për të shpërthyer një sistem të tërë të kundërveprimeve ndaj tyre. Në vepra të M. Krajës, Z. Çelës, V. Zhinit... realizohet njëkohësisht *rrëfimi i së vërtetës dhe ‘mashtrimi’ logjik*, të cilat paraprijnë formësimin e figurave-personazhe. Kjo është arsyeja që, ndonëse kuptojmë dallimin midis këtyre dy aspekteve, ne, megjithatë, jetojmë me iluzionin e së vërtetës, ne ndjekim me emocion personazhet e tyre si figura shumë më tepër të sofistikuara se një trillim i thjeshtë dhe, nëse përjetojmë ndjeshmëri emocionale, kjo ndodh sepse ne reagojmë ndaj tyre si iluzione të reales.

Konvencioni është njëkohësisht edhe *forcë përgjithësuese* edhe *forcë konkretizuese* në art; është mjet i brendshëm i krijimit të figurës artistike. Letërsia prandaj ekziston, falë pakapërxueshmërisë së distancës midis vizionit të artistit dhe vetë realitetit. Sipas Ch. Crittenden⁵ konvencioni ka karakter të shumanshëm dhe shumëkuptimësh, sepse shërben si kufi midis jetës dhe artit. Ai është *brenda vetë letërsisë si tip i të menduarit*, si mjet përgjithësimi, i trilluar, ‘artificial’, që rrjedh nga specifika e përmbajtjes së figurës artistike. Prandaj thelbi konvencional i figurës-personazh është thellësisht individual. Ky tipar nuk çënon aspak lidhjen midis racionale dhe emocionale në figurën e tij; ai i bën raportet reale të formave të realitetit të ngjiten deri në shkallën e lartë të tensionit artistik, të zbulimit të thelbësorës në to, sepse e vërteta dhe pasqyrimi janë një akt sinkron...

Problemi themelor i kuptimit të thelbit specifik të letërsisë, që e dallon nga llojet e tjera të krijimtarisë, është se mjeti që ajo përdor, FJALA, ka vetinë e pakrahueshme me çdo mjet tjetër të arteve të ndryshme, për të krijuar vazhdimisht, në trajta të papërsëritshme te lexues të kohëve të ndryshme, imazhe që lëvizin, gjallërohen, përshtaten me emocionet dhe përvojën e çdo lexuesi...Këtu e gjen përgjigjen pyetja se pse një personazh është më i fuqishëm në emocionet që përcjell se dukuria reale, se karakteri social që mishëron.

5 Charles Crittenden “UNREALITY” - The Metaphysics of Fictional Objects, Cornell Univ. Press, 1991.

(Vijon nga faqja 3)

Shqipërisë në Frankfurt, prani e cila do të sillte dobi të panumërta për ne si autorë të gjuhës shqipe?

Bashkë me Enxhin, “shfrytëzojmë” emrin e Ismail Kadaresë dhe u prezantojmë botuesve të tij anë e mbanë botës disa prej shkrimtarëve shqiptarë, me materiale të përgatitura vetë, sipas modeleve të lartpërmendura, por e vërejmë se më tepër na dëgjojnë për mirësjellje, na buzëqeshin, marrin ato libërtha që u japim me pasazhe tekstesh të përkthyer në anglisht a gjermanisht dhe i lënë diku. E kuptojmë se pa qenë të mbuluar nga prania e vendit tonë aty, nuk na kushtohet rëndësia e as serioziteti i duhur, praktikisht asgjë përtej mirësjelljes.

Ndërkohë të shtunën, në këtë datë kur ju po e lexoni gazetën, stenda e Kosovës organizon Orën e Madhe Letrare. Me të ftuar tre autorë, njëri shqiptar i Kosovës, Ag Apolloni dhe dy shqiptare të Shqipërisë, Rita Petro dhe Loreta Schillok. Kështu, mungesa e Shqipërisë sikur zbehet pak, sepse Shqipëria gjen vend në stendën e përgatitur prej institucioneve të Kosovës, paçka se jo rrallë herë, Kosova nuk ka gjetur vend në aktivitete, ngjarje apo botime të mbështetura nga institucionet e Shqipërisë.

Ndërsa tani, mbyllja

Vetëm në panaire të tilla, një gazetar kulture mund ta mësojë si mbulohet një ndodhi kulturore, një botues mund ta kuptojë si funksionon industria e librit në botë, një shkrimtar mund ta zbulojë çfarë duhet për të kaluar kufijtë e lagjes së tij. Në Shqipëri mungon koncepti i agentit letrar, mungon mbështetja konkrete për krijimin e konteksteve për njohje ndërkombëtare të letërsisë kombëtare (ne mbështesim gjashtë libra në vit për përkthim në gjuhë të huaj, ndërsa Serbia, për shembull, 20 herë më shumë, pra 120 tituj) dhe mbi të gjitha, mungon dashamirësia për ta pranuar tjetrin si dikë me të cilin nuk lufton, por bashkëjeton.

Por le t’i kthehem sërish lajmit të mirë, arsyet pse u gjendëm këtu, zbulimit fantastik të një romani të humbur sikurse e vë në dukje që në kopertinën e sapozbuluar botuesi anglez i Márquez. Historia fantastike, përnjëmend markeziane e një vajze që çdo gjashtëmbëdhjetë gusht, dita e Santa Maria Maggiore, festa më e madhe përkujtimore e Marisë në botën katolike, kthehet në një ishull ku rijeton aventurat që zbulojnë gjithë përmasat e botës së saj shpirtërore, fizike e psikologjike. Dhe sikurse nuk ndodh shpesh, kësaj premiere botërore i bashkohet edhe Shqipëria. Ndoshta është hera e parë kur lexuesit shqiptarë që adhurojnë një autor të huaj, s’do të kenë nevojë ta kërkojnë librin e ri në anglisht fillimisht e pastaj, muaj a vite më vonë, ta gjejnë dhe në shqip. Jo, ky libër do të vijë për lexuesin shqiptar në të njëjtën kohë si për atë spanjoll, kolumbian, italian apo amerikan. Të paktën në këtë, jemi në të njëjtën kohë me botën.

3 Jean Baudrillard: Simulacres et simulation, Paris: Galilée, Simulacra, 1981.

4 Cv. Todorov “Poetika e Prozës”, Panteon - Sh.L., Tiranë, 2000.

Dalja prej vetvetes, rikthimi te vetja (Vijon nga numri i kaluar)

Në shënimet dorëshkrim me titullin *Pikënisje poetike*, dhe nëntitullin *Në fillim këtë poezi e quejta Hoja*, në disa rreshta me ligjërim tërheqës biografik, është parashtruar një dramë e zhvilluar në psikologjinë e tij krijuese, që ka zgjatur gjithë jetën. *Hoja* në Malësi është një *genie imagjinare popullore*, e përfytyruar e huaj, që nuk thirret për mik në shtëpi. Negativizmi, që mishëron nuk sqarohet. Nisur nga kodi kanunor, mendësia shqiptare për mikun, që i hapet dera, mund të hamendësohet, se keqbërja e saj, ndoshta, lidhet me pabesinë, shkeljen e nderit e të besës. Për fëmijët është *bubazheli*. Me të trembin fëmijët natën, kinse vjen për t'i marrë, kur nuk duan të flenë. Camaj, në këtë sjellje me "funksion" "disiplinues" e "qetësues", shikon dukuri psikologjike të papajteshme, të cilën nuk i ka kuptuar as i rritur. Konteksti ka edhe domethënie, se nuk e pranon një lloj të tillë edukimi, për mos të thënë diçka tjetër. Si mund të flejë fëmija, duke i ngjallur përjetime tmerri? Në fëmijëri, frikën prej saj e ka përjetuar edhe vet, madje i është kthyer në makth. Në moshë të rritur Hoja, në psikologjinë e tij, shfaqet në dy pamje e në dy pozicione. Njëra është figurë e frikshme e kujtesës së fëmijërisë, e zhytur, me kalimin e viteve, në nënvetëdije, që përcjell anth me adresë të humbur. Tjetra është përfytyrim i të papranueshmes në shtëpi, se mishëron të keqen e madhe, të papërcaktuar. Mospranimi i saj është mospranim i të keqes, mbyllje e derës. Pranimi është gabim fatal i bërë me vetëdije. Këto dy figura, apo, përfytyrime, i janë kthyer në obsesion. "Kjo fjalë [Hoja] dhe përfytyrimi i saj gjith bashkë më kanë ndjekë tanë jetën të konkretizuem në një grue njëqindvjeçare e veshun nuse. Ajo ka jetue bashkë me mue pa shndërrue kurrë fytyrë." ** *Pikënisje poetike*, Lavdi enigmave të natyrës.

Edhe përfytyrimi i përjetshëm, që e ka përndjekur psikologjikisht Camajn, i është shfaqur në dy pamje përjashtuese të njëra tjetrës. Edhe njëqindvjeçare, plakë, thuajse, e dënuar me pavdekësi, edhe e veshur nuse. Shëmtimi, e keqja e përjetshme, të fshehura në bukuri. Sikur po i afrohem një lloj kuptimi, thirrjes për ruajtje prej saj.

Prej obsesionit e ka çliruar krijimtaria. Me vetëdije e vullnet e ka shmangur shëmbëlltyrën e saj, duke e zëvendësuar me poezi për jetën dhe natyrën. Me zëvendësim e saj ka dalë prej vetes Martin për të qenë plotësisht poet.

"Për ta shmangë atë, më ashtë dashtë të dal prej vetvetes dhe t'i këndoj jetës a natyrës sepse një genie si Hoja s'e meriton kangën e aq ma pak ta quej librin tim të shtatë në emën të saj, Hoja. Ma mirë Lavdi einigmave të natyrës." ** *Pikënisje poetike*, Lavdi enigmave të natyrës...

Shmangu më të madhen. Doli prej vetes, duke mos e titulluar librin *Hoja*. Mirëpo, nuk shpëtoi plotësisht prej saj. Një shtytje tjetër, e pa përballueshme, e riktheu tek obsesioni i fëmijërisë.

Prej mllëfit psikologjik është përfutur poezia *Hoja* (* * Vëllimi me poezi, dygjuhësh shqip-anglisht, *Palimpsest*, përkthyer prej Leonard Fox, Munich and New-York, 1991.

me domethënie shoqërore aktuale. Përkundër bestytnisë popullore, që Hojës i mbyllet dera dhe nuk thirret për muke në shtëpi, njerëzia është në ekstazë euforie nga *vallja* dhe *thirrjet* e saj. Plaka njëqind vjeçare, e veshur nuse, sikurse e ka pasur përfytyrimin vetjak gjatë gjithë jetës, e shndërruar në shëmbëlltyrë poetike është e marrë dhe *magjistare*. Në përmbytjen apokaliptike të *Pazarit të Shkodrës*, ku janë zhdukë mija ngjyra të folklorit dhe gjithçka është përzieshëm, Hoja, thërret e kërcen, vetëm ajo dëgjohej, ndërsa, *turma i brohorit në jehonë madhështore: Hoja! Hoja! Hoja!* Sikur i thotë Lavdi! Lavdi! Lavdi! e Rroftë! Rroftë! Rroftë!

Metoda e rrethana në të cilat "kam ba letërsi"

Ai kishte droje, mezi fliste për veprën e vet, edhe kur e pyesnin bashkatdhetarët nëpërmjet letrave. E quan të domosdoshme të thotë diçka vetëm në mbyllje të ciklit të krijimit (1989). Dhe atëherë, jo aq për të, se sa, sikurse shkruan, *ndoshta mbi metodën e rrethana në të cilat "kam ba letërsi"*. Këto mund të mendohen, se kanë qenë kryesoret, që kanë përcaktuar veprën.

Cilat janë rrethanat?

Më e plotë, do të thuhej, gjendja e shkrimtarit dhe rrethanat.

Letërsia i është shfaqur fillimisht në formë pasioni, si te çdo talent i ri. Me ndërgjegjësimin për aftësitë e veta, të bërit letërsi, mes vështirësive të mërgimit, i shndërrohet në pasion të skajshëm, që njëjtësohet me jetën, me qëllimin dhe kënaqësitë e saj. Me kohë, edhe kjo kapërcehet. Shkon në një gjendje tjetër, në shkallaren më të lartë të qeniesisë/ekzistencës. Letërsia e mban gjallë, i jep edhe vullnetin për të jetue.

"Qysh prej fillimit ishte një pasion, nga lirika kam kalue në shkencën gjuhësore për mos t'u nda nga krijimi letrar: prej letërsisë kam pasë gjithçka, edhe vullnetin për të jetue. Kjo quhet edhe obsesion." ** *Ndoshta ka qenë e dobishme që i kam pjekë*

Nëpërmjet letrave dhe shënimeve të arkivit vetjak, në shtëpi, Lenggries (Gjermani)

PORTRET PSIKO-LETRARI MARTIN CAMAJT

Nga Bashkim Kuçuku



temat e mjetin "gjuhën" pa qenë fort i ndikuem nga faktorët e jashtëm: lirika, sidomos, e don vetminë e zhvillimin * * 22. 8. 1989, I dashuni Idriz Lamaj, mora kasetat bashkë me tekstin e emisionit mbi Fishtën....

Ai ka jetuar për të bërë letërsi dhe nëpërmjet të bërit letërsi. Aq i fortë ka qenë ky motiv jete sa i është shndërruar në obsesion. Në fund të frazës, shpjegon: *kjo quhet dhe obsesion*, i cili, sipas psikologjisë, është gjendje emotive tronditëse, e padurueshme, që synon të zëjë gjithë fushën e vetëdijes.

Larg të vetëve- lexuesve, letërsia i u shndërrua në obsesion, në një ngarendje tej kufirit të zakonshëm, në humbje barazpeshe mes qenies-njeri, dhe qenies- shkrimtar. Njeriu Camaj ka humbur nga hapësirat e qeniesisë, të cilat i ka "pushtuar" shkrimtari Camaj.

Mbi shkrimtarin luajnë rol faktori i jashtëm, mjedisi me rrethanat, dhe faktori i brendshëm, gjendja e tij psiko-shpirtërore. Nga faktorët e jashtëm nuk ka *qenë fort i ndikuem*. Bota përreth e mërgimit mbeti "e huaj" për "letërsinë" e tij. Rrallë gjendet ndonjë poezi për rrethanat dhe mjedisin e mërgimit. Mosprania e saj, zbulon, se nuk e kishte as në shpirtin krijues, dhe, as "aparati" i përfutimit të letërsisë nuk e pranonte.

Faktori i brendshëm, zotërues i gjendjes, aktivizohet mbi të zakonshmen për të mbuluar edhe mangësinë e faktorit të jashtëm. Mjedisi dhe rrethanat e jetës shqiptare, bie fjala, nuk ishin pranë e përreth tij. Ato i kishte marrë me vete dhe, nga faktor i jashtëm, ishin kthyer në faktor të brendshëm. Rëndësi parësore ka bota e brendshme e shkrimtarit, zhvillimi i saj, të cilën e mendon të pavarur prej mjedisit. *Lirika, sidomos, e don vetminë e zhvillimin e mbrendshëm të pavarun. * * 22. 8. 1989, I dashuni Idriz Lamaj.*

Ai, që, disa herë është ankuar përvuajtshëm për vetminë, në këtë rast, e shikon si një mundësi pavarësimi prej rëndomtësive të përditshmërisë. Shkëputja, veçimi prej të tjerëve, që e ngre në shkallaren e domosdoshmërisë, sidomos për poetët lirikë, nuk është për t'u mbyllur në "kullën e fildishtë", por për të qenë sa më i lirë, i pandikueshëm në shprehjen e vetvetes në art.

Ka qenë ky zhvillim i brendshëm i pavarun, pa program a qëllim të paramenduar, që e ka drejtuar fillimisht te lirika, pastaj edhe në prozë, të cilat i ka lëvruar krahas njëra tjetrës, e disa herë në ndërthurje të tyre nën të njëjtin titull, për të arritur në *sintezën kulmore* të tyre te *Dranja*. Prandaj, vepra e tij, pavarësisht lëndës, mishëron një art të pastër e të mirëfilltë, pa detyrim, veç shprehjes së domosdoshme të shkrimtarit për të komunikuar me lexuesin, më tepër imagjinar se konkret, i pangjashëm në llojin e vet.

"Ndjekja e rrymës së zhvillimit të mbrendshëm nga lirika kam kalue në prozë, por jo tue i thanë lamtumirë lirikës, si ngjan shpesh: i kam lavrue të dy gjinitë njëkohësisht: *Djella shënon këtë kthesë që ashtë shkruar në prozë e poezi. ... sintezës mes poezisë e prozës i jam avytë në veprën Dranja.*" * * 22. 8. 1989/I dashuni Idriz Lamaj, mora kasetat bashkë me tekstin e emisionit mbi Fishtën...

Tërësinë e veprës, poezi-prozë, e ka menduar me një *regularitet*, ose, *konsequencë*, që, mund të quhet edhe vijimësi në zhvillim e embrionit fillestar tematik e gjuhësor në dialekt, gegënisht, të lidhur me vendlindjen, në malësi. "Në prozë kam pasë mundësi, pavarësisht, të jem dhe strukturalist, ndoshta sepse edhe në gjuhësi jam strukturalist? Nuk mund ta pohoj sepse krijimi letrar ka metodën e vet. Nuk e mohoj se kultura e shumanshme sidomos gjuhësore jep edhe (?) të jesh jo struktural, por në veprën tande në tanësi të ketë një "regularitet". Mund të quhet dhe *konsequencë që del ma së fort në pah në tematikën të cilës i kam mbetë besnik tue fillue nga lirika "tingujt e parë" që kam shkruar kur isha 25 vjeç...*" * * 22. 8. 1989/I dashuni Idriz Lamaj, mora kasetat bashkë me tekstin e emisionit mbi Fishtën....

Regulariteti, konsequenca është edhe në motive, figurshmëri, struktura të përsëritshme, etj., të cilët nuk i përmend. Në prozë pranon, se, *pavarësisht është strukturalist, me qenëse është strukturalist në gjuhësi*. Strukturalizmi ka kaluar nga gjuhësia në letërsi. Struktura e ndërlikur e poezive dhe e prozave, brenda të njëjtit titull dhe nga titulli në titull, origjinalizmi, veçanësia strukturore e secilës dhe domethënia në mënyrën e leximit janë disa nga të dhënat e tij.

Camaj, që gjithandej shfaqet modest për veten dhe ndihmesat letrare, pas një përvojë të gjatë, në poezi dhe në prozë, ka kullmuar me sintezën e shkrirjes së tyre te *Dranja*. Në një moment (1989), pohon: *tue shkruar Karpa e kam ndie veten shpesh "virtuoz"*. Me këtë fjalë, shenjuese e aftësisë së lartë të krijimit, ai kupton jo vetëm aftësinë e pakufizuar për të shprehur plotësisht veten, por edhe mënyrën e të shprehurit. "... mora zemër me shkue dhe një hap përpara me KARPA: tue shkruar këtë vepër e kam ndie veten shpesh "virtuoz", dmth jam në gjendje të thom shqip gjithçka due! P.sh., në një periudhë pesë rreshtash me projektue shtresa të ndryshme *domethanije*. * * 22. 8. 1989/I dashuni Idriz Lamaj, mora kasetat... mbi Fishtën....

Njësia bazë e të shprehurit është shumë e vogël: *një periudhë me pesë rreshta*, e cila mund të merret edhe si njësi bazë strukturore e stilit të tij, sidomos te *Karpa*. Përkundër madhësisë së saj të zvogëluar skajshëm, *domethanjet* janë disa, madje, dhe me kahe diverguese, tipar kryesor dallues i stilit të modernizmit bashkëkohor në zotërimin e të cilit është njëmendësisht virtuoz.

Vetjakja në poezi, shndërrim i të njëmendëtave

Në se do t'i përmbahemi konceptit, se lirika më shpesh zotërohet nga ndjenja e ndjesi intime, pasione e obsesione të poetit, që përjeton thellë në rrethanat e jetës, Camaj ka një mendim e qëndrim tjetër, ndonëse, në poezinë e tij, mund të vërehet, se, nuk është plotësisht, sikurse ka shkruar në letra e shënime.

Subjekti lirik i saj mbart cilësi psikologjike dhe të dhëna "biografike" të ngjashme me të biografisë së poetit. Më shpesh ata të dy janë të njëjtësuar, duke mishëruar cilësi universale,

njëkohësisht dhe të dhëna psikologjike vetjake e intime.

Marrdhënia mes vetjakes dhe të përgjithshmes njerëzore është problem për çdo poet, aq më tepër në lirikë, në të cilën, humbja e barazpeshës së këtyre përbërësve rrezikon me zhvlerësimin e saj. Përmasa, që zë njëra dhe tjetra, denduria, harmonitë mes tyre janë nga më të ndryshmet, në varësi të temperamentit dhe konceptit, që ka secili për poezinë e vet. Për Camajn ka qenë një nga problemet krijuese më të rëndësishme. Shqetësimi dhe qëllimi i tij ishte të gjente mënyrat më të përshtatshme: "*si t'i thjeshtësoj ngjarjet e ndjesitë e mia*" * * *Shënime të përgjithshme – mbi Varg librash letrarë*. Të gjente ku mund të kapej filli i krijimit për të kaluar në përgjithësi me rreze të gjerë. Parimi artistik për të *thjeshtësuar* ngjarjet e ndjesitë vetjake vinte prej konceptit, që kishte për poezinë: "*Njehja e tyre në mënyrë realiste, as me qenë tue shkruar biografinë për mue nuk ashtë art.*" * * *Shënime të përgjithshme – mbi Varg librash letrarë*. Praninë e tyre të madhe, dhe, ashtu si kanë qenë, "realiste", nuk e quan art, se ngjan me biografinë, që anon nga historiografia. Ndikim, në këtë qëndrim, ka pasur edhe kodi etik, modestia e dëshira për mos t'u dukur para të tjerëve si "hero" "*Nuk kam qenë kurrë aq i pakrypë me qitë ndjesitë e ngjarjet e jetës sime të idhta e të gëzueshme troq...*" * * *Shënime të përgjithshme – mbi Varg librash letrarë*. Thjeshtësimin e ka arritur nëpërmjet stërhollimit, largimit të skajshëm, shndërrimit të të njëmendëtave deri në tjetërsim: "*pa i shndërrue dhe stërhollue sa mos me i njohë as vetë*" * * *Shënime të përgjithshme – mbi Varg librash letrarë*. Pohimi, se, në veprat e tij, nuk mund të njëjtësohen përbërës biografikë, i zhdrejtton studiuesit në gjurmimin e tyre. "*Nëse ndokush prej gjurmuesve të letërsisë ka me kërkue elementa autobiografikë në veprat e mia, ai hyn në pyll pa spatë...*" * * *Shënimë të përgjithshme – mbi Varg librash letrarë*.

Rrallë, për ndonjë moment tepër të rëndësishëm, përmend faktin e njëmendët, pa pasur qëllim zbulimin e lidhjes me poezinë. Bie fjala, kur, me rrezik jete kaloi kufirin për t'i shpëtuar përndjekjes. Ndodhinë e kujton pas 33 vjetësh. Edhe këtë në trajtë jo letrare, në letërnë, që i ka dëguar bashkëpërfjetuesit, At Danielit (Daniel Gjeçajt) "... a ka mbetë kush gjallë prej atyne me të cilët kemi kalue kohët e vështira? Mner! Shumëve u kam harrue edhe emnat. Thelbin e atyne përjetimeve - të shndërrueme - e kam përpunue edhe në veprat e botueme deri dikund; shum motive kësi lloji i kam në dorëshkrime që sigurisht se nuk do të botohen kurr: " * * **Lenggries, 27.8.81/I** dashtuni Atë Dannjel, megjithëse kaloi Krejt odiseja e arratisjes është e përmbledhur në tri fjalë: *kohët e vështira. Mner!* E njëjta ndodhi (1948) është përshkruar e zhvilluar nga At Danieli, në kujtimet e tij, me kujdesin dhe përjetimet e ankthshme të atyre, që, në malet e thepisur, fshiheshin, edhe nga drita e hënës, për t'i shpëtuar syrit dhe veshit të ushtarëve të kufirit.

Përshkrimi i At Daniel Gjeçajt:

"U çuem më një anë të errët, përpara se të delte hana. Rruga, e pa rrugë, kalonte nëpër pyllë, gjithkund në të përpetit. Në fillim s'shihej kurrja... Dikur, ndoshta dy orë para mjesnatet, nisi me dalë hana si qëthë, përherë e ma e shndritshme. Majet e maleve të thepisuna e të bardha, shkamb i gjallë, dukeshin në tanë madhninë e vet kristaline, si të veshuna me argjend. Hijet e luginave e shpatet në kapt bësheshin ma të dëta e qitshnin në pah trajtat e relievat një mijë formash me një sfond qiellit tejet të kaltër, ku hyjt zbeheshin në dritë, sa ma fort çohet hana në udhëtim të vet. ... Qellimi ishte që të mos shiheshim prej rojeve të cilat mund të gjindeshin ndër maje e qafa të kufinit. ... Dikur, mbas orëve të rrugës të pa rrugë.... u kapëm në qafën e kufinit... Sigurisht s'ishte koha me vrojtë bukuritë, as veçantitë përherë të tërheqëse të maleve tona të vrashta e përherë të virgjra... Ishte një çast takimi me bukurinë, me nallësitë. Martini më vonë i thandroi në art këto çaste tmerrësisht madhështore. Fryt i këtij takimi me hanin, rrethue prej telash ferrc, asht poezia "Telat me thepa nën hanë", e cila ndoshta-ndoshta nuk kishte për t'u kuptue si duhet, pa këtë kornizë: S'mund ta harroj hanën mbi krye kur ishte një rrotull e rrezikshme hekuri së skuqun. Preksha eshtrat e shpatullavet të mija, të ngurta e trimnohesha.

Telat me thepa, kufini i botës: përtej njerzija ishte e veshun e pa tundime në shpirt, këndeja na lăkur para njani tjetrit. Npër parzmat e hollë tejsiheshin përmbrenat; për të parën herë diktova se edhe zemrat ishin ngjyra-ngjyra.

Hana ecte kadalë mbi krye: astronomët rreth telash e vrejshin me turbi të gjata në dorë.

Këto mendonte atë çast poeti, ndërsa kujdesi i atyne që na përcjellshin e na drejtojshin ishte frika e takimit me roje të kufinit, për të cilat s'kishim njoftësi as se sa ishin, as me ç'mjete luftarake ishin të pajisun. Ndoshta edhe ata kishin turbi të gjata në

dorë, për me pá hyjt. E me i vrá!

Gjithnjë na ishim pregatitë për ndeshje me armë. * * At Daniel Gjeçaj/pseudonimi Pal Dukagjini *Si e njofta Martin Camajn*, gazeta *Shekulli*, e shtunë 25 shtator 2010)/ Poezia *Telat me thepa nën hanë*, e cituar nga At Daniel Gjeçaj, është qortuar (disa pak ndryshime të vogla) sipas motërzimit që është në librin *Vepra poetike*, Onufri, 2017, faqe 103. Më lart poezia është sipas librit të Onufrit.

Është një rast i rrallë i dokumentuar, se si Camaj ngjarjen e përjetimet e njëmendëta i shndërron në poezi. Për të parë shndërrimin dhe mënyrën e shndërrimit do të duhet të hulumtohen të përbashkëtat dhe ndryshimet mes fjalëve dhe metaforave të përshkrimit dhe metaforave e simboleve të poezisë, të cilat mund të ndahen:

Në përshkrimin e At Danielit	Në poezi
Fjalë çelës	Fjalë metafora çelës, të njëjta me përshkrimin
<i>hana kufini tela</i>	<i>hana kufini tela</i>
Togfjalësha	Metafora me fjalë të njëjta e të ndryshme me përshkrimin
<i>tela ferrc hana si qëthë hana ma e shndritshme</i>	<i>tela me thepa hana mbi krye hana një rrotull e rrezikshme hana një rrotull... hekuri së skuqun hana ecte kadalë mbi krye</i>
<i>hana në udhtim të vet</i>	
Përshkrimi nuk ka fjalë të tilla gjegjëse me të poezisë	Fjalë metafora të poezisë, pa gjegjëset e tyre në përshkrim
	<i>eshtnat [preksha eshtnat e shpatullavet të mija] trimnohesha përtej njerzija ishte e veshun [përtej njerzija] pa tundime në shpirt kënde/ kënde/ na lákur para njani tjetrit [hanën] me turbí të gjata në dorë</i>
Fjalë e shprehje të përshkrimit, që nuk janë në poezi	Poezia nuk ka metafora gjegjëse të këtyre fjalëve
<i>rruga, e pa rrugë majet e maleve të thepisuna e të bardha në tanë madhninë e vet kristaline roje [mos shiheshim prej rojeve] çast takimi me bukurinë, me naltësitë tmerrësisht madhështore [çaste]</i>	

Fjalët çelës të përshkrimit: *hana, kufini, tela* janë, gjithashtu, metafora e simbole çelës të poezisë. Në përshkrim, ato përcaktojnë tre objekte kryesore. *Hana* u ndriçon rrugën, që nuk dinë, ku shkelin, por shton edhe rrezikun, se mund t'i dallojnë ushtarët. *Kufini* shënjon vijën ndarëse, nëse do shpëtojnë, apo, do të flijohen. *Telat (ferc)* e vështirësojnë, gati, në pamundësi kapërcimin e kufirit. Edhe përjetimet e At Danielit vërtiten rreth këtyre tri fjalëve, mes të cilave, ndërftuen fjalë dhe togfjalësha të tjerë.

Dallimi i poezisë nga përshkrimi nis të shpërfaqet më qartë në fjalët e ndryshme mes tyre. *Telat me ferrc* përngjasohen me ferrën, që të kap e nuk të lëshon. *Hana* sa më e madhe, aq më shumë dritë lëshon. Dhe, bëhet *ma e shndritshme*. Në *qëthë* gatuhet buka, që ushqen jetën. Është perceptim subjektiv për dritën e saj, që i shpëtoi të gjenin rrugën pa zhurmë. Prej At Danielit, ajo është perceptuar dhe i është dhënë kuptim pozitiv, ndihmues.

Hana në udhtim të vet, në përshkrim, objektivizon lëvizjen e saj në rrugën e vet kozmike, pa lidhje psiko-emocionale me përjetuesin. Në poezi, *hana ecte kadalë mbi krye* është perceptim subjektiv i poetit. Ndryshimi bëhet më i madh me ndërftutjen e fjalëve të tjera, si dhe të fjalëve të përshkrimit, që nuk janë në poezi dhe anasjellas.

Poezia mund të ndahet në këto njësi strukturore, metaforiko-simbolike:

I. **Hanë**

- Hanë
- Hanën mbi krye
- Hanën një rrotull e rrezikshme
- Hanën një rrotull... hekuri së skuqun
- Hana ecte kadalë
- Hana ecte mbi krye


II. **Telat me thepa**

- Telat me thepa
- Telat me thepa, kufini i botës

III. **Astronomët**

- Astronomët rreth telash
- Astronomët e vrejshin (hanën)
- Astronomët e vrejshin (hanën) me turbí të gjata në dorë.

IV. **Kufini**



- Kufini
 - Kufini i botës
 - [Telat me thepa], kufini i botës
- V. **Vendi, bota, hapësira e njerëzimit**
- [Bota] përtej
 - [Bota] përtej njerzija ishte e veshun
 - [Bota] përtej njerzija ishte pa tundime në shpirt
 - [Bota] kënde/
 - [Bota] kënde/ na lákur
 - [Bota] kënde/ na lákur para njani tjetrit

VI. **Koha**

- Kur

Objektet e jashtme, të simbolizuara, të mjedisit e të rrethanës, që e “objektivizojnë” lëndën e poezisë, janë të pakta: *hana-* në qiell, *telat me thepa-* në tokë, *kufini i botës, përtej dhe kënde/ astronomët, turbi të gjata*. Thuktia e fjalëve, që shenjojnë këto simbole objekte, nëpërmjet sintaksës strukturore bart një lëvizje mendimi dhe ndjesish prej tokës në qiell, si të gjallërohej një lëvizje kozmike.


Ndajfolja kohore, *kur*, ndryn gjithë kohën e asaj ndodhie, të cilësuar *s’mund ta harroj*, pa shenja konkrete, të rrethanës e të mjedisit, me përjashtim të *hanës*, metonimi simbolike e natës së njëmendët. Ndonëse, *kur*, aktivizohet vetëm një herë, mbetet nyja mbi të cilën është varur tërësia e domethënies. Nëpërmjet elipsës, kuptimisht, ajo është e barazvlefshme në krye të çdo njësie të sintaksës strukturore, që shpreh kohën.

Hapësira diegjetike, që përfshin ligjërimi lirik, është e përcaktuar me simbolet ndajfoljore të përgjithshme: *kënde/ dhe përtej. Kënde/* është hapësira në të cilën veprojnë subjektet, në shumës- *na [kënde/ na lákur para njani tjetrit]*. Mes tyre edhe subjekti lirik, njëkohësisht autori. *Përtej* është hapësira tjetër, skajshmërisht kontrastuese (*kënde/ na lákur/ zbuluar/ përtej njerzija veshun*) Ligjërimi i tij, gati, bashkon hapësirën njerëzore-tokën, me kozmosin- hënën, apo, qiellin, duke kaluar sa nga njëra të tjetra. Ndryshe nga shtrirja tokë- qiell në vazhdimësi, hapësira e jetës njerëzore është e ndarë. Dy ndajfoljet vendore, *përtej dhe kënde/*, simbolizojnë përballjen e dy botëve të kundërta në mënyrën e të jetuarit dhe marrdhëniet e brendshme me njëri tjetrin. Ndarja është me *telat me thepa*, ndalim-komunikim i plotë dhe i dënueshëm. *Përtej njerzija ishte e veshun e pa tundime në shpirt*. Ndodhia, që s’mund të harrohet, është përjetuar *kënde/*, aty ku, *na lákur para njani tjetrit*.

Në poezinë *Telat me thepa nën hanë*, vargu i parë është *S’mund ta harroj [hanën mbi krye]*. Fillon me pamundësinë e të harruarit të asaj, që ka ndodhur, e ngritur në sipëroren absolute, në të cilën, zakonisht, ngjiten, ose, ndodhitë shumë të gëzueshme, ose, tmerrësisht të këqia. Ky varg, sikurse të pesëmbëdhjetë vargjet e saj, ka për bërthamë shprehjen e përdorur prej Camajt në letrën drejtuar At Daniel Gjeçajt *a ka mbetë kush gjallë prej atyne me të cilët kemi kalue kohët e vështira? Mner!* Pikëçuditësja shenjon shkallaren e lartë të rrezikut që kanë përjetuar.

Ligjërimi është në vetën e parë, i cili i ka hapur rrugë subjektivit lirik për t’u njësuar me vet autorin. Në dukje nuk vërehen të dhëna aubiografike të tij. Disa objekte simbolike të rrethanës dhe të mjedisit, me domethënien e tyre, shpien drejt një lloj përcaktueshmërie, duke të afruar me të dhëna të biografisë.

Hana, ndonëse është përdorur dy herë, është simboli më aktiv, gjithashtu, aktivizues e zotërues, që u jep vlerë edhe domethënieve të metaforave dhe të simboleve të tjerë. Në gjysëmvargun *hana mbi krye* është fsahirë largësia kozmike. Ajo është zbritur fare poshtë, rri mbi krye, sipas gjedhes frazeologjike *i rri tjetrit mbi krye* (për ta mbikqyrur), *i rri rreziku mbi krye*. Objektet simbolike, që e bashkëshoqërojnë në sistemin figurativ, pasurojnë domethënien e rrezikut



e të rrezikshmërisë, madje e konkretizojnë fjalshmërisht *hana një rrotull e rrezikshme*. Më tej, zhvillohet në rrezik, që vjen prej hekuri të skuqur: *hana një rrotull... hekuri së skuqun*. Dikur qe damkë shenjë në trupin e skllevërve për t’i dalluar prej qytetarëve të lirë. *Hekuri së skuqun* ndërmend edhe plumbin e mundshëm, që mund të hanin nga pushka e ushtarëve.

Hana mbi krye mbart rëndesë të madhe psikologjike, ndezjen e llampës së kushtimit në trurin e tronditur. Gjendja është pa lëvizje. Në vargun tjetër, *Hana ecte kadalë mbi krye*, nis lëvizja, ecja, por ngadalë, perceptim subjektiv i poetit. Njëmendësisht, ajo ecën me shpejtësinë e vet kozmike. Janë përjetuesit, me ta dhe poeti, që, për shkak të rrezikut mbi kokë, që pritët nga çasti në çast, ritmi i ecjes i u duket i ngadaltë. Përqasur me përshkrimin e At Danielit, mund të thuhet, se *hana ecte kadalë* është metonimi e lëvizjes së ngadaltë të klandesitëve për mos të bërë zhurmë. *Hana*, në vargjet: *Hana mbi krye, hana një rrotull e rrezikshme, .. një rrotull hekuri së skuqun, hana ecte kadalë mbi krye* është perceptuar dhe ka marrë doemthënie negative, rreziku i përhershëm mbi krye të jetës. Ka të ngjarë, që, në mendjen e Camajt, hana me ndriçimin e saj, në ndodhinë e njëmendët për të kapëcyer kufirin, rriste mundësinë e zbulimit prej rojeve. Frikën dhe ankthin mishërojnë edhe vargjet antitetikë: *Preksha eshtnat/ e shpatullavet të mija, të ngurta/ e trimnohesha*. Elipsa e *trimnimit* ka në skajin e vet të kundërtën, e pashenjtuar- *frikën, ankthin*.

Pse gjendja pa lëvizje dhe gjendja në lëvizje, në poezi, është e ndërvanur prej hënës?

Një nga shndërrimet figurative tjetërsuese janë rojet e simbolizuara në astronomë. Logjika figurative zhvillohet mbi bazën e funksionit të tyre të njëjtë: shikimin, vëzhgimin, si dhe të mjeteve, që përdorin. Rojet e kufirit vëzhgojnë me dylbi, në tokë, mos kalojnë klandestinë. Astronomët me tejkqyrë vëzhgojnë trupat qiellorë. Objekti i vëzhgimit të rojeve, klandestinët, në se ato i qëllojnë me armë, do ngjiten në qiell. Sublimim poetik i tyre. Këmbimi i rojeve me astronomët ka edhe domethënien e vëzhgimit të tyre të jashtëzakonshëm, zhbirimin në largësi tejet të mëdha, përfutur nga ndjenja e madhe e rrezikut qeniesor, që ka ndërë njëmendësisht Camaj në atë rrethanë.

Në poezi, edhe pse është ndryrë një ndjeshmëri e madhe subjektive e subjektivizimi nëpërmjet njësimi të poetit me subjektin lirik, është tepër e vështirë të dallohet në të ndodhia vetjake e njëmendët, tanimë, e dokumentuar. Megjithatë, në vargjet: *Preksha eshtnat/ e shpatullavet të mija, të ngurta/ e trimnohesha* subjektivizmi theksohet në një mënyrë më vetjake. Pasiguria i ka pushtuar qenien. *Prekja e eshtnave e trimnon*, duke e bindur, se, ende, është e mund të dalë i gjallë. Një gjendje e tillë psikologjike ankthi qeniesor/ekzistencial është pasojë e atij *mneri*, që kujton, në letrën e lartpërmendur, nga endja e tij nëpër male, në rrugë pa rrugë, nën syrin vrojtues të ushtarëve.

Përjetimi, rrafshi i përbashkët i letërsisë dhe i fesë

Letërkëmbimin më të shpeshtë e ka pasur me klerikë dhe njerëz në shërbim të fesë katolike për të cilët kishte vlerësimin dhe nderim më të madh.

I lindur në familje katolike, në Malësinë e Dukagjnit, ndoqi mësimet e mesme në *Kolegjin Saveriane*, në Shkodër, me sistemin pedagogjik të Urdhërit të Jezuitëve. Formimi dhe edukata katolike ishte rrënjosur prej fëmijërisë dhe adoleshncës, të cilat i ndërmend edhe në vitet e mbrame të jetës, me ndjenjën e mirënjohjes së thellë ndaj atyre “*që na edukuen e na dhanë*



kulturën e ndjenjën humanitare”./ 3. 12. 1989/Fort i dashtuni Pater Danjel; “*na kanë bà njerëz të cilit i falnderoj dhe pozitën e dijen që kam sof*” /**München 27 marc 1991**/I dashtuni Gjon, megjithse...

Edukata, kultura dhe ndjenja humane jo vetëm ndjehen, por edhe janë mishëruar në trajta të ndryshme, në poezinë dhe prozën e tij, sidomos humanizmi i konkretizuar në anësinë e përhershme ndaj të pambrojturve, sikurse është shpjeguar më lart.

Tradita gjuhësore gege e teksteve fetare, që studionte, *Meshari* i Gjon Buzukut me të cilin doktori, përkthimi prej tij i psalmeve, ishte një lidhje tjetër e fortë kulturo-shpirtërore me klerikët katolikë.

Më tepër se feja, me ta e lidhte intimizmi miqësor, interesimi për kulturën në mërgim, revistat, librat, që botoheshin, pasi ata ishin studiues të gjuhës, letërsisë, kulturës shqiptare. Me njërin syresh, At Daniel Gjeçajn, i cili ishte në grupin e malsësorëve që u arratisën, pati lidhje shpirtërore të veçantë. Njohja në ankthin e rrezikut më të madh për jetën u shndërrua në miqësi e mirëbesim të plotë, në komunikim të sinqertë. Atij i tregonte pengesat, shqetësimet, arritjet si në një rrëfim para Atit. Këshillohej sa herë kërkonte të gjente një rrugëdalje nga vështirësitë. Në kujtimet e tij, At Danieli përshkruan edhe qëndrimin e Camajt ndaj fesë: “*Martini, megjithëse i edukuem ndër jezuit, rrallë e gati kurr merrte pjesë me grupin e uratës. Duket se koha e shkurtë e mësuesisë ndër male, e kishte ndërrue diametralisht jetën e të riut në drejtimin e fesë. Gjithnjë Martini s’ishte as kje kurr anmik i deklaruem i katolicizmit as i moralit kristian.”/ * * Shekulli, 25 shtator 2010.*

Camaj, ndryshe nga përshkrimi i Atë Danielit, ka qenë vazhdimisht i interesuar për fatin tragjik të klerit katolik në Shqipëri, madje dhe për mbajtjen gjallë, aq sa ishte e mundur, të kishës, në diasporë si qendër e bashkimit dhe e ruajtjes së identitetit të shqiptarëve.

I ndërgjegjshëm për rolin e pazëvendësueshëm, që ka feja në psikologjinë njerëzore, në moralin, edukatën, ruajtjen e virtyteve, i ka kërkuar me këmbëngulje ministërpresidentit të Bavarisë Jozef Shtraus / Joseph Strauss/ të ndërhynte, duke i vënë kushte Tiranës, për të ndaluar përndjekjet ndaj klerikëve.

“*Krejt programin e ministërpresidentit të Bavarisë në lidhje me të dy vizitat në Shqipni kanë qenë të përgatituna prej zyrtarësh që kanë studiuë albanologji tek unë. Para udhëtimit të dytë jam takue edhe unë me Straus... ku i jam lutë me duer të ngjituna që të intervenojnë për klerin katolik shqiptar dhe të vëjej si kusht në traktatet për vumjen e marrëdhanjeve diplomatike. Mâ parë isha shprehë kundër këtyne marrëdhanjeve, si këshilltar, natyrisht.” * * München 27 marc 1991*/I dashtuni Gjon, megjithse...

Vërejtjet në qëndrimin ndaj fesë, sado të vogla, që kanë qenë, nuk i ka pranuar asnjë herë. I ka kundërshtuar, me argumente nga veprimtaria “nën rrogoz”, “pa u ndjerë” dhe me fakte nga vepra letrare. Mikut të afërt, Gjon Sinishtës, për vërejtjen, se, “*ti nuk e përmend emnin e Zotit në poezinë tande*” i përgjigjet: “*Nuk të kam kundërshtue, por kam ra në mendim. Kam pasë disa periudha krijimi; sidomos mbas 1967 kur nis periudha abstrakte apo ajo mâ e kapërthymja: fund e maje vepra ime ka Provaninë e Perendisë mbrendë. Palimpsest, shkruie në dy vjetet e fundit, sos me tematikë mistike.” * * München 27 marc 1991*/I dashtuni Gjon, megjithse...

Shkrimtari dhe besimtari në qenien e Martin Camajt janë të barabartë, sepse, në mendësinë e tij, letërsia dhe feja janë, në të njëjtin rrafsh. Shkrimtari, sikurse besimtari te Zoti, ka besim absolut te forca e jashtëzakonshme e letërsisë, që

(Vijon në faqen 9)

Diktatori në kryq: kështu titullohet libri i ri i Mira Meksit, njëra ndër shkrimtarët më të çmuara të panoramës letrare shqiptare të tanishme, i botuar nga A&B Editrice, 2023, me përkthimin e Giovanna Nancit.

Faqet e para

Diktatori qëndronte në këmbë dhe sodiste detin. Ishte i veshur në mënyrë të çuditshme, me një tunikë të bardhë tejte të gjatë, një kapelë partizani me yllin pesëcepësh që i spikaste mbi ballë. Ecte brenda detit, ndërkohë që frynte një erë e fortë, e cila i ngriti ujërat si male përpetë, sa që ndjeu rrafshin prej rëre të funddetit. I mjaftoi një gjest, lëvizja e krahut, që deti të hapej e të dukej toka. Ujërat u ndanë që njerëzit të ecnin pas figurës së veshur me të bardha.

Kishte një stap në dorë, fuqia e tij, udhërrëfyesi i tij, kur, duke kthyer kokën pas, vuri re se ishte i vetëm, se nuk ishte askush prapa tij. Tronditja iu shndërrua pothuaj në tmerr: e megjithatë qëllimi i tij ishte të printe popullin e tij drejt së ardhmes së ndritur. Çfarë po ndodhte? Vuri dorën mbi ballë, i befusuar, vërejti se nuk kishte më kapelen partizane, por trupin e ftohtë dhe të qullët të një kandili deti që i mbështillte kokën.

Ishte vetëm një ëndërr, nga e cila diktatori u zgjua i mbytur në djersë të akullta. Por të qenit i vetëdijshëm zgjati shumë pak: bota e ëndrrave nuk vonoi t'i rimarrë arsyen për të çuar serish trupin e tij në ujërat, kësaj here jo të detit, por të një lumi. Ishte i veshur akoma me tunikën e bardhë, kur iu desh të binte në gjunjë para një njeriu, i cili i hodhi ujë mbi kokë, duke i dhënë një ndjenjë lehtësie, gati shpëtimtare.

Ishte sikur të ndihej i çliruar nga të gjitha ligështitë e kryera: ishte sikur të ishte bërë, papritur, biri i Atit. Ai njeri, i cili e kishte lehtësuar nga të gjitha vuajtjet, kishte sigurisht fytyrën e Pagëzorit, për këtë ishte i bindur. Por ja, sytë e tij i treguan diçka tjetër: panë fytyrën e Stalinit, jo me tiparet e tij të natyrshme, por në gjithë shëmtinë e tij. Nuk mundi të bënte gjë tjetër, veçse të zgjohej e të largonte dëshirën për të fjetur.

Ajo që më shumë e frikësonte ishte ëndrra e parë, sepse më të vërtetë ngjante sikur të paralajmëronte të ardhmen, ndërsa e dyta, ndoshta, nuk kishte asnjë peshë: në thelb, Stalini ishte pjesë e së kaluarës së tij. Patjetër, i kishte thur lavde revolucionarit sovjetik, e kishte mirëpritur kur gjithë bota e kishte izoluar. E kishte adhuruar dhe kishte ndërtuar një sistem qeverisës, që dukej i bazuar mbi parimet staliniste, por që në realitet vërtitej rreth një figure të vetme, asaj të njeriut, të Atij vet. A nuk duhej vërtet të merrej parasysh ëndrra e fundit? Ishin dy pamje të ndara apo ishin në ndonjë mënyrë të ndërlidhura? Nuk mundi të mos mendonte për Pagëzimin dhe për atë që e kishte pagëzuar. E kotë të kishte ende iluzione: fundi ishte tanimë i afërt.

Rreth dhjetë vjet më parë kish pësuar dy infarkte, të cilat e kishin dobësuar mjaft. Ndër të tjera, jetonte me tmerrin se i kishin vendosur në kraharor një bombë me sahat, e cila mund ta bënte copa-copa nga çasti në çast. Ishte një njeri i sëmure dhe kjo ishte e pamohueshme: kishte diabet; përveç kësaj, përpara një viti, një problem cerebral ia pati bllokuar këmbët gati për një muaj, ia pati turbulluar gjykimin dhe e pati bërë të çaprashiste fjalët. Nga ajo kohë, i shihte të tjerët me dyshim sepse ishte i bindur se nuk po i tregonin të vërtetën.

Intriga e romanit

Në ditët e fundit të jetës së tij, diktatori ripërshkon tërë ekzistencën e tij, duke u përqendruar tek episodet më domethënëse, ato që e kanë shenjuar më shumë. Pra, në romanin *Diktatori në kryq*, Mira Meksi rrëfen, nëpërmjet kujtimeve të njeriut, për Dashurinë që ai ka përjetuar, për fëlligëshitë që ka bërë, tmerrin që ka qenë për njerëzit e tjerë. Diktatori nuk dorëzohet dhe kërkon një formë tjetër shpëtimi, një tjetër mundësi

Shënime për botimin në italisht të "Diktatori në kryq"

DITËT E FUNDIT E DIKTATORIT NË LIBRIN E RI TË MIRA MEKSIT

Nga Anna Latanzi

jete në tokë, nëpërmjet Ashklës së Shenjtë të Ringjalljes, ndërsa përgatitet të vdesë. Shkrimtarja rrëfen për rrënjët pagane të kishës së Hyjlindjes në Labovën e Kryqit, për origjinat e lashta të gjuhës shqipe, duke zbuluar misterin e “Graalit të Shenjtë”, i cili përfaqëson shpresën e shpëtimit të njerëzimit.

Përtej personazhit

Mira Meksi prezanton diktatorin në mënyrë unike dhe origjinale, krejtësisht ndryshe nga mënyra si ka qenë paraqitur gjithmonë. Shkrimi i rrjedhshëm dhe i kthjellët nuk e zvogëlon kuptimin e thellë të tekstit dhe kompleksitetin e analizës që rrjedh prej tij. Në pamje të parë, mund të duket se figura e diktatorit është thelbi i romanit, por në realitet ajo përbën vetëm një pjesë të asaj që shkrimtarja ka dashur të rrëfejë.

Ai përfaqëson motorin e narracionit, që lëviz në një botë shumë më të ndërlikuar dhe të artikuluar, duke hyrë në lidhje të ngushtë me personazhin e tij. Me fjalë të tjera, vepra shkon përtej profilit të njeriut të përshkruar me kthjelltësinë e detajeve: *Diktatori në kryq* nuk është një roman mbi diktatorin. Struktura e tij, në thelb, përbëhet nga tri pjesë: ditët e fundit të tiranit; përpjekja për të vjedhur kryqin, që mban ashklën e drurit të shenjtë që i përkiste Kryqit të Krishtit, për kthimin në jetë; dhe zbulimi i misterit të kishës së Labovës, në skutat e saj më intime.

Pjesët përzihen, ndërlidhen dhe krijojnë diçka që shkon përtej historisë së rrëfyer, duke mbartur një mesazh me aromë

universale. Mira Meksi përpiqet të tërheqë lexuesin në një dimension kuptimshmërie që shkon përtej vet leximit, i cili është në vetvete shumë pozitiv; bën një përpjekje të arrirë për ta çuar atë në një dimension që ndjell emocione të fuqishme, duke i ofruar lexuesit nxitje reflektimi që largohen nga objektiviteti, për të arritur te një interpretim vetjak të mendimit, të njohjes dhe të veprimit njerëzor, në sferën absolute dhe ekskluzive të procesit historik.

Diktatori si të gjithë

Që kur s'mbahet mend, njeriu përpiqet t'i kundërvihet vdekjes, ta tejkalojë momentin me anë të rilindjes, të ringjalljes: është diçka që përpiqemi ta zbulojmë që nga kohërat e Ringjalljes së Krishtit. Në roman vihet në dukje se sa shumë kjo dëshirë njerëzore është e përhapur, duke u bërë antiteza e konceptit të mëkatit.

Këtu ndërhyjnë sarkazma e përdorur nga Mira Meksi, jo aq për të paraqitur figurën e diktatorit, se sa për ta shkatërruar atë, sepse autorja, duke përshkruar ankthin, paranojat dhe frikën e tij për t'u gjykuar, ndonëse ngadalë, e shpërbën njeriun, personin dhe veprimet e tij, si edhe çdo formë mëshire që mund të ndihej ndaj tij. Aftësia introspektive e penës së saj është e madhe, duke arritur të depërtojë thellësisht te personazhi dhe në realitetin e tij, nëpërmjet paraqitjes se shqetësimeve, të ëndrrave të llahtarshme, të tmerreve dhe të nevojës që në rikthim gjithçka të jete ndryshe.



Të jetë e qartë: nuk dallohet asnjë shenjë pendimi nga ana e diktatorit. Gjithçka tek ai është vetëm tmerrri dhe fobia nga dënimi. Prandaj, Meksi i jep personazhit karakteristikë universale, që mund t'i jepen cilitdo në krye të një regjimi totalitar, duke skicuar një profil tragjik, emblemë të kundërvënies që e helmojnë, mes përgatitjes së tij për vdekjen dhe vullnetit për t'u kapur pas jetës, mes dëshirës për të pasur dashurinë pranë dhe vullnetit për t'u arratisur.

Në një çast del në dritë synimi i angështuar për ta rikthyer dashurinë, por pabesia e tij, që ka qenë forma e tij e të qenurit, e njeriut që u ka bërë të këqia njerëzve të tjerë, e ka tradhtuar, e ka goditur, dhe me gjasë do të bëhet shkaktari i vdekjes së tij, sepse vetëm dashuria mund të përcaktojë kthimin në jetë. Ky është momenti në të cilin diktatori, i cili përfaqëson çdo diktator, lan hesapet me realitetin brutal të ndërtuar prej atij vet. Një njeri që ka mbjellë vetëm kob, urrejtje, mllef, ligësi, që ka vvarë, torturuar, burgosur, a mund të ketë fuqi mbi Kryqin e Shenjtë aq sa të rikthehet në jetë?

Albanologu Guttenberg

Albanologu është shprehja e interesit që shumë studiues kanë dëshmuar ndër vite ndaj gjuhës dhe kulturës shqiptare dhe jo vetëm. Hulumtimi mbi historinë e themelimit të kishës së Labovës nuk është vetëm një temë që rezulton shumë interesante, por synon të jetë një rikthim në epokat që datojnë shumë shekuj më parë.

Pjesa e romanit kushtuar studimit dhe kontributit të tij, vishet me magji të ndritshme. Lexuesi përkëdhelet me fjalë të pasuruara me domethënie historike dhe njëkohësisht emblemë të një bote të shuar, të mistershme, të magjishme, e cila, nga njëra anë lidhet me pjesët e tjera të romanit, por nga ana tjetër del në pah emocionalisht. Meksi krijon një personazh imagjinar, në të cilin faktet studimore dhe fantazia arrijnë një baraspeshë të përsosur.

Në këtë roman dallohet gjithashtu vullneti i autores për të mos i lënë asgjë rastësisë, përkundrazi ofron nocione të dokumentuara me një përsosmëri ekstreme. Del në dritë, pra, një libër me sfond historik, i ngarkuar me simbolikë, përveç realitetit të gjallë. Një prej simboleve më autentike dhe njëkohësisht i egër, është ashkla e shenjtë e ruajtur brenda Kryqit, si simbol i sakrificës, të cilën askush nuk arrin ta kapë, sepse duhet të jesh i denjë për të, dhe diktatorët, ndonëse kanë pushtetin, nuk kanë fuqi përballë gjithë kësaj shenjtërie.

Në fund...

Romani i Mira Meksit është përqendruar te njerëzimi, te gjendja e tij shpirtërore, te humbja e besimit dhe te rigjetja e tij, te ndjenja e tij për Dashurinë e humbur, te nguti për të rifituar një prej ndjenjave njerëzore më të mëdha dhe te dëshira, tanimë e kthyer në domosdoshmëri, për të kryer një veprim shpëtimtar ndaj ekzistencës së vet. *Diktatori në kryq* është një libër intrigues, i rrjedhshëm, pasionant, i fuqishëm dhe thellësisht realist.

Përktheu: Giovanna Nanci



E MARTË 24 TETOR

NË ORËN 18.00,

EUROPE HOUSE,

RRUGA PAPA GJON PALI II

Con altre parole

BISEDË ME

ANILDA IBRAHIMI



Instituti Italian i Kulturës, në bashkëpunim me Europe House Albania, ka kënaqësinë të prezantojë takimin e katërt të ciklit **Con altre parole**, seri takimesh dhe bashkëbisedimesh me zërat më interesantë të narrativës italiane me prejardhje shqiptare.

Për takimin e katërt e ftuar do të jetë shkrimtarja **Anilda Ibrahimi**, e cila do të dialogojë me Profesoreshë Diana Kastrati, Drejtor ekzekutiv e QSPA – Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët dhe, prej vitesh, përkthyes e vlerësuar nga italishtja në shqip. Bashkë me të, Doktor Fabio M. Rocchi, Studiues pranë QSPA dhe Pedagog pranë Departamentit të Letërsisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Tiranë, autor i monografisë kritike *Le prime voci dell'italofonia albanese*.

Anilda Ibrahimi ka lënë Shqipërinë në moshë shumë të re, në vitin 1994, për t'u transferuar fillimisht në Zvicër, e më pas, në mënyrë përfundimtare, në Itali, ku zgjodhi Romën si vend për të jetuar. Në romanet e saj – jashtëzakonisht vitalë e të dominuar nga individualitete femërore origjinale e vibruese –, takimi mes rrënjëve shqiptare dhe historisë evropiane të dekadave të fundit rezulton gjithmonë e më i ngutshëm, nga rrëfimi në rrëfim, derisa arrin të analizojë evolucionet e shoqërisë italiane të fillimit të mijëvjeçarit në librin e fundit, *Volevo essere Madame Bovary*, i publikuar nga Einaudi në vitin e afërt 2022. Gjithmonë me shtëpinë botuese Einaudi – si dëshmi e një marrëdhënieje aq cilësore sa edhe të gjatë me shkrimin – Anilda Ibrahimi ka publikuar: *Rosso come una sposa* (2008), *L'amore e gli stracci del tempo* (2009), *Non c'è dolcezza* (2012) dhe *Il tuo nome è una promessa* (2017).

Deri më sot, asnjë nga librat e saj nuk është përkthyer ende në shqip, megjithatë, një projekt i ri sugjeron që në të ardhmen skenari mund të ndryshojë.

(Vijon nga faqja 7)

ka qenë jeta dhe qëllimi i saj. “...jam letrar obsesiv dhe për ndamjen e artit nga manipulimet facioze politike Mos më përzieni në politikën e vogël “të katundit” e mos të ndiqen modelet komuniste të politizimit të letërsisë; arti e feja e përjetueme janë pronë e individit, të njeriut. Ndoshta janë fjalë të mëdha, por unë besoj në to.» * * **Lenggries 1. prill 1991**/Gjon i dashun... Në këtë shprehje arti letrar është ngritur në shkallaren e epërme, të besimit të feja, dhe anasjellas, feja është ngritur në shkallaren e mrekullisë shpirtërore shndërruese të letërsisë. Barazvlershmëria e tyre është përjetimi emocional, përtëritja shpirtërore, e drejta vetiake, privatësia e të dyjave, mos ndërhyrja në to e askujt.

Lexuesi model, i papranishëm

Lexuesit e veprës së Martin Camajt, deri në gjallje të tij, kanë qenë fare të paktë. Mendimin e tyre, gojarisht a nëpërmjet letrave, vetëm në disa raste ka mundur ta dijë. Po ashtu, edhe vet, kur e kanë pyetur me këmbëngulje, është përgjigjur me kursim. Sado të kursyera, mendimet e tij për marrdhënien autor-lexues, vepër-lexues, duket qartësisht, se, janë të përfutuara prej teorisë moderne bashkëkohore, të receptimit, natyrisht, edhe prej përvojës krijuese vetjake

Në letrat e tij gjenden terma të tilla: *perceptim, dialog shkrimtar-lexues, autor-lexues, reagim, momenti recipitiv*, të teorisë së receptimit, përpunuar në Gjermani, në vitet 1960-1970 nga Hans Robert Jauss, Wolfgang Iser, etj., që u përhap, në Europë dhe në botë, me përplotësim e degëzime të saj.

Rëndësi parësore i jep dialogut shkrimtar-lexues, jo thjesht në kuptimin e bisedës, ndërkëmbimit të mendimeve, por të “dialogut” të drejtpeshimit, të afërsisë kulturore mes tyre. Me këtë, edhe pse nuk e emërton fjalshëm, ai flet për lexuesin model, të cilin e dinte, që nuk ishte i pranishëm në horizontin e pritjes. “a) *Në botën shqiptare, përgjigjet në një letërkëmbim, nuk asht gjetë ende drejtpeshimi mes shkrimtar – lexues: s’ka djalog të kënaqshëm dhe për këtë duhet kohë shumë; na të dy këtë s’kemi për ta përjetue. b) Realizmi e shkatërroi lexuesin shqiptar; realizmi asht mjet propagandistik.*” * * **Lenggries 8. 5. 80**/I dashun Ndok Sinishtaj, sot mora letrën tande...

Drejtpeshimi mes shkrimtar- lexues, pa metonimi, do të thuhet drejtpeshimi vepër- lexues. Edhe “dialogu”, marrveshja e mirëkuptimi, është mes tekstit dhe aftësive të lexuesit për të aktivizuar sa më shumë nga domethëniet e tij. Ankohet, se, *Në botën shqiptare s’ka djalog të kënaqshëm*. Ndryshimi i madh mes tyre, në shkallaren kulturore e letrare, nuk e mundësonte. Mosmarrveshjen, dialogun e pakënaqshëm mes tyre, prapambetjen dhe njanshmërinë, e shpjegon, konkretisht, në një letër tjetër, me shkaqe shoqërore të të shkuarës dhe të bashkëkohësisë.

“Konceptioni im ka qenë e asht ky: Shqiptarët që kanë fillue me lexue vonë, si thoni ju, janë të mësuem të lexojnë sende të drejtimit realist e sentimental. Asnji nesh, shkrimtar apo lexues, s’e kemi gjetë ende kohën të rëmojnë pak ma thellë “mbi qenien tonë dhe mbi tjerët”. Për këtë na kanë mungue shumë kushte. Mbas luftës së dytë botnore – dhe duhet pranue – mbasi që mësuem të mbledhim gerrat (Buzuku e ka “mbledh” për “lexoj”) qemë të shtrënguem të lexojmë sende e slogane propagandistike. *Realizmi social: kurrfarë ndryshimi mes artikullit të gazetës e të prozës artistike.*” * * **Lenggries 3. 1. 79**/I dashuni Idriz Lamja, e mora letrën tuej...

Historikisht, shqiptarët, deri vonë, kanë pasur arsimim tepër të kufizuar, vetëm disa shtresa dhe kategori shoqërore të caktuara, për pasojë, lexuesit kanë qenë edhe më të kufizuar. Me një arësimim, kryesisht, të ulët, dhe, në një masë të vogël, të mesëm, ishin të njanshëm, të pa përgatitur për pëlqime të ndryshme. Në periudhën bashkëkohore të arsimit masiv, u detyruan të mësohen me pëlqimin e realizmit socialist, duke ruajtur dhe pëlqimin tradicional, realist dhe sentimentalist.

Në mërgim, vëren, se, pëlqimi letrar i tyre ka mbetur po ai, që kanë pasur në atdhe, vite të shkuara, ndonëse, jetojnë në mjedise me kulturë. Njëmendësisht, kultura letrare e lexuesve në diasporë ishte larg prej një shkrimtari të tillë dhe veprës së tij moderne, të abstraksioneve metaforiko-simbolike. Intelktualët e mirëfilltë, me përjashtime të rralla, ishin me formim klasik. Ndonjëri prej tyre, që bënte vërejtje, nisej nga pritja e formimit të vet, e cila nuk përputhej me mënyrën e leximit, që projektonte tekstin.

Prandaj, lexuesin më të plotësuar e gjen në Kosovë e Shqipëri. “Me fjalë tjera unë po e shoh se lexuesit qenkan andej sidomos në Kosovë e jo këndej.” * * **Lenggries 3. 1. 79**/I dashuni Idriz Lamja, e mora letrën tuej të gjatë dhe urimet për festa...

Mirëpo, në një letër tjetër, bie në kundërshtim me këtë pohim. Pavarësisht nga vlerësimet e larta, që i shkojnë nga Shqipëria (1991), nuk beson, se lexuesi i formuar ideologjikisht dhe nën trysinë e dogmës letrare, do ta kuptojë veprën e tij. “... më janë sjellë plot intelektualë nga Tirana e sidomos

asish që kanë studiue në Prendim, jo si njeri politik, por si letrar. Thonë se ky drejtimi im, kryekreje lirika sepse deri tash vetëm nga kjo degë kanë lexue diçka, do të përgjithësohet në Shqipni. Si asht natyra ime unë jam skeptik: njoh vlerën e veprës sime e se ajo asht fort e vështirë të kuptohet nga njerëz të rritun në stalinizëm” * * **Lenggries 1.prill 1991**/Gjon i dashun...

Ankesën për vështirësi receptimi të atyre, që nuk kanë kulturën e domosdoshme, e shpërfill.

Para se të ankohen, u këshillon, të *nxejnë* për t’u ngritur në shkallaren kulturore. “*Natyrisht se lexuesit tanë (sado pak këtu jashtë) nuk janë mësue me lexue shkrime të tilla. Mirë po unë nuk mundem me shkruie me urdhën që të më kuptojnë të gjithë e shpesh njerëz që nuk ia kanë ba sherbimin punës për të mësue se çka ashtë arti. (Pa marrë parasysh shkallën e kulturës këto vepra i kuptojnë ata që dinë shqip).*” * * *Shënime të përgjithshme – mbi Varg librash letrarë*/.

Duke e pranuar vështirësinë e receptimit, sidomos të poezisë, jep shpjegimin. Ai nuk mund të shkruante ndryshe, ta zbriste atë nga majat e abstraksionit, as ta shmangte nga gjedhet e modernizmit. Një arsye bazore, e njëmendët e “vështirësisë” të të kuptuarit ishte kultura jo e ngritur e pjesës më të madhe të lexuesve, të mësuarit e tyre me poezinë tradicionale të metaforave të drejtpërdrejta e të një proze të realizmit klasik, aq më keq me gjedhen tkurrëse të realizmit socialist. Theksin e vë edhe te një dukuri më e thellë, te mosnjohja, pikërisht, e kulturës, apo, trashëgimisë kulturore shqiptare, mitet, legjendat, ritet tradicionale të shkrira në të, me të cilat ka ngjizur e konturuar linjat kryesore të saj. “*Kuptimi i veprave të mia*, shpjegon, *vështirësohet edhe nga rrethana se lexuesit shpesh nuk e njohin këtë kulturë apo pajë shpirtnore shqiptare.*” * * *Shënime të përgjithshme – mbi Varg librash letrarë*.

Arritjen e drejtpeshimit dhe të dialogut të kënaqshëm e shikon si proces historik, madje të gjatë: *Për këtë duhet kohë shumë*, me kalim brezash. Autorë të shquar, modernë avangardë, sidomos të shekullit XX, edhe në letërsi të tjera, lexuesin e fituan dalëngadalë, me kalimin e kohës. Brezat e mëpasëm, me shkallare më të lartë, i rivlerësuan, duke zbuluar anë të reja të veprave të tyre, të pa aktivizuara më parë. Edhe veprës së Camajt, pas 1990-s, lexuesit iu afruan ngadalshëm, pak e nga pak, krahas emancipimit botëkuptimor, njohjes së letërsive të gjuhëve të tjera dhe të teorieve moderne bashkëkohore.

Në shkrimin *Rrëmime mbi poezinë*, në hyrje të vëllimit me lirika, që u botua për herë të parë në atdhe, duke qenë edhe takimi i parë i këtij lloji me lexuesin pas rreth dyzet vjetësh, i detyruar moralisht, ka paraqitur disa të dhëna për poezinë e vet. Megjithatë, sqaron, që në fillim të shkrimit, se *syzimi i tij ... nuk qëllimon t’i paraqesë vetveten lexuesve*. Nga një paraqitje e tillë ndihej keq emocionalisht, sepse nuk i a lejonte etika e modestisë. Rrëfimi për poezinë e vet, i ngjante, se zbulonte diçka intime, që duhej mbajtur e fshehtë, siç mbahen ndjenjat më të thella. I dukej me pasoja edhe në subjektin krijues, edhe në poezi: “*po humb “fillin e gjetun”, drejtpeshimin e krijimtarisë*”.

Shkrimtari, sipas tij, ka vetëm një mënyrë për t’u paraqitur te të interesuarit- nëpërmjet veprës, e cila është portreti më i plotë dhe më i natyrshëm. Madje, për t’u ballafaquar, edhe para vetes, të vejë veprën. Përballja me të flet më saktë dhe më shumë.

Shpjegimet, komentet e autorit për krijimin vetjak i mohon. Paramendon rrezikun e largimit nga teksti, sajimin e një metateksti të panevojshëm, që mund ta zhdrejtojë lexuesin.

“*Ka vetëm një trajtë të qëllueme e të drejtë, një radhitje fjalësh, gjithmonë në gjuhën amtare, përmes së cilës njeriu i paraqitet vetes e rrethit të njerëzve që janë të interesuem. Sikur unë ose çdo autor tjetër të vehej me shpjegue krijimet e veta ashtë rrezik t’i largohet tekstin fillestar e të krijojë diçka të re, pa dashje, të prishë veprën e vet tue e vu në një dritë të rrejshme.*” * * *Rrëmime mbi poezinë*–Martin Camaj *Vepra*, vëllimi i dytë, Onufri, Tiranë, 2010, faqe 7.

Të jetë thjesht një parim estetik, apo, është i ndikuar nga kodi i i etikës së modestisë dhe i mbylljes në vetvete? Çfarë mund të thuhet për Umberto Eco-n, që ka shkruar gjerësisht, për përftesat e krijimit të veprave, duke i ngritur në rrafsh të përgjithshme teorie letrare? Po për Ismail Kadarenë që, ka folur herë pas here, ka shkruar libra për laboratorin e vet të krijimit? Cilido goftë qëndrimi është e drejtë e autorit.

Me këtë mendim i jepet pavarësi e plotë lexuesit para autoritetit të shkrimtarit, sidomos prej manipulimeve të mundshme prej tij.

Teksti është më i rëndësishmi, krijimi, letërsia. Realistë, duke pohuar: *vepra është realiteti*, mbiçmonin rrelitetin, dhe, gati, mohonin rolin e subjektit krijues. Modernët dhe modernistët, ndër ta Martin Camaj, gmojnë lart subjektivitetin: *autori është vepra*, dhe, anasjellas, vepra është autori. Mendimi i tij mund të ndihmojë në përkapjen së mbari të strategjisë së receptimit, dhe, po ashtu, mund të pengojë, ose, ngatërrojë, në se ndërftu vlerësime të veta subjektive.

Ditët e para të tetorit në Tirana International, promovoi librin e saj të dytë, Laura Olldashi, një autore e re në krijimtari, por me vetëbesim e me gjënë e saj në të shkruar. “Asgjëja ime”, një vëllim me tregime, vjen si një pretendim për atë të pathënë tonë, që sa herë na shohin të menduar e na pyesin, ne përgjigjemi “Asgjë!”.

Shpesh ajo gjëja e pathënë na flet më shumë. Edhe pse është vetëm libri i saj i dytë, autorja lundron e sigurtë në ujërat e saj me stilin e thukët e plot nëntekst. Fjalitë e saj kanë një figuracion jo të përsëritshëm dhe të rënduar, por që vjen me një gjallëri e një gjuhë të freskët dhe mund të themi se në rreshta të shkrimeve në prozën e saj, ka shumë poezi moderne. Temat e tregimeve janë një refleksion nga e përditëshmjia, jo si historitë e autores, por bazuar në atë që e rrethon, e heton dhe e kërkon. Gjuha e saj është e dhënë shpesh me mungesa fjalësh, por që të lejojnë të aludosh për gjëra që lidhen me lexuesin. Përsiatjet filozofike bëhen pjesë e zanafillës së copëzave të historive që sjell autorja. Refleksionet, reagimet letrare nga të tjera vepra të njohura, e bëjnë të afërt këtë lidhje për t'u “ribërë nga fillimi”, “jetuar brenda shumë jetëve”, “pavetëdijshëm për dritën” e të tjerëve, në kërkim të vetvetes që shpesh e humbet ose e rigjen të plagosur nga dhimbjet që përballim. Në shkrimin e saj, njerëzit gjenden të rrethuar me një tradhtar të madh: vetveten. Me mendime të “mbështetura mbi Danub”, në netë të gjata pritjesh idiote, autorja është e vetëdijshme edhe kur bën “sakrifica” për dashurinë, si dashuri për veten.

Herë vjen me një prelud me shije jete që sillen vërdallë nesh me ngjyra, hapësira, natyrë, aroma e herë vjen me refleksionin e pasigurive që na sjell jeta sot me globalizmin e saj, me ngarkesën e me dukjen që na ofron, por që edhe na kontrollon. (Teknologjia si një rrezik; nëse njerëzit nuk të shohin me sy apo në rrjete sociale, për ta je i vdekur.) Herë sjell të premten si ditën e saj pikë vlimi analize, e herë të shtunën, si refleksion i një dite ku shpirti i njeriut në kërkim të ndjenjës gjen atë që zemrës i përshtatet i bëhet transplant shërues zemre të papërplotësuar; si të vetmet ditë të sajat. Refleksionet ndalen mbi marrëdhënien e njeriut me dashuritë që dhembnin e që ikin, ashtu rrjedhshëm si lotët, si pjesë e jetës, si pjesë e marrëdhënies jetë-vdekje;

Në libër, kohët përsëriten, luftërat e zemrës, por edhe ato të vërtetat vijnë pasi “Lufta e Shvejkut është akoma mes nesh, sepse mbushim stomakun nga e njëjta supë”; trishtimi dhe dhimbja na shoqëron njësoj.

Mënyra se si e përdor në tregimet e saj çdo detaj, na përcjell tërheqjen ndaj së bukurës, të pëlqyeshmes për sytë. Autorja kur thotë “...tymin e mbështes mbi flokët e tua. Ai të vesh si vesë dhe të zbret. Të mbulon, duke të zbuluar.” (“Sonata e hënës”), na sjell një skicë të bukurisë që të ikën duarsh, sjellë me fjali telegrafike. Soneti i hënës është realisht një prelud i të bukurës në dashuri. Në secilën fjali, metaforat e përsëritet mbizotërojnë në këndvështrimin e një burri. Çdo gjë aty është esencë fjalësh për dritën që kanë ca njerëz e që arrijnë ta shpërndajnë. Nuk janë të bukur, por janë ndiques të jetës së atyre që u rrinë pranë. Ka një gjuhë të gjallëruar e të pangjarë nga autorë të tjerë. Sjell mendjen e saj me imagjinatën e kulturën e saj krijuese, pa huazuar nga ç'mund t'i kujtohet nga autorë të tjerë. Librat që lexon i do për emocionin që i falin dhe që ajo i “përkthen” në fëmijën e saj të krijuar nga ajo vetë.

Tregimi që hap vëllimin e Laura Olldashit është “Rënia e germave”, një shkrim ku ndërthuren batuta të vjetra filmash, personazhe tipike të një kohe tjetër, lidhur me një histori trashëti-dashuri, ku njeriu me shumë mundësi do të lypë jo më dy lekë, po dashuri nga të tjerët. Askush nuk do të gjejë më asgjë, as duke rrënuar astarët e xhakëtës,

Për librin me tregime “Asgjëja ime” të Laura Olldashit

Ankthet e kohës që jetojmë

Nga Migena Kapllani

se asnjë nuk e ushqen dhe rrit atë (dashurinë), as për vete. Pyetjet ku rrahin mendimet në tregim, na dërgojnë në përsiatje që të ruajmë të bukurën brenda nesh. Shpesh njeriu mes pyllit të jetës, humbet shikimin për gjërat e duhura. Çfarë duhet të bëjë njeriu që mos të humbasë shpirtin? Cilat janë kompromiset për të pasur dashuri? Deri ku mund të shkojë njeriu për të pasur dikë pranë? Fjala *të dua* ka më shumë rëndësi; *shpirtin* nuk duhet ta humbasim. Paralelizma të filmave të vjetër, të figurave emblematisht të librave klasikë, të imazheve krijuese nga një foto, melodi etj., shoqërojnë një pjesë të mirë të tregimeve të saj.

Gruaja-dhimbja-vetja

Laura ka në qendër gruan që strapacohet e vetme në jetën e saj punë-shtëpi e prapë punë, sa e premtja është një ditë “premtuese për shlodhje e argëtim”. Kjo grua vuan, por nga lodhja nuk arrin ta kuptojë këtë lodhje. Rutina e rrëmben dhe e bën të besojë se po shijon në mënyrën e saj moderne, pa kushtëzime jetën e saj edhe në lidhje. Kjo jetë, nuk dihet pse nuk i do më romantizmat, po shpejt të kthen në luftën e përditëshme të punës, për të shpëtuar jetë të tjera kur punon në mjekësi. Prandaj thotë: “Si njerëz modernë, i vrapojmë rreth e qark ditës, për të “shpëtuar” botën dhe është e paktë koha që kemi për veten.” Vonë, kjo grua kur hap sytë, kupton që është keq, vuan, nuk është e lumtur dhe pse gabimisht këtë gjë e ka projektuar te njeriu që është në një lidhje (“Pacienti numër zero, E premtja”).

Figura e gruas me dramën e saj, vjen me një tjetër dhimbje te “Requiem për Suhade Cakrani”, drama e njeriut që në mënyrë absurde vuajti persekucionin. Përmes letërkëmbimit, paraqiten dy gjendjet e vajzës në jetën e saj, atë të vuajtjeve dhe atë të ëndrrave. Një rebelim migjenian e shoqëron këtë shkrim me paradigmen e njohur të hapave para e pas të Migjenit duke i zbritur

në numër drejt zeros. Si do të ishte Shqipëria “sikur e bukura të kishte triumfuar”? Bëhet më e madhe dhimbja kur na shpërftytyrojmë në këtë botë ëndrrat më të pastra e më të bukura. Si nuk çmendet njeriu nga gjërat e shëmtuara që mëson se ndodhin në këtë botë?! Si vazhdon jeta?! Si lindim akoma fëmijë?! Mbase mendojmë se me lindjet e reja do të korrigjojmë jetët e humbura.

“Ulur jashtë trupit tim”, është tregimi ku lexuesi në të përditëshmen e tij zbulon gjëra që tingëllojnë kaq pikurë, kaq muzikë. “E kam parë trupin që hekuros rrudhat e së përditshmes: kur lan sytë, kur përkul ëmbëlsisht qerpikët me rimel, kur lyen buzët e mishta dhe të thella me buzëkuqin ngjyrë koral dhe dy pikat e parfumit që rrëshqasin rrëzë veshit; si i mbyll sumbullat e këmishës së bardhë, kur përplas derën dhe i futet “e bukur” ditës së saj të kotë.”

Jeta e lidhur pas kavanozësh të mbushur me dhimbje, inate, urrejtje, mlllef e çdo dhimbje që e bën shpirtin ta braktisë trupin, përcillet me temën e vajzës prostitute, produkt i jetës në luftë (luftës më të re të kontinentit tonë, asaj të Ukrainës). Përmes simbolikës së gjetur të kavanozëve që shtërojnë dhimbjet brenda, shohim si endet me to nëpër rrugët e luftrave të jetës, e vogla Luizë. Këta kavanozë, njerëzit hallemëdhën e pa mbështetje, i bartin sa në një vend në tjetrin. Pika e lidhjes, e zgjidhjes, e dhimbjes së madhe të tregimit, varet pas një letër babai; një histori dhimbjeje që merr shkas nga lufta ku “brenda jetës, dhimbja dhe urrejtja gjallonte aktivisht” ku dashuria nuk “prodhohej” më. Luftat mendojnë vetëm njerëzit e popullit që u duhet dhe e duan atdheun, por që nuk duan aspak luftën. Çmimet që u varin në trup, ua zbulojnë më mirë tërë të keqen që kanë përjetuar e që nuk do të donin kurrë t'u ndodhte.

Ardhur nga një “botë dhimbjesh të thella” në duel e në përballje më të, vjen dhe tregimi “Fotografia”. Kur “hap sëndukun e shpirtit”, e sheh atë të plagosur rëndë dhe pse përsëri

krenaria nuk të lë të mposhtesh. Luftat tona çuditërisht nuk u duken aq luftra të tjerëve. Historia jonë është e mbushur me të tilla, por kjo krenaria dhe reziliencia jonë na bën çuditërisht të papërfolshëm. Fotot e luftrave tona duhet t'i ndalim e t'i “përflasin” gjatë si dhimbje të mëdha të atyre kohërave që historia i shteron në libra. Ndalim djallë i fotos e zbrit të na rrëfesh. “A e kupton që je një epokë?”. Mes dhimbjesh të forta për historinë tonë, autorja thotë: “unë përjetoj shpirtin e një kombi që ka në zemër fotografia”. Historia jonë e të voglit, është shfrytëzuar gjithmonë në fitim të më të mëdhenjve. Fati i të voglit e të pafuqishmit na ka përndjekur. Na duhet të mësojmë “shah” që të dimë “lëvizjen e radhës”. Vetëm kjo ka qenë porosia e pleqve tanë.

Dy anët e medaljes

“Kur i zhvishem ditës sime”, një shkrim për veten, e vetëdijshme për ditët e sakrifikuar që duhet të ecë e të mbajë “peshën e botës”, mbi supe, sjell gruan që imagjinon ditët e saj, e zhgënjyer nga harresa e botës dhe pse ajo e mban në këmbë botën. Jeta ecën dhe ditët ikin pa të vënë re askush. Është vetëm imagjinata ajo që na i ndihmon këto ditë të vështira. Si do ia dilnim kësaj bote të lodhshme nëse nuk do strukeshim ngrohtë në ëndrrat tona, larg njerëzve që të paragjykojnë, gjykojnë, që moralizojnë?! Por inatet e saj ndaj botës ndalen shpejt prej shpirtit të bukur artist. Inate që zgjasin “aq sa i hekuros gërmat mbi letër, sa i nxjerr nga vetja”, pastaj le t'i “vënë flakën” dhe le ta “djegin në turrën e druve...”.

“Dy anët e medaljes - Dy gratë e një burri”, ashtu si te “Kur i zhvishem ditës sime”, përsëri kthimi te dita, te e përditshmja, te e tashmja, te prezentja, te dashuritë, te mungesat. Duket sikur në këtë botë dashurinë sot më shumë e studiojmë se sa e ndiejmë. Një zë brenda kokës na kërkon gjithmonë llogari për dashuritë, shifrat dhe përqindjet e ndjenjave siç ndiqet “moda e fundit, ndjekim leksione si ta manipulojmë dashurinë” e ta kërkojmë teorikisht me studime, shembuj, citime apo teorira nga “ekspertët e humbjeve apo triufatorëve” në dashuri. Cili është i duhuri, a duhet të duam dikë që ka një jetë paralele thjesht për hir të dashurisë si ndjenjë; çfarë e bën dashurinë jodalldisje dhe të pandershme? Pyetje që ndërgjegjja sjell në përumbjet në ndjenjë, në dëshirën e marrë sot për ta pasur atë pranë vetes, pavarësisht formës se si na vjen. Vdesim për pak dashuri...! Çfarë ndodh kur ajo tërheqje e madhe që ne e quajmë dhe dashuri, nuk është më?! Çfarë bën një burrë “kur ka në krahë gruan që nuk e do më”? Të vetmuar, i veshim zërit të saj notat e zërave të sirenavë që na tërheqin drejt... asaj që na e treguan bukur si përrallë për të na vënë në gjumë dhe nuk na zgjuan për të parë të vërtetën të nesërmen e lindjes së diellit. I mbyllëm sytë gjithmonë për të gjetur atë ëndërr të bukur dashurie kur “ata jetuan përgjithmonë të lumtur”. A është dashuria një gjendje mashtrimi, apo është vërtet ajo që mban botën akoma në këmbë? Egoizmi, na mbyllet fotografinë e parë të personit që ne deshëm aq shumë, atë foto të parë të dashurisë.

Autorja me autorët e saj

“Djella”, një shkrim që sjell histori të letrave shqipe, nga një shkrim i autorit tonë të madh M. Camaj, një shkrim që sjell dhimbjen në fjalët legjendare “jam ulur në pemën që la hija e kokës tënde e varur dhe lagem nga lotët e shirave të vjetër”. Në këtë kërkim thellë në kohë, vjeshta dhe gjetet e harruara në xhep janë në të njëjtat vende, por me stacione të ndryshme kohore. Njerëzit kërkohen me dëshirën për të ndezur zjarret e shpirtit, por luftat janë përqark gjithmonë si për të na kujtuar se është i vështirë bashkimi. Dashuria ndër



ne është gjithmonë një luftë e vështirë bashkimesh. Dashtë Zoti të mos kujtohem gjithmonë për dritën e vërtetë të dashurisë, kur ajo të jetë në qiell. Historia jonë është e mbushur me thirrjen “Ku je?”.

“Shkruar me katër duar: Unë dhe Pessoa”, vjen si një lidhje me poetin e zemrës së autores, ku jeta komplikohet e shihet në të tjera dimensione dhe kuptime. Për autoren jeta imagjinohet si kurri i një djali veshur me pallto, me jaka të ngritura që i largohet në horizont që nuk arrin as t’i prekë flokët. Kështu ikën ajo përduarsh pa u jetuar.

“Letër kurrë e shkruar nga Milena Jesenská për Franz Kafkën”, na vë në kërkim të së vërtetave që historia na tregon e përmes saj kupton absurdin. “E mbështesin jetën, të vetmen bukuri që i është dhënë mbi kotin bosh të sipërfaqësorës. Janë gjeni për të krijuar procesin e kaosit, aq sa s’mjafton një jetë për ta zhbërë dhe shqepur rrëmujën.” Dashuria në letra, aq romantike dhe aq shtegllënëse bëhet shteg mendimi për ne të ftohtët e shekullit virtual. Si është dashuria me letra? E pavdekshme, si një vepër e shkruar.

Si mbyllje

Duke dashur të shpjegojë ankthet e kohës që jetojmë, bën një portret të vetes, ndryshe nga ajo që bota do dhe pret, por e sigurtë që më mirë ta thotë me zë të lartë atë që është e do të ndihet. Boll më me korniza sociale që na e vështirësojnë jetën, kur ajo është boll e vështirë vetë. Të numërosh me dhimbje ditët e tua, do të thotë të dish t’i japësh vlerë asaj që është më e rëndësishmja për secalin; jeta jote.

Tregimi i Laurës sjell historinë e zgjimit të nostalgjisë, mallit për të bukurën në jetën e njeriut, se pa të nuk jetohej. Bota është sa e madhe, aq dhe e vogël, përshtjellur në duart e personazhit. Një botë që na rrethon nga jashtë e një botë që na pushton nga brenda. Bota na mundon dhe e mundojmë një botë që “s’mund ta hedhësh” se “aty mbështet trupin”. Ajo ofron pa kuptuar gjëra aq të bukura që vetëm kur i lexon në një libër ke mundësi të shohësh qartë se çfarë të dhuron jeta në të rëndomtën e të përditëshmen e saj. A do t’i ishe larguar ndonjëherë asaj vajze që ka buzët “qershi gjysmë të hapura”, që vijnë si “një lloj ftese për valse të gjata puthjesh”; a mendon se pas këtij përshkrimi ndahesh nga ajo? Duhet t’i kthehem faqeve të librit tonë të jetës gjithmonë si për kujtesë të asaj që më vonë e quajmë normale e të përditshme. Njeriu pa kujtesë e pa vëmendje për gjërat e bukura në jetë, thjesht “ndien keqardhje në vetvete” dhe “trishtimi i ushqehet ngadalë në mes të gjoksit dhe fillon të dalë si bimëz në sipërfaqen e trupit”. Këto gjëra na mungojnë sot; komunikimi, të themi dy fjalë me dikë. Nuk e kuptojmë që jemi izoluar e mbyllur në egoizmin tonë. Pas pandemisë, bota shumë gjëra i mbylli e po i mbyll. Konkluzioni më i duhur për kohën që jetojmë thuhet në tregimin “Të puth”: “Qeshim, sepse e dimë që askush nuk dashurohet me trishtimin. Dashurohem me buzëqeshjen, me njerëzit e lumtur. Me guximin, kur ngrihem nga rëniet dhe zërat entuziaste që na rrahin shpatullat: ti po që ia del, sepse je i fortë!”

Vitet lodhin sfilisin e plaklin çdo pjesë të trupit, trurit, nervave. Njeriu ka dëshirë të “zihet” me jetën, por gjithmonë kjo grindje materializohet me njerëzit që ke afër. Jeta duhet pranuar me të vërtetat e saj të vështira. Nuk mund të bëjmë më teka fëmijësh me dua apo s’dua. Jeta do të përballesh me dallgët e saj edhe kur do t’i ikësh asaj nga sytë këmbët. Dili zot gjërave të tua o njeri. Jeta nuk është pëlhurë Penelope që mund të thuret/shturet sa herë të duash që të fitosh kohë. Në jetë nuk e gjen dot aq kollaj një shpirt binjak që të ka shoqëruar gjatë, prandaj kthehu gjithmonë me harresën e ditëve të këqija e kujtesën e ditëve që ia vlen.

Romani “Pushteti i kancerozëve” i autorit Kleo Lati

Tharja kulturore prej regjimit korruptiv

Nga Aleksandër Çipa

Reagimi social dhe politik i shkrimtarëve aktualë, përmes letërsisë që sjellin është një shërbesë e vyer për lexuesin aktual shqiptar, i cili duket se gjendet në një hapësirë me kaos, pa rend, pa struktura meritokratike dhe në anarkinë e mungesës së një sistemi me referenca.

Gjatë dekadës së fundit dhe jo vetëm, entet botuese të letërsisë shqipe, në krejt hapësirën shqiptare, kanë sjellë e sjellin botime dhe tekste cilësore e me risi tekstuale.

Mund të flitet tashmë edhe për një lloj të ri letërsie të angazhuar, por pa tabu dhe pengime ekstraletrare, pa reminishenca me socrealen e anatemuar. Kemi të bëjmë me një letërsi aktuale, realiste, me risi dhe ndikime të asimiluara teknikash nga rryma dhe shkolla dhe përvoja letrare në rajon dhe arealet letrare ndërkombëtare.

Të ngjan se motivimi angazhues i shkrimtarëve është i njëjtë me konstatimin e A.R.Ammos, kur thotë “...se shkruan për t’u bërë pjesë e një bote nga e cila ndjehem i dëbuar”. Degradimi moral, korrupsioni malinj-kanceroz, bjerja dramatike e ndërgjegjes morale, zhbërrjet strukturore të familjes dhe shoqërisë, hipokrizia kriminale brenda tyre dhe sidomos ekspozimi gati sundonjës i personazheve të një shoqërie me paskrupullsi dhe makutëri balzakiane, janë arsyeja madhore pse shoqëria shqiptare, në periudhën e ashtuquajtur tranzicioniste, është dëbuar dhe vijon të mbahet nën regjim dëbimi prej së mirës, cilësore, morale dhe ndërgjegjes pozitiviste kolektive. Prej këtij realiteti shkrimtari Kleo Lati mishëron tekstualisht motivin jo fotografues, por përshkruar për një dramë e cila nuk mund të mbetet në fuqi e nuk mund t’i ketë personazhet e veta jetëgjatë në tablonë e gjerë dhe në krejt kohësinë shoqërore.

Qëndrimi që mishëron në romanin e vet më të ri, shkrimtari rezulton duke vendosur në epiqendër të subjektit, panoramën alarmante të thatësirës kulturore dhe intelektuale të Shqipërisë së sotme, dhe fatkeqësisht, në krejt marrëdhënien dhe



rrafshin e shfaqjes publike të shoqërisë sonë. Libri i tij, si thelb të lëndës shkrimore mbart pasqyrimin e koncentruar dhe brengën intelektuale të shkrimtarit për thatësirën kulturore aktuale në vend. Nëse do ta thonim me leksikon lokal të Bregut të Petro Markos, (nga është edhe shkrimtari Kleo Lati): Kserimi(tharja) kulturore është në faqen e parë të romanit “Pushteti i kancerozëve”.

“Pallati i pushtetit” në roman është i banuar, seksion më seksion dhe skutë më skutë, nga banorë, prototipa të korrupsionit dhe abuzivizmit, nga antilexonjësit dhe shpërfillës patologjikë e injorantë të kulturës.

Në këtë “pallat” nuk larton asnjë shtat antikorrupsionisti, madje as ai i kryeqeverisësit të tij, sikundër shfaqen e bëhen të dukshëm e të shqueshëm krejt karakteret dhe mantenutat gjuhë e trup-shërbyese për luks e vjedhje, për shtirje dhe klasë pa klas apo antiklas.

Autori ka zgjedhur ta nisë romanin me një pretendencë paralajmëruese të një avokati në ligjërime publik, sipas modulit të Jozef.K së Kafkës.

Është reaksioni verbal intelektual i personazhit Avokatit, që shpërthen sepse në këtë vend dhe shoqëri që adreson romancier, askush nuk është në vendin e vet të duhur dhe askush nuk peshon pasojat dhe dëmet, por hyn makutërisht në shërbesa

prostitutive dhe korrupsioni degradues.

Ky është romani që ofron një sprovë autentike për ta zbardhur realitetin tonë socioburokratik dhe për ta lënë atë në një vepër letrare. Është një tekst pa metateks specifik. Sepse ka dashur ta japë pa asnjë ndërhyrje pas-spartuese realitetin karakterologjik të korrupsionit, nëpunësisë dhe burokracisë ala-tranzicioniste shqiptare, arkitekturën e qeverisjes së korruptuar të anarko-pluralizimit shqiptar në kohën e viteve 2020.

Autori, jo pa qëllim, ka huazuar nga imazhi real i përditshmërisë shqiptare karakterin e një avokati të së drejtave dhe dëshirave publike. Në formimin dhe sidomos tendencën e tij, dominon qasja pro euroatlantike dhe sidomos ndaj kulturës dhe mendimit oksidental.

Sarkazma, ironia, qesëndia dhe sidomos qortimi i drejtëpërdrejtë prej tij, i deformimit dhe prapambetjes aktuale në sferat e qeverisjes janë mjete të përdorura me aftësi shkrimtarie prej autorit. “Sistemi për skrap” sic do ta quajë miku dhe studiuesi mendjehollë Gëzim Basha, duket si i tillë kur vërehet gjendja dhe thatësimi tronditës i intelektualizmit dhe sidomos shtetarësisë shqiptare në këtë roman. Personazhet e tij si Jetnori, Diana, Bledari, Denisa, Bankieri janë përdorur me aftësi karakterizuese prej shkrimtarit për një shoqëri boshe, elita e së cilës ia ka lënë vendin dukjes dhe mjerimit substancial.

Shkrimtari Kleo Lati në këtë roman respekton principin se “**Në jetë – edhe në letërsi - asgjë nuk ndodh rastësisht.**”

I gjithë subjekti i romanit përmban një kumt të qashtë shpëtues për shoqërinë aktuale. Në thelb të të cilit është nevoja për një proces reformues dhe përmbysës: dekorruptionizimi i superstrukturës dhe burokracisë së shoqërisë së sotme.

Në fakt kjo nevojë për shkak të përmasave reale konkrete në realitet, të le në dilemën se është një proces utopik. Mirëpo është i vetmi shpëtues, nëse ngjet dhe sipërmerret prej vetë shoqërisë së pushtuar nga ky kancerizitet së pari në ndërgjegje e më tej në superstrukturë. Shkrimtari, pa kërkime të qëllimshme, por me aftësinë shkrimore të një qashtësie dhe thjeshtësie mjeshtërore ia ka dalë ta japë tablonë specifike dhe të fotografueshme të këtij ndryshku, kalbjeje dhe degradimi të thellë njerëzor. Në sytë dhe mendjen e lexuesit, duke kaluar tekstin tërësisht, krijohet imazhi real dhe asosacioni konkret për këtë “kënetë me luks” në të cilën gëlojnë e shfaqen, me ar në veshje dhe llum në shpirt e ndërgjegje, personazhet e romanit.

Është një raport i shkëlqyer që ndërton autori (kur ndodh leximi dhe përputhshmëria) me realitetin social të subjektit romanor. Personazhet e tij janë evidentues atipik të zhgënjimit moral dhe ndërgjegjësor të marrëdhënies mes përfaqësuesit, të zgjedhurit, qeverisësit dhe shërbëtorit brenda strukturës shtetërore dhe individit në kolektivitetin aktual shqiptar. Madje, për shkak të injorimit dhe shpërfilljes dramatike të nevojës dhe rolit moral në shoqëri, në njerëzi, në familje dhe raportet mes tyre, shoqëria nuk përpëllitet vetëm në zhbërje, por në fatalitetin e papeshueshëm. Jo vetëm tek romani “Pushteti i kancerozëve” por në pararendje të këtij botimi me romanin “Shpirtra të shitur”, autori mbetet në brengën dhe konstatimin e vdekjes kulturore, zbrazjes shpirtërore të shoqërisë së sotme. Sipas tij kjo vdekje ka për shkaktar “pushtetin kanceroz” dhe për mjedis-lindës të saj, pushtetin e korruptuar dhe orgjitë e tij. Krejt kjo lëndë vjen përmes një thjeshtësie mjeshtërore rrëfimi, një përkujdesi dhe qashtësie gjuhësore për të cilën rëndom ndjejmë tashmë mall dhe të cilën, pothuajse e humbasim përherë e më tepër, për shkak manierash dhe fanatizmesh idiomadashjesh gjuhësore.



Isha ftuar në përkujtimoren kushtuar Migjenit më 13.10.2023 në Tiranë, me rastin e 112 vjetorit të lindjes së të tij. Por nuk munda të shkoja atje për arsye shëndetësore. Më erdhi keq, se doja të merrja pjesë dhe të kumtoja për një përkujtimore tjetër të paharruar për Migjenin, organizuar para më se gjysmë shekulli më parë, ashtu siç e kisha përjetuar atëherë.

Isha maturant në shkollën pedagogjike të Tiranës. Kisha fatin, apo shansin -siç mendojnë ata që besojnë në Zot, të kisha pedagogë profesor Skënder Luarasin në lëndën e letërsisë dhe Ollga Luarasin, motrën e Migjenit, për lëndën e matematikës.

Profesor Skënderi, ishte dhe mbetet një patriot i madh, njeri i letrave dhe i fjalës së lirë, studiues dhe përkthyes i talentuar, por edhe një personalitet i fuqishëm, trim i çartur, apo sic ka thënë për të poeti i mirënjohur Xhevair Spahiu “gojë që nuk iu mbyll dot kurrë”, antikonformist, që nuk e duronte autoritetin partiak, padrejtësinë, mediokritetin dhe servilizmin të kohës, kritik i hapur i antivlerave sidomos në fushën e letërsisë, por edhe mëtonjës i vlerave, siç ishte vlerësimi publik për Ismail Kadarenë, për romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, kur mjaft të tjerë e heshtnin apo e sulmonin tinëzisht. Në ato vite, por edhe më vonë, partiakët e fuqishëm dhe aparatçikët shpesh përpiqeshin ta fundosnin profesor Skënderin, por ai ngrihej përsëri, po aq herë, së pari se ishte një personalitet i mirënjohur, sepse ishte i biri i Petro Nini Luarasit dhe e treta, mund të vihet edhe e para, sepse shpesh gjente mbrojtjen e kryeministrit Mehmet Shehu, me të cilin kishin qenë së bashku në luftën kundër fashizmit në Spanjë.

Mbi të gjitha Skënder Luarasi ishte botuesi i parë i veprës së plotë të Migjenit, që e bëri atë të njohur e të vlerësuar brenda e jashtë Shqipërisë. Nga ky botim e njoha edhe unë veprën e tij të jashtëzakonshme. Por edhe për botimin e kësaj vepre, prof. Luarasi pati probleme. Në shtëpinë botuese “Naim Frashëri” i thanë që ta hiqte përkushtimin kushtuar Niçes “Ditiramb Niçes”, në krye të poezisë “Trajta e mbinjeriut”. Profesori u tërbua, i akuzoi për censurë, retushim e manipulim dhe u largua i revoltuar. E çfarë nuk tha botuesi- Skënder Luarasi shau pushteti, ngriti lart Niçen etj, por si edhe herë të tjera, ky skandal u mbyll nga lart, që të mos merrej vesh që shteti aplikonte censurë, aq më tepër për Migjenin.

Profesoreshë Ollga, një zonjë fisnike, e imët, me flokë të përhimët e me syze të rrathuar, jepte matematikë, por unë habitesha me vete sesi ajo me atë shpirt të butë, të brishtë dhe zë të njomë, jepte matematikë, ndërkohë që ngushëllohesha nga që ajo gjithsesi e bënte atë lëndë të vështirë, - të lehtë e të rrokshme për nxënësit, me të cilët ishte shumë e afërt, e dashur, siç ishte edhe Migjeni dikur me nxënësit e tij në Pukë...

Ishim përpara përvjetorit të lindjes së Migjenit. Atëherë matura e shkollës pedagogjike kishte lidhur një bashkëpunim me vitin e fundit të Fakultetit të Letërsisë në Universitetin e Tiranës dhe me këtë rast ishte vendosur ta përkujtonim së bashku ditëlindjen e Migjenit, një nismë e profesor Skënder Luarasit dhe takimi do të bëhej në shkollën tonë. Do të mbaheshin dy kumtesa, një për poezinë nga ana e shkollës sonë dhe një për prozën, nga Fakulteti i Letërsisë, si edhe dhe kujtime, refleksione etj.

Një përkujtimore e paimagjinueshme për Migjenin

Lotët e Ollgës, motrës së Migjenit


Nga Uran Butka

Prof.Skënderi, si një autoritet që pyeste vetveten, ma besoi mua kumtesën për poezinë e Migjenit, gjë që krijoi edhe pakënaqësi dhe përplasje në drejtori. Por Skënder Luarasi ishte i patundur. Dhe ashtu u bë. Unë e ndjeva thellësisht përgjegjësinë dhe u përgatita për këtë ditë të veçante të jetës sime.

Ishte ora 18 e mbrëmjes së 13 tetorit. Tubimi do të zhvillohej në sallën e madhe të studimit të konviktit të vajzave. Unë shkova pak më herët atje, por ndjehesha i emocionuar, i mbushur përplot me zjarrmin e pashuar të poezive të poetit. Për t,u qetësuar e freskuar sadopak, por edhe për të krehur pak baluket, se isha ende 17 vjeçar, hyra në ngrehinën e vjetër të shkollës (dikur shkolla “Nana Mbretneshtë”) dhe kalova në banjot e katit të dytë. Kur desha të dal, pasi kisha freskuar fytyrën, dera ishte mbyllur nga brenda dhe nuk hapej, sepse dorezën e kishte vetëm nga jashtë saj. Mbete brenda katër mureve të akullt e të heshtur. I rashë me grushte derës dhe thirra sa kisha fuqi, por nuk më dëgjoi kush, se të gjithë ndodheshin në ndërtesën tjetër, atë të konviktit. Kishte vetëm një mundësi daljeje, një dritare e lartë, afër tavanit,

e ngushtë si një drejtkëndësh, si frëngji. Atëhere bëra të pamundurën. Kërceva fort dhe kapa me të dyja duart parvazin e saj, ku mund të fusje vetëm kokën. Arrirta ta bëj me sforcime, mandej me përpjekje të mëdha u zvarrita pas murit dhe e kalova trupin si një zvarranik nëpër dritaren e ngushtë, që të nxirrte ne taracë. Mandej gjeta një dritare klase të çelur dhe zbrita poshtë. E këqyra veten me dhimbje dhe përbuzje. Teshat më ishin zbardhur nga gerqelja, duart dhe fytyra me ishin gërvishtur, flokët me ishin ngrehosur. U përpoqa t'i fshija teshat, por ishte e pamundur t'i pastroja. Ato u bënë si të lërosura me llaç. Si do të dilja përpara auditorit të zgjedhur? Për një çast mendova të ikja, të zhdukësja. Por si do ta lija ne baltë profesor Skënderin? Gjithashtu, ndjeva në thellësi të vetes një duf, një dëshirë të zjarrtë për t'u shprehur, për komunikuar me të tjerët mbi motivet dhe artin magjik të Migjenit, ashtu si e ndjeja dhe mendoja unë.

Në oborr kishin dale disa nxënës të më kërkonin si edhe profesoresha Dhurata Xoxa, bashkëshortja e shkrimtarit Jakov Xoxa. “Uran, ç'u bëre?- më tha. Të ka ardhur rradha për të folur! Eja.



Kishte rënë mbrëmja dhe ajo nuk më dalloi se si isha katandisur. Gjithsesi, hyra në sallën e madhe të mbushur plot e përplot me nxënës, studentë e pedagogë. Sa më panë ashtu, plasi një pëshpëritje shpotitëse dhe ilariret i përgjithshëm. Unë u ngjetha, por nuk u ktheva pas. U gjenda përpara foltores.

Për të dalë nga ajo gjendje dhe për të nisur fjalën, thashë me një grimë zëri: “Për ta bërë sa më të prekshme veprën e Migjenit, kam marrë pamjen e disa prej personazheve të tij”

Kjo alibi krijoi një pauzë të përzierë humori, dyshimi apo meditim, që më shpëtoi disi dhe unë ia nisa fjalës. Nuk mbaj mend se çfarë thashë konkretisht, di që edhe recitova vargje të Migjenit, se e dinja përmendësh poezinë e tij. Më kujtohet vetëm se më dëgjuan në heshtje e kuriozitet bashkë dhe se fitoi fjala, jo pamja ime e zhgaravitur. Më kujtohen, gjithashtu, lotët e profesoreshë Ollgës, motrës së Migjenit, të cilës i rridhnin lotët varg nga sytë nëpër faqet e zbehta, kur unë flisja për Migjenin.

Më pas e kuptova se ajo rropatje që më ndodhi, ajo vendosmëri e habitshme, më rrithnin nga impresionet e Vargjeve të Lira të Migjenit. Për mua, por edhe për brezin tim, madje edhe për deklasuarit e regjimit, për të vuajtuarit dhe të nëpërkëmburit, për ne bijtë e atyre prindërve perëndimorë, që u dënuan apo u pushkatuan, por që ne kishim brenda vetes genet e mesazhet e tyre qytetare, ishte shumë më i kuptueshëm, më i dashur dhe më i vlerësuar Migjeni. Ndryshe nga nomenklatura komuniste dhe puthadorët e saj që e trumbetonin Migjenin më tepër si një zëdhënës të tyre, si revolucionar dhe prekursor i ideve komuniste, pra ideologjikisht, ndryshe nga disa të paktë personalitete si Ismail Kadarej etj, që e kishin vlerësuar si novator për artin e tij. Përmbledhja e viteve të mëpasme të veprës së Migjenit, kishte parathënien e gjatë të Ismail Kadaresë.

Dua të theksoj, se Migjeni për shtresën tonë të deklasuar ishte një poet i revoltës kundër çdo sistemi totalitar, ne nënkuptonim brënda motiveve të vargjeve të tij të lira, lirinë e munguar, shtypjen e mjerimin nga regjimi diktatorial, ku jetonim, vlerësonim artin e tij, humanizmin e tij për njeriun, të mjerët e përbuzur, për të varfërit, për të papunët, por nuk bëzanim dot guximshëm si ai. Zëri i tij i shpallur, ishte edhe zëri jonë i munguar. Prandaj e kuptonim, e ndjenim dhe e donim poetin e mjerimit, por edhe të çlirimit njerëzor.

Rinia, të cilës i këndoi Migjeni, i dha grushtin e fuqishëm (“Ah, sikut të kisha një grusht të fuqishëm, malit që hesht mu në zemër me ia ngjeshë...”) dhe e përmbysi atë regjim diktatorial vetëm pas gjysmë shekulli, në vitet '90.

Migjeni, për mua nuk ishte një meteor, siç është thënë rëndom, por një yll dritëdhënës i pashuar në qiellin e letërsisë shqiptare.



Studimi monografik Peizazhi linguistik i Tiranës është një studim serioz sociolinguistik. Autorja Elsa Skënderi Rakiplari ka realizuar një hulumtim dhe punim të përthekuar mirë dhe para së gjithash të ndërtuar metodologjikisht mbi parametrat më të lartë shkencorë, duke iu përmbytur edhe një etike të lartë shkencore, demonstruar përmes citimeve korrekte të rezultateve paraprahe të studimeve të ngjashme a pioniere të kësaj fushe dhe dhënies së meritës së mjaftueshme për bashkëpunëtorin e këtij punimi Rrezarta Yzo.

Libri, siç e thotë në recensën e tij profesor Munishi, është një prurje e rëndësishme për studimet sociolinguistike dhe linguistike shqiptare. Autorja Elsa Skënderi Rakiplari që në parathënien e librit, por edhe në pjesën e përimitit teorik më pas, jep të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me natyrën e peizazheve linguistike, të cilat në bindjen time janë më shumë dokumentare deskriptive që pasqyrojnë aspekte të veçanta linguistike, të ndërlidhura patjetër me kohën e realizimit të studimit. Ky komponent, sado duket i thjeshtëzuar, kur shpjegohet në këtë mënyrë dhe kur shihet si vjelje e korpusit për hulumtim, pastaj në kuptim të analizës dhe të intepretimt të të dhënave vjen e bëhet mjaft i vështirë dhe i ngatërruar, pasi duhet të ketë parasysh faktorë të shumë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë që diktojnë ndryshimet që paraqiten përmes variablash. Globalizimi, tregu, momentumi politik e kulturor, shkalla e vetëdijes arsimore, kulturore e identitare janë vetëm disa nga faktorët që duhen pasur parasysh me këtë rast. Unë që i kam lexuar jo vetëm punimet e tjera të saj të Elsës nga gjuhësia, por edhe romanin e saj, e gjej këtë studim brenda pritjeve për të si studiuese, që do me thënë se nuk kam pritur më pak, por më duhet ta them se në profilin e Elsës si studiuese ndërmjet gjuhës dhe letërsisë, që del herë-herë jashtë kornizave apo jashtë të të menduarit brenda kutisë jam habitur për mirë me disiplinën metodologjike që e ka dëshmuar, pasi ne që sillemi ndërmjet këtyre dy fushave të studimit, dimë të ngutemi. E them këtë pasi, kur e lexova romanin e Elsës gjeta kompozita aq kompozita sa asnjë vepër letrare në shqip dhe aq të goditura sa për të qenë një korpus i mjaftueshëm për studimin e kompozitave të shqipes. Dikush kaq kreativ, pavarësisht nga dija e konsoliduar që posedon vështirë se mund të qëndrojë brenda kornizës metodologjike të një hulumtimi sociolinguistik të kësaj natyre, pa u rrëmbyer nga kreativiteti që do të mund ta dëmtonte aparatusin e përdorur metodologjik-shkencor. Ajo ka arritur ta bëjë këtë, prandaj ky punim, për mua ka vlera edhe dokumentare, siç kanë zakonisht punimet sociolinguistike të kësaj natyre, pra peizazhet linguistike, pasi

Mbi librin “Peizazhi linguistik i Tiranës” të autores Elsa Skënderi Rakiplari, botuar nga “Albas” 2023

STUDIMI I PARË I PLOTË PËR PEIZAZHIN GJUHËSOR TË TIRANËS

Nga Rrahman Paçarizi (Universiteti i Prishtinës)

Zv. Dekania e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Dr. Elsa Skënderi Rakiplari publikon monografinë studimore “Peizazhi Linguistik i Tiranës” “Peizazhi Linguistik i Tiranës” është monografia që u promovua më 12 tetor 2023 në Universitetin e Tiranës, nga zv. Dekania e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Dr. Elsa Skënderi Rakiplari.

Ky është studimi i parë i plotë për peizazhin gjuhësor të Tiranës dhe shtron udhën për studimin e mëtejshëm të përdorimit të gjuhës në hapësirat publike, në vendin tonë. Sipas këtij studimi, në disa zona të Tiranës, si rruga “Myslym Shyri”, Blloku, Zogu i Zi dhe Rruga e Durrësit, emërtesat e bizneseve dhe të objekteve janë më tepër në gjuhën angleze. Në këto rrugë gjuha shqipe qëndron në vend të dytë, pas anglishtes.

Mënyra si zgjidhen emrat e bizneseve dhe si shkruhen ato, reflekton nivelin e kulturës gjuhësore dhe të njohurive për gjuhën shqipe. Sipas autores, vendi i lartë që zë anglishtja në peizazhin linguistik të Tiranës, është shenjë e globalizmit, pasi kjo prirje vihet re dhe në peizazhet linguistike të metropoleve të vendeve të zhvilluara. Veç kësaj, prania e lartë e gjuhëve të huaja (si anglishtja, italishtja, frëngjishtja, gjermanishtja etj.) në hapësirën publike është pjesë e diskursit të përgjithshëm publik, që narrativë mbizotëruese ka orientimin e përgjithshëm properëndimor dhe proevropian të vendit tonë.

Studimi “Peizazhi linguistik i Tiranës” trajton si pjesë të peizazhit urban edhe mbishkrimet murale dhe grafitit, që shpesh janë formë e shprehjes së aktivizmit qytetar për çështje të mprehta sociale e politike.

Të pranishëm në promovimin e monografisë ishin edhe studiues nga Shqipëria dhe Kosova. Ata vlerësuan risitë e këtij punimi, thellësinë e hulumtimit, qëndrueshmërinë shkencore dhe faktin që kjo prurje shërben për të shtruar diskutime të tjera në forume gjuhësore dhe kulturore, si dhe nxit analiza të tjera në këtë fushë.

Studimi “Peizazhi Linguistik i Tiranës” i Dr. Elsa Skënderi Rakiplarit është një kontribut i vyer në disiplinën e peizazhit gjuhësor. Ajo më herët ka publikuar monografinë “Analizë kritike rreth diskursit politik në Ballkan”, romanin “Krom dhe Luledele”, si dhe është autore e një sërë artikujsh studimorë dhe tekstesh shkollore të Gjuhës dhe Letërsisë në Shqipëri e në Kosovë.

ato mund dhe duhet të përdoren edhe për studime të fushave të tjera, si sociologjike, identitare, studimeve mbi marketingut, studimeve mbi statuset dhe konstelacionet politike e të tjera. Kur e përmend këtu tregun, duket sikur po largohem shumë, por trajtimi i mbishkrimeve të lokaleve afariste çon atje, ashtu siç më çoi mua te tregu e marketing studimi për brendimin si mënyrë e fjalëformimit, e cila sillet ndërmjet gjuhësisë e hulumtimeve të tregut që në anglisht njihet si genericization.

Dhe, rezultatet e këtij studimi të Elsa Skënderit janë po aq impesive, pasi ajo merr parasysh të gjithë këta faktorë të përmendur. Analiza e mbishkrimeve nxjerr edhe sete gjuhësore që ndërtojnë narrative ideologjike e identitare që dalin pikërisht në mbishkrimet e Tiranës dhe po të krahasohen me ato të Prishtinës nxjerrin dallime shumë interesante të cilat i vërtetojnë deri në një arsyet për këto dallime. Në të vërtetë aspiratat e shprehura nga qëndrimet e respondentëve janë argumenti më i mirë

për këtë dhe hartimi i grafikave për këto lloje qëndrimesh e argumentimesh, është vlerë e shtuar për këtë punim, që e çon përtej dokumentaritetit të domosdoshëm në analizë sociolinguistike. Gjithashtu paraqitja përmes grafikave e mbishkrimeve të ndara sipas origjinës së tyre gjuhësore a multilinguale dhe të shpërndara sipas rrugëve të Tiranës, dëshmon për një punë këmbëngulëse, për të mos i lënë asgjë rastit dhe për të eliminuar aq sa e është e mundur gabimet që mund të dalin në matjen përfundimtare të kësaj dukurie.

Domethënë, seti metodologjik i përdorur për testimin e hipotezave iniciale, metodologjia e hulumtimit dhe e mbarështimit a kompozimit të tekstit, etika e lartë shkencore e pasqyruar përmes citimeve dhe literaturës së përdorur janë tiparet e një punimi të qëndrueshëm që ky studim i shndërruar në libër i ka, madje i ka fort.

Autorja thotë në fund, duke u mbështetur te një thënie e Teki Dërvishit, se “Këtë libër do ta shkruaj prapë”. Natyrisht, jo duke ndjekur arsyet e Dërvishit, por duke ndjekur parimet sociolinguistike, ky libër do të shkruhet prapë, edhe nëse jo nga Elsa, por do të shkruhet në një Tiranë tjetër, me rrethana të tjera që do ta ndryshojnë peizazhin e sotëm linguistik të Tiranës.

KANË SHKRUAR PËR LIBRIN:

“Ky është një studim relevant dhe mahnitës, për disiplinën e Peizazhit linguistik. Bashkë me disa kontribute më të shkurtra të Shkumbin Munishit për Prishtinën, ky është përvetësimi i parë i metodës dhe një vepër pioniere në kuptimin literal të fjalës.”

Christian Voss
(Universiteti i Humboldt, Gjermani)

“Studimi, përveç se paraqet studimin e parë dhe të plotë për peizazhin gjuhësor të Tiranës, sjell po ashtu modelin e plotë se si duhet te studiohen peizazhet gjuhësore të një hapësire publike. Ky hulumtim behet krejtësisht i qëndrueshëm shkencërisht për shkak se, përveç diskutimit të studimeve të plota teorike të koncepteve paraprahe të peizazhit gjuhësor, mbështetet në një metodologji të plotë dhe të saktë shkencore, në një metodologji të plotë dhe të saktë shkencore, në bazë të të cilave gjetjet dhe përfundimet qëndrojnë më këmbë të forta shkencore. [...] studimi i pasqyruar në këtë libër paraqet një arritje jashtëzakonisht të rëndësishme për gjuhësinë shqiptare”.

Shkumbin Munishi
(Universiteti i Prishtinës, Kosovë)



BUZE DETIT

Buzë detit
Ca njerëz shëtisin
Mbi rërën e errët
Të njomur nga batica
Megjithëse Vermeer-i
E ka pikturuar të trëndafil të
Siç thotë Proust-i
Kur përshkruan Bergotin,
Shkrimtarin simbol të tij
Që duke soditur tablonë
Pamje nga Delfti
Sheh për herë të parë
Rërë të trëndafil të
Dhe ca personazhe
Në ngjyrë të kaltër ;
Pastaj i hutuar
I ngul sytë gjatë
Mbi një copëz muri
Të pikturuar brenda tablosë,
Dikur i afrohet shumë asaj
Si të ishte fëmijë
Që dëshiron të kapë
Një flutur të verdhë.
Proust-i shton gjithashtu se Bergoti
Murmurit me zë të ulët :
« Ja kështu duhej të kisha shkruar »
Dhe vdes
I vranë nga bukuria.

MAGDALENA

Unë e njoha
Dhe predikimi i tij
Më bëri të mençur

Shita gjithçka
Dhe i shkova pas
Deri në Malin e ullinjve

Në gji ruaja
Shishen e parfumit
Që doja t'ia dhuroja

Medet !
Nuk arrita dot
Ju e dini çfarë ndodhi

Por i spërkata
Këmbët e lodhura
Kur ngjiste Golgotanë

Me kryq në krah
Me vdekjen
E paralajmëruar

E di që ky gjest
Për dashurinë
Eshhtë fare pak

Por dashuria
Mund të ushqehet
Edhe me kaq « fare pak ».

SHQIPËRIA NË VERË

Vijë e zgjatur bregdetare
Adriatik, Jon
Si një peizash impresionist
I kredhur në kaltëri
Aty qielli dhe toka bashkohen
Në një tablo gjigante
Pa kornizë
Ca fëmijë luajnë në rërë
Buzë ujit
Dhe futen në tablo duke qeshur
Me diellin në sup
Trupat e tyre u ngjajnë
Pranverës në gjelbërim
Dhe pëllumbave të bardhë
Gjithë gugurima
Vështrimet e tyre
Janë flakërima yjsh
Në qiellin pa kufi.

ANTISONET PËR HËNËN

Kënga jote e kaltër nëpër natë
Dëgjohet larg ndër pyje
Dhe ndalet kur ylli i mëngjesit



Vjen pranë teje si zemër e vockël.

Monedhë ari e rrëzuar në det
Nga nxitimi i kohërave
Shqiponjë e artë e vizatuar me një vijë
Që shëtit në fund të qiellit.

Mund të jesh edhe ëndërr
Me ngjyra të shuara
Fytyrë që e ringjall dashuria

Thonë se mbase je engjell argjendi
Që shpesh shndërrohet në satan
Dhe mbjell lahtari mbi botë.

ERËRAT E HISTORISË

-Unë po jetoj fundin e jetës -
tha ajo duke vështruar ngultas
sikur të mos e kishte parë kurrë atë vend
dhe ata njerëz që kishte përreth.
Në sy i shfaqeshin disa imazhe
me një dritë të shuar.
Kishte qenë dikur partizane
dhe sytë e një ushtari të huaj
nuk mund t'i harronte
kur luteshin për jetë
në minutat e mbrame
i plagosur për vdekje.

Ajo lëvizi dorën e lodhur në ajër
dhe shqiptoi :
-Përse erdhi si pushtues ai
në atë ditë kobzezë ?

Nga dritaret e kohës
frynin erërat e marra të historisë.
Dhe buzagazi i saj
i hidhur
derdhte një shkëlqim të hirtë
në muzgun që afrohej.

DHIMBJE

Në qytetin e vogël
Dëgjoheshin këngë zogjsh
Që vinin nga një koriye aty pranë
Dhe valët e lumit
Që kalonte mespërmes tij
Ushtonin me jehona të ëmbla
Duke u bashkuar me këngët e zogjve
Thjesht, lehtësisht
Sepse kështu ndodh gjithnjë
Me gjërat e natyrshme

Një ditë e prenë korijen
Kurse lumit ia ndryshuan rrjedhën
Dhe u zhdukën të dyja
Nga ai gjest i vrazhdë i njeriut.

DASHURIA

Ishte një stinë e mistershme
Vjeshtë e parë
Dhe trëndafilat kuqëlonin së tepërmi
Vitet dhe ditët tona
Nisën të prarojnë
Dhe në një çast
U përndezen
Në një hapësirë abstrakte
Ne heshtnim
Dhe kur flisnim

Thoshim diçka pa lidhje
Që mbi të gjitha nuk e dëgjonim.
Vetëm zemrat
Kishin një gjuhë të kuptueshme
Pataj nisëm të ecnim
Në mes të kozmosit të tmerrshëm
Të hutuar e të mrekulluar
Me fatin tonë përdore.

FËMIJA

Me flokët e derdhur në nënkresë
Si një hierore drite
Ai fle.
Kur zgjohet
Ka në sy një dritë fatlume
Dhe një zë të nartë
Që duhet ta ruajmë
Si ujin e pakët.
Ajo dritë fatlume
Dhe ai zë i nartë
Janë hyjnorë
Si rrezet e diellit mbi botë.

POEZIA

Trup virtual prej fjale
Që të shpie në horizonte të largëta
Në kohë lufte të çmendur
Por edhe në kohë përrallore :
Ku dëgjohen hapat e bebes
Ëndrrat kur udhëtojnë
Vallja e flokëve të borës
Madje dhe muzika e heshtur
E petales së lules
Kur çelet
Por edhe drita e hënës
Yjet që bien
Ndërsa emrat Bodler
Rilke, Eliot, Trakl
Emili Brontë...
Kalojnë aty
Si meteorë.

SIKUR...

Nuk jam më fëmijë
Por dua të bëhem sërish
Të ma prishin lojën
Dhe pa u dëshpëruar
Të nis nga e para.
Gjithçka vjetrohët
Por jo lojërat fëmijërore :
Shrregulla e pranverës
Litari që hidhet
Sa andej-këndej
Pllakat
Me vijat e bardha
Shtëpizat e vogla
Kukullat
Vrapi i lumtur
Për Sylla-mbylla
Apo Ta lashë...
Sikur të bëhem prapë fëmijë
Të gjej atë të qeshur, të dëlirë
E të mos e quaj humbje
Kur nuk jam në krye
Por thjesht provë
Për të filluar e gëzuar
Edhe njëherë...

SFIDA

Atë e kishin veshur me të bardha
Dhe e kishin shtrirë në mes të dhomës
Në gushë i kishin lidhur
Një shall mëndafshi
Bojë qielli
Në gjoksin e saj binin në sy
Me dhjetëra stoli
Për t'u kujtuar njerëzve
Se ajo ishte bërë nuse
Dhe do të ngrihej nga çasti në çast.
Ngjante shumë e hijshme
Mbi flokë kishte një kurorë të bardhë
Sytë i kishte të pulitur sikur ëndërronte
Njerëzit shtyheshin
Për ta shikuar;
U bënte përshtypje
Njëlloj mallëngjimi
Që i ravijëzohej në buzë
Si pas puthjes së parë
Vetëm kryqi i vendosur
Drejt e mbi zemër
Tregonte se kishte vdekur.

KRONIKAT

Ato flasin me gjuhë të ftohtë
Për periudhat e lulëzimit
Të qytetërimeve
Për luftërat
Me vrasje e shkatërtime ;
Për përmbytje
Dhe epidemi ;
Prapë për qytetërime të reja
Për mbretëri
Frone
Dhe aleanca pushtetesh ;
Sërish për luftëra e bombardime
Por nuk flasin për ëndrrat
Shpresat
Dhe dashuritë
As për zhgënjimet
E njerëzve të pafajshëm
Që u vranë heshturazi
Dhe pa u kuptuar.

LIBRI I FËMIJËRISË

Libër imcak
I gdhendur në kujtesë
Me fletëza si mëndafsh
Dhe me vizatime të holla

Askush nuk e di
Sa imazhe zgjoheshin
Kur të mbaja ty në duar
Si të ishte mbushur me ëndrra

Libër i fëmijërisë
Unë të thërras në emër
Që të vish ashtu si dikur
Me mrekullinë e zbulimit.

ELEGJI

Fshat i braktisur
I mbështjellë me pikëllim
Rrugët e tua kanë humbur
Borziloku nuk mbin më
As myshku ;
Trëndafilat janë tharë
Para shtëpive
Lulet e natës japin shpirt ;
Tani nuk ka më
As bagëti dhe as qen
Nuk ka më barinj ;
As zogj që këndojnë ;
Lumi i vogël ka shterrur
Sepse nuk ka më fëmijë
Për t'u larë aty ;
Nuk ka më njerëz
Që kthehen nga puna në muzg ;
As pleq dhe plaka
Që soditin mbrëmjen të harruar ;
Hëna nuk i ndriçon gjethnajat
Ku fshiheshin puthjet e dashurisë ;
Qielli i lartë nuk nxiton
Për ta nderur aty kaltërinë,
Gjithçka është arratisur
Ka mbetur thjesht kujtim.

Në letërsinë arabe mungojnë romanet satirike që simulojnë përvojat tiranike në emër të “socializmit”, me thellësinë me të cilën këto regjime ndryshuan shoqëritë e tyre. Një gjë të tillë e gjejmë dhe e prekim gjatë leximit të romanit të shkrimtarit dhe poetit shqiptar Besnik Mustafaj me titull “Daullja Prej Letre”. Romani i botuar nga Dar Al-Hiwar, i përkthyer nga Adnan Muhamed, i referohet një jete politike të njohur për shumë vende arabe, pasi ajo ka prodhuar një model shoqëror dhe sjelljeje të caktuar midis qytetarëve të tyre.

Romani i Mustafajit përfaqëson një propozim të guximshëm narrativ që satirizon realitetin e prodhuar nga verbëria dhe dhuna e ideologjisë, duke përdorur modele që mund t’i shohim në çdo vend ku individi i nënshtrohet autoriteteve të cilat duan që ai të mbetet i dyshimtë për rolin e tij. Përpyekja më e mirë e autoriteteve është ta konsiderojnë kufizimin e një personi si një vetëpërmbajtje, në mënyrë që njeriu t’i drejtohet vetëcensurimit dhe ta shikojë veten me një sy që vjen nga jashtë, burimi i të cilit është partia, lideri apo aparati i sigurimit. Me fjalë të tjera, njeriu fillon ta gjykojë veten sipas vullnetit të liderit apo partisë.

Romani është më shumë si një serial i historisë. Lexuesi nuk e ka të lehtë të gjejë pikat e përbashkëta midis historive që përbëjnë romanin. Por në fund, rrëfimet formojnë një histori të harmonizuar që tregon një sërë përfundimesh për «përvojën socialiste» (më mirë të thuhet për diktaturën e regjimit të Enver Hoxhës) në Shqipëri. Në thelb, shprehja e mugët, një daulle letre dhe mbyllja ndaj kuptimit të drejtpërdrejtë nëpër histori, ka luajtur një rol të rëndësishëm në shumësinë e kuptimeve të saj, sepse ndonjëherë ajo rrit besimin në shpirtrat e personazheve dhe herë të tjera e shkatërron atë, sipas palës që e përdor atë.

Një propozim narrativ që përqesh realitetin e prodhuar nga verbëria ideologjike dhe dhuna

Lexuesi nuk mund të sigurohet se kjo shprehje, daullja prej letre, është e vetmja e përbashkët midis historive të librit, së bashku me personazhin e Enver Hoxhës, udhëheqësin komunist, sekretarin e parë të Partisë së Punës, derisa ndodh ballafaqimi mes tyre. Nuk ka dyshim se romani ka të bëjë me fuqinë e shprehjes, e cila i jepet tjetrit, për ta lënë atë nën pushtetin e fjalës dhe ta vendosë në një pozicion më të ulët se vetja. Ky është një roman rreth rrezikshmërisë së

“Daullja Prej Letre” i Besnik Mustafajt: Një përkufizim i jetesës nën tirani**

Nga Sumer Shehadeh*

Përktheu dhe përgatiti për botim: Fatrit Beqiri

ligjërimit, si një diskurs nga një nivel më i lartë tek një më i ulët.

Historitë janë pa tituj, vetëm me numra. Ato fillojnë me historinë e ndryshimit të identitetit të Shqipërisë pas rënies së monarkisë, kur Enver Hoxha ngarkon një komunist të riemërtojë rrugët në kryeqytet, përpara se regjimi i ri të fitonte njohje ndërkombëtare, duke e porositur që misioni të mos e kthente në një daulle prej letre. Historia e dytë ka të bëjë me ditëlindjen e shtatëdhjetë të Stalinit, në të cilën një komunist i vjetër paralajmëron Komitetin e Partisë, që kishte kërkuar këshillën e tij, të mos e përsëriste historinë e daulles së letrës me të. Plaku i kishte sugjeruar Komitetit që Stalinit t’i dhurohej shoqja Sekretare e Rinisë Komuniste, për ta ndihmuar atë të kthehej në rininë e tij. Sugjerimi kishte ardhur si rezultat i pleqërisë së tij. Të gjitha tregimet kanë të bëjnë me “komunistët” që ngatërrohen para drejtuesve, përballë urdhrave që u kërkohet të kryejnë pa kuptuar saktësisht rolet e tyre në to. Në këtë kontekst dyshimi, zbulohet besnikëria e tyre e pabarabartë, ndërkohë që u kërkohet besnikëri e verbër ndaj budallenjve.

Edhe misionet që u kërkohen personazheve nuk janë gjë tjetër veçse teste besnikërie. Ajo që shpërfaq fëmijëria shkon në skajet e ekzpozimit, siç ndodh në rastin kur profesori kërcënon nxënësit e tij se kush do të bënte fletoren me njolla boje

do të konsiderohej tradhtar i Partisë dhe i atdheut. Kur një incident i tillë ndodh me njërin nga nxënëset, përballë frikës dhe të qarit e saj, profesori e çliron atë nga frika me argumentin se tradhëtarë janë në Tiranë, ku maja e penës është prodhuar me difekt. Historia nuk mbaron këtu, por përkundrazi fillon, kur batuta e tij kthehet në një daulle prej letre, një histori që lëviz mes krahinave për tradhëtarët e partisë dhe atdheut që fshiheshin në Tiranë.

Në epokën e pushtetit popullor, ne shohim se si pushteti i popullit shndërrohet në një fuqi iluzionesh. Sepse çdokush mund të kthehet në tradhtar, pa kryer tërësisht tradhtinë dhe pa mundur ta përkufizojë atë. Shakaja e profesorit e ktheu paranojën e përgjithshme të krijuar nga politika e Partisë Komuniste në një të vërtetë të rrezikshme. Historitë shkojnë përtej ironisë së zakonshme, deri te madhështia e tyre, te aftësia e tyre për t’u kthyer në realitet.

Edhe në sferën personale, batutat mund të kthehen shpejt në armiqësi, si në rastin ku dy shokë i dhurojnë një qepë të kalbur gruas së shokut të tyre, duke e kthyer dhuratën në mosmarrëveshje dhe shakaja kthehet në një formë vrasjeje. Kjo është gjithashtu një nga mënyrat e Milan Kunderës (1929-2023) për të përcaktuar jetën nën regjimet komuniste. Sa i përket vdekjes, ajo ka një histori tjetër, ku vdekja e vajzës së një komunisti shndërrohet në festë, me fjalimin e Enver Hoxhës për babain e të ndjerës në radio. Në këtë moment vdekja del nga atmosfera e saj e dhimbshme personale në hapësirën

publike ceremoniale që e kthen gjithçka në një rast për të arritur përfitime për partinë ose për “pushtetin e popullit”.

Një roman për seriozitetin e fjalës: Si një diskurs nga më i larti tek më i ulti

Ndoshta historia më e shquar është ajo ku njëri nga personazhet shkëmben rolin e tij me Partinë, kur ai quan djalin e tij Mao Ce Dun, në nder të liderit kinez. Ai komunikon me ambasadorin kinez dhe jeton në kurriz të partisë me mashtrim, vetëm se fundi është i sigurt dhe lexuesi e parashikon atë me vdekjen e liderit kinez. Megjithatë, evgjiti që e ktheu ditëlindjen e djalit të tij në një daulle prej letre, mbetet një hero popullor. Sepse ai mundi të shkëmbente rolin me Partinë dhe dukej se tashmë zotëronte pushtetin e popullit, një autoritet që nuk e zotëronte dikush që e kalonte jetën në shërbim të ideve të partisë, si rasti i komunistit në pension, ndërmjetësimi i të cilit nuk ia doli të nxirrte nga burgu djalin e fqinjit të tij me akuzën e fyerjes së shtetit, edhe pse ishte i çmendur. Dhe dënimi që Partisë i jep atij ngre një pyetje gjeniale: Pse çmenduria nuk i shtyn qytetarët të lavdërojnë shtetin, pse i shtyn ta shajnë atë? Sikur lavdërimi i regjimeve totalitare shoqërohet me humbje të arsyes edhe për përfaqësuesit e tyre.

Tematika e “Daullja prej Letre” i përngjan romanit libanez me titull “Ibriku me vaj”. Romani është shkruar si një histori jo e plotë, një truk, një metaforë misterioze që arti e përdor për një qëllim tjetër. Dhe romani thotë se ata personazhe që Besnik Mustafaj i ka gjetur gati për t’i përfshirë në librin e tij, në fakt nuk janë personazhe të natyrës së lirë, përkundrazi, janë personazhe të krijuara nga partia, janë personazhe të dyshimtë, të frikësuar dhe hapësira në të cilën jetojnë është një hapësirë e korruptuar. E gjithë kjo është për shkak të autoritetit të diskursit, i cili nuk thotë asgjë, por përcakton marrëdhëniet e pushtetit midis klasave të njerëzve.

- * Sumer Shehadeh, i lindur në vitin 1989, është shkrimtar sirian, i pranuar si një nga zërat më të rëndësishëm të letërsisë së sotme arabe. Çmimi i fundit që ka fituar është ai “Naguip Mahfuz” në vitin 2021 me romanin “Al Hegran”.

- **Ky shkrim është botuar me 17 korrik 2023 në gazetën Al – Araby, e cila botohet në Londër dhe shpërndahet në mbarë botën arabe



Eh, Amerika! Një grusht drite që ta përplasnin në fytyrë! Këtë me tha një i porsanjohur në një nga kafenetë e Kuinsit. Unë vija nga një varfëri e turpshme, vazhdoi ai. Sepse dikur ishim të kamur dhe pushteti i ri, që i besuam me pafajësinë e fëmijës, s'na i dha pronat. Histori e trishtë kjo, pothuajse e harruar. Ja, tani jam në Amerikë. Vend përrallor. E dua shumë, megjithëse s'më le kohë të marr frymë. Kisha merak babanë, vuate nga zemra, bërë vrima vrima, e gjora, nga çështja e pronave. Hyja e dilja nëpër kafenetë shqiptare të gjeja një Krisht të me ndihmonte për babanë, po gjeta vetëm Kainin që kërkonin Abelin për ta vrarë. Sepse të gjithë kishin nga një hak për të marrë. S'ta vinin veshin, bënin sikur të degjonin, po rrinin e vazhdonin dialogun me veten. Skuqnin kafenetë nga plagët e pambyllura. Si është puna? do të pyesësh ti. Dua ta sjell babanë në Amerikë, sepse ai ka nevojë urgjente për një operacion. Por s'po më ecën, nëntë herë ka hyrë në ambasadë, nëntë herë nuk e ka marrë vizën... Si t'ia bëj?

Kishte një fytyrë të tretur, sy të futur thellë ne gropa, sikur i faleshin fundit, buzë të thara, flokë të rënë, një shogë që ia shëmtonte kryet, por gjithsesi qëndronte prej një fuqie që nuk dihej nga i vinte. Më ndihmon dot? thoshin sytë e tij gati të fikur, dua të shpëtoj babanë. Unë mund të isha i njëqindti që po më qante hallin. Nuk isha shquar për këto punë madje, në vend që t'i ndreqja, i djallosja, sepse e shikoja jetën si letersi, art, fantazia e mundëte gjithmonë realitetin. Me kohë e kisha bërë njëfarë korrigjimi. Ishte një histori dashurie që e kisha humbur prej gabimeve të mia. Kishin kaluar kohë, por ajo dashuri më ishte kthyer në një plagë që duhej mbyllur, por që s'mbyllej kurrësi.

Të nesërmen e asaj bisede, një vajzë shumë e bukur hyri në kafene dhe u drejtua tek unë; Babi më ka lënë një letër për ju! E lexova. Kishte shkruar në Tiranë, për të shoqëruar të atin që do të jepte intervistën për vizë në ambasadën amerikane. U rrëqetha. Nuk e di përse. Ishte vërtet një vajzë e bukur, njëfarë Kameron Diaz. Ulu, i thashë, merr diçka nga unë. U skuq pak, ngurroi një çast, pastaj u ul ngadalë pa m'u ndarë sytë. Unë nuk po flisja. U turbullova vërtet nga vajza dhe gjesti i të atit. Si iku kështu, po ai mund të ketë humbur punën, i thashë vajzës. E humbi, tha ajo, por s'ka gjë, vetëm gjyshi të vijë dhe të shërohet, punojmë unë dhe mami.

Po ç'do nga unë, mendova, pse beson tek unë? Njeri i çuditshëm!

Ajo porositi një lëng molle, ndërsa unë një konjak hennessy. Ç'sy! Përplot lëng shndritës, pa e fshehur tundimin që të shkaktonin.

Ju shkruani? më pyeti me një zë të ëmbël, përkëdhelës. Nuk i ktheva përgjigje. Ishte pyetja më idiote që më bënte ta neverisja veten, ngaqë kudo më rrethonin antiletrarë të tërbuar. Po ta merrnin vesh se unë vërtet shkruaja dhe botoja libra, do të ma hiqnin fillin. Miqtë e mi të kafeneve bënë punë të ndyra (kështu i quajnë në Amerikë punët e rënda fizike, pa kurrfarë ngjyrimi të keq, siç pandehim ne) dhe një laps që shkruan në një fletë letër, iu shkaktonte të përzier.

Ku e di ti se unë shkruaj? e pyeta vajzën. Ajo bëri një lëvizje të kokës duke qeshur dhe më tregoi çantën time që e mbaja mbi tryezë. Hape, më tha. Unë e hapa dhe nxora dy libra; njëri ishte i Frank O'Hara-s dhe tjetri i Mark Strand, në anglisht. Unë e pashë në sy. Po e pyesja në heshtje se nga i ishte krijuar ideja se unë shkruaja. Dhe ajo po në heshtje m'u përgjigj se e dinte. E ç'rëndësi kishte kjo gjë, fundja ajo s'kishte ardhur për të shuar kureshtjen nëse unë shkruaja apo jo, thjeshtë, ishte aq e bukur sa unë nuk mund ta lija të ikte shpejt.

Sa e bukur është Amerika e vajzave të reja! Sikur të ishte vetëm kaq. Po kishte dhe sëmundje, zemra që nuk prisnin, zemra që kërkonin shërim. Ç'të lidh me gjyshin? e pyeta. Ai më ka rritur. Nëna na la, iku, na la, na braktisi... pastaj u kthye prap. Po kur ajo u kthye unë isha rritur ndërkaq. Tani punon shumë, se do të ndreqë atë mëkat të madh, më la mua në duart e gjyshit dhe ia mbathi me një... Nëna është shumë e bukur! Çuditërisht shumë e bukur dhe, megjithëse punon shumë në pastrime, pak është prishur. Ndërsa babai ka mbaruar...Më vjen keq për të. Mund të bëhet diçka për gjyshin?

Nuk e di, i thashë. Jam njeriu më i papërshtatshëm, nuk e di pse më zgjodhi mua... jam një njeri kot... Ja! Dhe i tregova me kokë të dy librat. Ajo qeshi me zë, uli kokën, ishte skuqur shumë në fytyrë, pastaj m'i nguli sytë dhe s'm'i hoqi. Edhe unë qesha.

Tani do ngrihem, tha, vjen mami dhe unë duhet ta pres.



ROLAND GJOZA

AMERIKA E GRAVE

Tregim

U ngrit në këmbë duke buzëqeshur, më tha faleminderit dhe, para se të kalonte pragun e derës kthehu kokën dhe më lëvizi gishtërinjtë para fytyrës së saj. M'u desh një kohë që të mblidhja veten. Ç'ishte kjo? Ajo i kishte a s'i kishte njezetë vjeç, ndërsa unë pesëdhjetë. Asnjëherë s'më ishte dukur vetja i bukur, as tërheqës, as i dashur me njerëzit, madje isha i ftohtë me ta, gjersa i bëja miq. Me babanë e saj kisha patur vetëm një takim, atë që iu përmenda më lart dhe ja letra e tij dhe vajza e tij e bukur, që më tronditi vërtet, sepse më kujtoi një kohë të largët kur isha ndryshe nga ky që jam sot. Dhe një enigmë që më shqetësonte, më zgjonte kureshtje, si kishte mundur ajo vajzë te zbulonte se unë shkruaja. Kjo gjë, natyrisht më përkëdhelte sedrën, sepse ai që shkruan e kërkon lexuesin.

Në mbrëmje ajo më shkruante në Messenger; Përhëndetje nga unë dhe mami. Ajo është Giti e bukur që tronditi Tiranën në kohën e rinisë tënde. Ke dëgjuar, besoj. Mami ka shkruar një roman për atë histori, po nuk e ka botuar. Une e nxis që ta botoj. I fola për ju. Ajo ju njihte. Ju kishte lexuar diçka. Ajo i tha babit që t'ju drejtohej pikërisht ju me një letër. Ne jemi një familje e çuditshme që adhurohemi për bukurinë dhe urrehemi për bukurinë. Më falni që po ju shkruaj pa ju pyetur më parë. Do të kishit mirësinë të merreshit pak me dorëshkrimin e mami? O, sa do të më lumturonte një përgjigje pozitive prej jush.

E lexova dy tri herë atë shënim dhe ndieva një si thikë në zemër. Giti? Ajo? Jo, s'kish asnjë mundësi të ishte ajo. Jo, jo!

Nuk fjeta atë natë. I ktheva përgjigje; Ma dërgo dorëshkrimin! Kaq. Përgjigja e saj erdhi menjëherë. Mami thotë të takohemi në ndonjë kafene, jo këtu, po në Manhattan. Mirë, ia ktheva, po vij t'iu marr me makinë. Kur? Në pesë. Po dridhesha, e ndieja që po dridhesha, mezi merrja frymë dhe pëshpërisja me vete; Mos, do marrësh veten më qafë... Po ishte e kotë, isha nën rrotën e fatit. Po shtypesha edhe njëherë, por jo si atëherë, në zjarrin përvëlues të një rinie mëndjelehtë, por në një moshë të thyer kur ndien se iluzionet e humbura ia lënë vendin një zhgënjimi pa shpresë.

Në orën pesë pa pesë isha para shtëpisë së tyre. Pashë një perde që lëvizi në katin e dytë dhe pas pak në qelq u shfaq fytyra e saj. M'u morën mendtë. Jo, s'mund të rrija më. Nuk ishte e mundur ta përballoja atë gjendje, më mirë të vdisja. Ishte Giti. Ishte e pamundur të kthehesha

mbrapsht. Ishte jashtë fuqive të mia, edhe sikur të kisha ndihmën e zotit. Erdhën të dyja me vrap. Giti i kishte flokët të lagur, si duket s'kish patur kohë t'i thante. E bija, që quhej, Xhaki, më zgjati dorën e saj, që unë vetëm sa ia preka. Ende nuk po nisesha. E shikoja Gitin nga pasqyra dhe ajo më shikonte mua. Kisha ngrirë. Ç'të bëja? Më përziheshin gjithë ngjarjet e së kaluarës, gjithë ajo bukuri verbuese që u shua papritmas në një çast të vetëm. Gjithmonë kisha menduar se çdo gjë mbaron një ditë, por jo, natyra na jep shembuj se çdo gjë ringjallet përsëri. Vdes dita, lind nata, vdes nata, lind dita. Pas pak do të vdiste dita njujorkeze, por do të lindëte nata, që ishte më e bukur se dita, sepse ne kishim nevojë për errësirën. U nisa më në fund, pa folur. As ajo nuk fliste, as a bija. Duhej të thoja diçka, patjetër duhet ta hapja gojën se kjo heshtje po më acaronte. E sollët dorëshkrimin?

O, sa me fat që jam! Ishte zëri i saj. Po ai zë. A mund të kishte në botë zë të përveçëm? Pse jeni me fat? Që ju do të merrni me romanin tim. Me kënaqësi, i thashë. E pashë nga pasqyra. Dukej e tronditur. Shumë e tronditur. Është një starbaks këtu afër, në 34 street, nëse ju pëlqen, tha ajo. Natyrisht që më pëlqen, nëse ju pëlqen ju. Aty bëjnë dhe amareta shumë të shijshme. Unë i ha pasi i ngjey në kafe. Po, e dija këtë manierë aq joshëse të saj, ia dija të gjitha manierat. Iu thashë të zinin vend dhe u nisa drejt banakut. Porosita kafetë, amaretat, dy çokollata të zeza për vajzën, ndonëse ajo më kërkoi një, pastaj për vete një makiato. Kisha pire atë ditë gjashtë kafe. Më vinte mendja rrotull. U ula përballë saj. O zot, përse? Përse? Ç'ishte ky zhvarrim i tmerrshëm i një kujtimi aq të largët?

Më falni, më tha, me zërin e saj aq ngashnjyes, nuk e besoja që do pranoni, po ju mundoj... vërtet po ju bezdis.

Për mua është kënaqësi, i thashë.

Po përse? Ju jeni të zënë me punë, kohën e keni shumë të çmuar, atë po ja u marr unë...

Siç ma keni marrë dikur... me lumturinë më të madhe, doja t'ia ktheja, po, natyrisht, që nuk ishte koha për t'ia thënë.

Dua të jem e sigurtë me ju. Atë letër nuk e ka shkruar im shoq, po unë. Kam shumë borxhe për të larë...

Ne sytë e saj të mëdhenj kishte shumë brengë. Nuk ishte më ai trup i madh, i ngjeshur, me një ngashnjim të fortë, nuk ishte më ajo krenari dhe guxim për të tërhequr vëmendje, po

një bukuri që më dukej sikur ishte kthyer nga një çmendinë bukurie dhe ishte shëruar tashmë. Të vinte ta merrje në krahë dhe të qaje bashkë me të.

E dni pse ta shkrova atë letër? Nëse ai merr vizën dhe vjen në Amerikë, do një kohë të marrë letrat, po zemra e tij s'pret.

Po pse më zgjodhët pikërisht mua?

Ajo nuk më ktheu përgjigje. Ngjeu një amaretë në kafe, e futi ne goje dhe filloi ta përtype ngadalë.

Ju rrinin me intelektualë, midis tyre janë dy mjekë te rinj që punojnë në Linkoln Hospital. Për njërin prej tyre, një kirurg kardiolog, ju keni shkruar.

E mora me mend se ku donte të dilte, vërtet ishte një mundësi, por unë nuk isha fare praktik dhe pothuajse nuk i kuptoja gjërat që lidheshin me afëra pak të ndërlikuara. Mos duhej dhënë para? Për të, për Gitin, bëja gjithçka.

Ajo u zhvesh para meje, me ndrojtje, nuk kisha parë kurm me te bukur, gjinj, kofshë, vithe aq mërshore e tunduese. Vithet e ngritura lart, përplot vesk, sikur nuk ishin prekur kurrë, një pastërti e pafajësi e përzierë me një mëkat që bënte majë sidomos te sytë e saj që më shikonin ngulmët sikur kërkonin ndihmë. Por me njëfarë frike. Nuk po fotografoja, kishte ngrirë. Fillo, i thashë vetes dhe pastaj iu drejtova asaj; bëni një rrotullim të vogël, pastaj përkuluni... Mbaroi! Vishuni! Pas dy ditësh do të merrni përgjigje. Faleminderit, ditën e mirë. Doli nga studioja, po nuk harroi të kthente kokën e të më përshëndeste.

Kështu filloi. Në konkursin e parë të modës ajo fitoi çmimin e parë. Ishte e martuar me një inxhinier. Kaq dija për të. Më rrethonin shumë femra të bukura, ishin ditë të zjarra, s'më dilte koha të mendoja vetëm për një. Po, sa herë e shikoja, ndieja diçka ndryshe, sikur më takonte prej kohësh, por unë kisha përparësinë ta lija të më ikte, ose prisja kohën e përshtatshme për t'iu kushtuar. Bëja një jetë rozë, pa kokëçarje, i ndërroja femrat, nuk e çoja punën deri aty sa ta ktheja një dashuri në një konflikt mendjeprishës, në një dramë pa happy end, sepse unë i lija femrat. Ajo më shikonte kur e kur, por unë e shtyja kohën kur do të merresha me të. Nuk e di përse. Sikur e ruaja për kohën më të bukur. Më kishte ftohur pak fakti që ajo ishte e martuar. Vetëm kur e pashë të shoqëruar me një rival, një aventurier i lindur, më kapi një frikë e çuditshme; mos po vonohesha dhe po ma merrte tjetri? Por jo, ajo u nda prej tij, ashtu vrullshëm duke i shpëtuar nga krahët dhe ia dha vrapit. Ai nuk e ndoqi. Unë, pa e kuptuar rroja me portretin e saj dhe, kur isha vetëm në shtrat, ajo më vinte në dhomë dhe qëndronte në këmbë duke pritur. Pastaj më zhdukej. Flisnin për të. Ishte një genie që të hynte në mish dhe të ndizte, që e torturonte mashkullin, sepse kishte seksapil kriminal. Vërtet, ajo nuk ishte një natë seksi dhe aq, po një jetë. Veçse paralajmëronte rreziqe dhe ky ishte një nga shkaqet që unë i rrija larg. Me të bije vërtet në dashuri, por unë nuk doja të bija në dashuri, ma shpifte fjala dashuri, sepse e kisha humbur kuptimin për të. Ishim në Itali te Guci, për një provë. Por ajo nuk fitoi. Në vend që të më ngjallej një interesim më i madh, se ai që kisha ndierë më parë, përkundrazi pata një krizë nervash, një gjendje pakënaqësie të hapur. Nuk e di përse më ndodhi kjo, ndoshta ngaqë kisha dështuar, se unë kisha shumë shpresë se ajo do të fitonte dhe tek e fundit pata dhënë një shumë të madhe me para. Ajo qante. Edhe kjo më nervozonte më shumë. Ç'faj të kam, o grua, ç'faj! Të dhashë një mundësi, por nuk që e shkruar. Shkuam në hotel. Erdhi në dhomë tek unë dhe më zgjati një tufë të madhe me lireta. Ç'janë këto? E pyeta. M'i dhanë atje. I numërova; ishin paratë që kisha dhënë për të. Sikur u çlirova nga një ankth i madh. Nuk e di, por tani po e kuptoja se isha vrarë ne sedër, më ishte dukur sikur ma kishin hedhur. Merri, i thashë, jane të tuat! Ajo kishte mbetur si e shtangur, nuk e priste që gjendja ime shpirtërore të ndryshonte menjëherë prej atij grushti me para. Natyrisht, nuk i kishte pëlqyer veprimi im. Kishte pritur të ndodhte diçka tjetër.

Doja që ajo të shkëlqente, të shkruhej për të, të më harronte, po, po, të më harronte dhe unë të bija në qetësi dhe krejt papritur ajo të më shfaqej papandehur në një nga ato mjedise të përbashkët dhe unë, më në fund, të kuptoja se lidhja jonë ishte bërë edhe më e fortë. Isha vërtet një njeri i çuditshëm, i pakuptueshëm me veten dhe me të tjerët. S'më bëhej ta prekja, vetëm e puthja, po kur ndieja brinjët e saj në duar, kockat e gishtërinjve, kofshët delikate, barkun e fushkët, bythët mërshore të ngritura

lart me një ndiesi fine teksa ia mbështillja me të dyja duart, nuk më bëhej me të, nuk e zhvishja dot. Edhe sot nuk e shpjegoj ç'më shtynte ta torturoja, ndoshta mund të ishte një kënaqësi e fshehtë e sundimit të njeriut që të dashuron. Por mund të ishte dhe instinkti i ruajtjes. Prej një dobësie të pashpjegueshme. Më dukej shumë e kristaltë, e thyeshme. E ruaja, nuk e di përse, me një ndiesi ngadhënjimi sikur kisha arritur një fitore, ngaqë arrija të përmbaja furinë e epshit që më pushtonte. Ajo fërgëllonte, vuante. Unë i pëshpërisja; iku ora! Ajo bëlbëzonte; edhe pak! Dhe më vështronte në sy me lutje. Pastaj, kur e pashe midis miqve e mikeshave të saj, aq të lumtur, krejt e pavëmendshme për praninë time, sikur të mos ekzistojë më në këtë botë, e bukur, më e bukur se e bukur, mendova se isha një idiot i lindur. Edhe ajo dinte të luante me mua. Dy javë nuk u shoqëruam, ajo nuk i përgjigjej syve të mi, prekjeve të mia, ndonjë fjale të pëshpëritur në vesh. Nuk e kisha parashikuar këtë ndryshim. Më dukej se ashtu do të vazhdonte historia jonë, unë, fituesi dhe ajo humbësja. Isha i papjekur, në shumicën e rasteve më mungonte arsyeja e drejtë, fitonte gjithmonë sharlatani, aventurieri. Tani ishte vonë për të luajtur indiferentin. Dy javë të tjera nuk i fola unë, as që ia hodha sytë. Ajo më dukej e qetë, nuk vura re të shqetësohej, apo të bënte një përpjekje sado të vogël që të afrohej. U mbyll dhe kjo histori, i thoja vetes, po dëshira e fshehtë që më mundonte ishte që ajo të mos mbyllej.

Të dyja, nëne e bijë, flisnin me njëra-tjetrën dhe herë herë i hidhnin sytë nga unë. Kur shikimet tona takoheshin, ato buzëqeshnin.

Kishin kaluar pothuajse njëzet vite nga ajo kohë dhe mua më dukej sikur gjithçka kishte ndodhur dje. Nuk jam nga ata që dritërohem lehte, mundohem t'i fsheh emocionet, nuk hyj te burrat romantikë që i japin rëndësi ëndrrave dhe nje pjese të madhe të jetës e kalojnë duke i supozuar gjërat, por jo duke i jetuar. Nuk isha praktik, por gjithsesi mendohesha para se të hidhja një hap të rëndësishëm, besoja se shumë punë që më ecnin mbarë, nuk vareshin prej meje po prej fatit. Ç'dëshiroja më behej, edhe të pamundurat. Nuk e di si ndodhte kjo, po një mendje djallëzore, për të këqijat, apo një mendje hyjnore, për të mirat, më ndihnin në hapat që hidhja. Sa me fat, këtij i ecën. E ka të shkruar!Këtë e dëgjoja jo rrallë. Isha i përkëdhelur, më donin, ma pëlqenin tipin, duke më lënë të habitur, se unë pak flisja, pothuajse isha i ftohtë në çështje intime. Kisha kaq shumë femra rrotull, që donin të ngecnin, sa nuk bëja më dallime. Po Giti ishte mbi të gjitha; kishte një sekret në atë kurmin e saj aq delikat, në sytë vëngëroshë, në mollëzat e dala, në gjestet e kursyera, por që kishin një gjuhë më vete. Nuk ia kisha parë asnjëherë të shoqin, as që më interesonte, ai, per mua, nuk ekzistonte. Giti, i thashë nje ditë, pas gjithë asaj kohe të gjatë që s'kishim këmbyer asnjë fjalë, do të vijë nesër një i dërguar i Valentinit nga Milano, për të parë modelet. I kanë thënë se femrat shqiptare janë të bukura. Si thua, të propozoj ty? Ajo nuk foli, e pashë si u drodh, si më pa dhe si i hoqi sytë menjëherë, me një gjest të çuditshëm, sikur nuk i interesonte kjo gjë. E tërhoqa nga dora dhe i pëshpërita; S'mund të rrija më gjatë pa të folur. Ajo m'i nguli sytë që i shkëlqyen nga lotët dhe shkëputi dorën nga e imja, sikur të ndiente se, fjalët që i thashë, nuk i përgjigjeshin atij emocioni të vakët që i përcolli dora ime. Më fal, i thashë, gjithmonë në marrëdhënien tonë, gabimet i bëj unë. Si të duash. Është një shans i mirë për ty. Po të fitosh, mund të ecësh në botën e modës. Këtu ajo sapo ka filluar, është në hapat e parë dhe nuk është se ka ndonjë perspektivë të sigurtë... Unë, edhe pak kohë dhe do ta lë... Do të hap një shtëpi botuese, do të nxjerr revistën e parë fashion, një lloj Elle apo Vogue dhe do të botoj librat e mi. Fotot do t'i bëj vetë. Kjo është pika ime e dobët; fotot! Ose... do të shkoj jashtë përgjithmonë. Ajo nuk fliste, e ndieja që dridhej, donte të ikte, të shpëtonte prej meje, ndoshta kishte marrë një vendim që të mos kishte të bënte më me mua, e kisha zhgënjyer. Mendohu, e dashur! Duhet të dish se ti je e veçantë për mua. Ajo nuk foli. Rrinte kokëulur. U ktheva dhe ika. Nuk e pashë më për një kohë të gjatë. Ajo aty ishte, po unë luaja rolin tim, atë të njeriut që nuk shkon me femra, po ato i vijnë vetë dhe ai zgjedh. Ishte koha e një degradimi të madh, e një zvetërimi, e një përpjekjeje për të dalë nga kjo vorbull e njëkohësisht një përpjekje tjetër për të hyrë sërish në të. Ajo gjithmonë shkëlqente. Por unë e pengoja, bëja të pamundurën që ajo të mos

fitonte atë që meritonte. E kuptoja që isha bërë i lig, por nuk ia falja që më kishte lënë. Fyerjen që më kishte shkaktuar, me shumë të drejtë, këtë të vërtetë s'ia mohoja vetes, doja t'ia ktheja në hakmarrje.

Ajo, ajo, pikërisht Gita, kishte kuptuar dobesinë time; mosnënshtrimin. Ajo nuk sundohej. Atë e sundonte vetëm dashuria. Por unë kisha luajtur me dashurinë.

Ato të dyja po më bënin shenja dhe më buzëqeshnin. Isha diku, diku larg, këtë e kuptova nga shenjat. Po përmendesha ngadalë me një ndjenjë faji. E kisha mundur atë grua. Kushedi ç'pamje kisha marrë! Vajza po habitej me mua, ndërsa unë po çuditesha me to. Ç'ka ndodhur? thashë, pasi u përmenda, a nuk ju ka ndodhur që ndonjëherë t'ju marrë një varkë kujtimesh, po deti ka qëlluar me stuhi? Kjo nuk ishte asgjë, shtova, kjo parti starbaksi, do t'ju çoj në Siçili. Vajza qeshi, ndërsa ajo luajti të habiturën, pa u habitur aspak, sepse ma njihte tipin, sajemat që shpikja në çast. E ç'është kjo Siçili në Manhattan? këngëzoi vajza me zërin e saj aq të ëmbël e lozonjar, ndërsa e ëma vetëm m'i kishte ngulur sytë e nuk m'i ndante. Në Little Italy! Të hamë karkaleca siçiliane me makarona siçiliane. Pastaj do të shohim në Broadway një nga shfaqjet, ç'farë të jetë. Vajza u gëzua shumë, e ëma më shkëlmoi poshtë tavolinës. Si nuk hoqe dorë nga këto surpriza që ma hëngrën kokën, thoshte këpuca e saj me majë që kishte goditur fort, po me ëmbëlsinë më të madhe, këmbën time.

Kaluam një mbrëmje të rrallë; u ndieva vërtet si burri i saj dhe baba i vajzës. Isha më i lumturi në botë. Ajo s'do të punonte më pastruese, jo, kurrë, nuk do të rraskapitej duke fshirë e larë zyra, korridore, banjo, por do të bëhej fotografe e modës (unë pas saj, natyrisht) dhe për një set me foto (nënshkruar prej saj, por bërë prej meje) do të merrte gjer në dymbëdhjetë a pesëmbëdhjetë mijë dollarë. Dhe kështu u bë, pas një jave ish pastruesja e Manhattanit, e një prej hoteleve Hyatt, mori pagën e parë; dhjetë mijë e pesëqind dollarë, honorar i revistës Vogue. Tani vishej ndryshe, bënte make up te një e njohura ime që kishte punuar për filmat dhe tani ishte bërë gjyshe dhe merrej vetëm me nipat dhe mbesat e saj, po përsoste anglishten, akcentin e vështirë, ishte bërë më e heshtur, më tërheqëse, një kopje e mrekullueshme e ëndrrave të mia, një e nënshtruar e trilleve te mia. E kishte pranuar më në fund këtë sundim çudibërës. Nuk më tha asnjëherë faleminderit, jo, as që prisja të ma thoshte, sepse unë po shlyeja gabimet që kisha bërë me të. Shtatë vjet që jetuam bashkë unë i shfaqja tërë karakterin tim të keq; ambiciozin, agresivin, narcistin, ndërsa ajo më fali vetëm bukurinë dhe dashurinë e saj.

Kisha plot borxhe për të larë. Aq shumë, sa nuk dilnin as për jetën tjetër. Jetoja në një shtëpi të vogël me kopsht dhe një pishinë, me dy shtëpiza anash, vetëm fillikat. Fitoja shumë, por nuk tregoja asgjë, s'më hynin në sy këto pasqyrlira, më në fund po shijoja paqen në një nga zonat e vjetra të Nju Jorkut ku kishte shumë shqiptar. Askush nuk dinte ç'punë bëja, po e merrnin me mend se edhe unë isha një nga ata të nomenklaturës së vjeter që isha dërguar me një detyrë të posaçme dhe pagesa e majme më vinte prej andej. Këto i dëgjoja ashtu si me eko dhe më vinte të qeshja. Ndihamoja shumë dhe për këtë shkak nuk më shqetësonin, nuk gërmonin në jetën time. Është njeri i mirë, thonin për mua, vjen nga një familje shumë e pasur dhe tani gëzon frutet e pronave të shumta që ka trashëguar. Thashethemnjat në kafenetë e shqiptarëve janë gjithmonë me barrë. Kisha një fletore të mbushur me emrat e borxhlinjve. Më dhimbseshin të gjithë, po më fort intelektualët. Nuk më vinte mirë që një mjek punonte në pastrime dhe një inxhinier shtronte pllaka. Të gjithë i bëja të njohur, por jo miq. Isha zhgënjyer nga miqtë. Kur me thonin se filani bën tre punë dhe s'ka letra, unë i afrohesha dhe e bëja të njohur. Atij të gjori, një burre i dobët, i thinjur para kohe, sapo kishte bërë këmbë në Amerikë, i kishte vdekur gruaja. Tani jetonte me tre fëmijët; dy në fakultet dhe e vogla në gjimnaz. Tre punë! Edhe ta mendosh të dhemb koka. Po të jap unë një punë të katërt, i thashë dhe i përkëdhela supet kockë e lëkurë. Ç'punë? pëshpëriti i gjori dhe më kapasalliti sytë e përgjumur, arrin koha të bëj dhe një punë të katërt? Po, i thashe, sa herë të vish në kafe, pagesën do ta kesh prej meje. Mos e mbaj dorën, ti ke nevojë për pak qetësi, harresë, divertiment midis miqsh. Ty të duhet një ngushëllim. Ai

qeshi. Po kjo s'është punë, pëshpëriti. Pranoi në heshtje, uli kokën, psherëtiu.

Aty, në atë kafene ishte dhe burri i Gitit. Sa herë më shikonte, zgjaste dorën dhe më tregonte karrigen që të ulesha. Biseda vërtitej rreth babait të tij që rrezikohej të vdiste nga zemra nëse ambasada Amerikane në Tiranë nuk i jepte vizën. Ai s'kishte patur fat. Nëntë herë, nëntë refuzime. Tani ishte e dhjeta. Ishte lodhur. E shikojta nga afër me një interesim të ri; asgjë e veçantë në portretin e tij, po veç zërin e kishte të butë, sikur kërkonte falje. Do të bëj diçka, i thashë. Faleminderit! m'u përgjigj menjëherë. Po si? Ai duhet të vijë sa më parë, duhet të operohet këtu. Patjetër këtu! Që sot unë do të nis dokumentet dhe një lutje që ai të vijë si turist. O, ashtu ai s'vjen kurrë! Ku e di ti? Lëre fare, duhet gjetur një fakt i fortë. Ç'fakt, i thashë, a bënë gjë rekomandimet e mjekëve shqiptarë? A bëri gjë sëmundja e tij? Unë do t'iu paraqis një fakt më të fortë. Le ta provojmë. Ai më shikonte në sy me një shprehje të çuditshme, sikur unë po tellesha me të. Në atë shprehje kishte diçka dhe prej tuhafi. Pastaj fytyra e tij m'u zhduk dhe më doli përpara ajo e Gitit. Bëje për mua, sikur më lutej, atij plaku i kam një borxh të madh. Giti! Dhe përsëri më doli përpara fytyra e tij e ndiçuar me një shpresë të vakët. Kaq budalla të jetë, mendoja, sa të mos e kuptojë se si ndryshoi rrjedha e jetës së bashkëshortes? Nuk pyeste ai njeri, nuk analizonte? Përsëri fytyra e Gitit para meje me një buzëqeshje enigmatike si ajo e Mona Lizës. E ç'më duhej të merresha me këtë njeri? A nuk na ka ndodhur të diskutojmë për burra që i drejtojnë gratë? Për burra të mire, madje simpatikë, të këndshëm, që s'e kanë kuptuar kurrë këtë të fshehtë të grave, fuqinë magjike të bukurisë së tyre, sjelljen e rafinuar, plot stimë, për t'u dhënë atyre të kuptojnë të kundërtën në sy të shoqërisë? Që atë natë bisedova me avokatin tim dhe të nesërmen letrat u nisën. Garanci ishin të ardhurat e mia. Pas një muaji i ati ishte në shtëpinë e tij. Një bablok i mbuluar me flokë dhe mjekër të thinjur, që mbante në kokë një kapele dhe në dorën e djathtë një bastun. Bisedova me dy mjeket që njihja dhe ata më rekomanduan një të tretë, i cili kishte ndihmuar shumë shqiptarë në raste të tilla. Mjekun e quanin Ardian, ishte një djalosh i pashëm rreth të dyzetave që, sapo u ulem, më tregoi historinë e tij. Jam në gjyq me gruan, po divorcohem. Faji është imi. Ashtu ndodhi... Ajo do të qëndrojë bashkë me djalin, ndërsa unë do të kthehem. Po kaloj një periudhë depresioni, jo prej ndonjë pendese, apo kompleksi psikologjik, po më është prishur krejt rituali i përditshëm. Jam si një sahat në tryezën e mjeshtrit që ia ka nxjerrë gjithë ingranazhet për ta ndrequr. Po kaloj nëntë muaj në atë tryezë... Kam zënë me qira një dhomë, një birucë dhe dua sa më parë t'ia mbath, t'ia nis një jete tjetër, në qytetin ku kam lindur, atje ku kam dhe prindërit. Nuk



rezistova dot, u theva. Gratë janë më të forta në emigrim. Veçanërisht kur kanë fëmijë. Edhe unë, i dashur mik, e ndërpreva në një çast kur ai pushoi, uli kokën dhe psherëtiu, kam pothuajse të njëjtën jetë, të njëjtën dramë. Prej veseve të mia humba dashurinë. Isha i ri, nuk e kuptova se një nga ato që kaloja nëpër duar, ishte e vërteta dhe...e humba. Tani e kam gjetur përsëri, por është vonë, tepër vonë, vetëm shlyej borxhe vesesh. Ne, mik, s'duhet të na ecte që në fillim. Duhet të përplaseshim me shkëmbin e durimit dhe të të pamundurës, por ne shkelëm mbi lule. Mbi lule të helmuara. S'më mungon asgjë materiale, i kam të gjitha, por jam i zbrazët. Shkojnë anijet kozmike në henë, por s'gjejnë asgjë. Unë kërkoj brenda vetes, por më janë bërë shkrumb të gjitha. Kam mbetur fillikat midis bollëkut material. Vetëm që s'jam në proces gjyqësor si ty, por në një proces tjetër me veten, që e kam humbur. Tani dua t'i bëj mirë një të njohuri.

Ai më dëgjoi i përhumbur, sikur nuk e kishte shumë mendjen në ato që i thoja unë, madje disa herë vija re me bezdi se e humbte fillin, më bënte pyetje që s'kishin lidhje me rrëfimin tim. Në fund më tha; Ka vetëm një zgjidhje, nëse ai është aq keq, siç më thua. Edhe po të shënohet në listen e operacioneve, i bije të hyjë në sallë pas nja tre, apo katër muajsh, se ka radhë të madhe. Por ti më thua se koha s'pret... Atëherë merre atë plak, në mëngjes herët... nesër... se nesër jam në urgjencë, thuaj të rrëzohet në rrugë... merre dhe sille... Para se të vish më bëj një telefon...pastaj punët i rregulloj unë... Ai do të trajtohet si një homeless.

Jo, thoshte plaku, nuk mund ta bëjë këtë gjë... s'ma lejon karakteri...këtu paska shumë korrupsion! A do të shpetosh nga vdekja? Ç'të thanë mjekët në Tiranë; perëndia po të mbron, paske bërë të mira, se ti duhet të kishe vdekur me kohë. Jo, nuk e përmendën fjalën vdekje! shfrynte plaku. A je në vete, bindu, shumë shqiptarë keshtu kanë shpëtuar nga vdekja. Ky nuk është nje vend i korruptuar, po një vend humanitar. E di sa kushton një operacion i tillë? Më shumë se njëqind mijë dollarë. Ti s'ke dokumente qëndrimi, s'je resident, a kemi ne kaq para? Kush i paguan? Shteti amerikan. Mbyll një sy e bën sikur nuk shikon për të ndihmuar të varfërit. Propagandë po më bëni? hidhej plaku; kam dinjitet! S'kam marrë një herë borxh në jetën time! Bukës thatë i kam thënë; faleminderit zot, që më siguron dhe këtë copë bukë! E dimë, e dimë, i thoshte Giti, baba, nuk është koha për të thënë nga këto, ne e dimë se kush je, unë mezi të kam pritur dhe të dua gjallë, të jetosh edhe njëqind vite të tjerë! Baba, ne të duam shumë, këte mos e harro, prandaj bindu! E di, moj bijë, po s'e bëj dot. Oh, unë i mjeri!...

Ishte një plak i mirë. Edhe kur ra e shkau, filloi të qajë, edhe në makinë qau, edhe në vig kur e morën infermierët dhe e çuan lart. Shikojta pas deres me xham se si e ndërruan, e lanë, e veshën me rroba të pastra (duke e ditur se ishte një homeless rruge) dhe i vunë serumin. E di sa ilaçe ka aty brenda, në atë lëng? më tha Ardiani, mbi pesëdhjetë. Pastaj shtoi; çdo ditë e humbur mund t'i kishte shkaktuar vdekjen. Pas tri ditësh u krye operacioni. Një javë më vonë plaku ishte në shtëpi.

Giti ishte bërë sunduesja ime, pa më sunduar. I bindesha. Kisha kënaqësi t'i bindesha. Ja, ç'më tha; Këtu, në Amerikë, një pjesë e madhe e grave mbajnë burrat. Bëjnë nga dy tre punë. Kjo është Amerika e grave. Im shoq e humbi punën. Për babanë. Ai po kërkon një punë tjetër. Është shumë punëtor. Nuk e përfytyroj dot në pension. Të kujtohet atëherë kur më le? Ishim në Francë. Unë qaja, vazhdimisht qaja, sa herë ti më lije vetëm, qaja për vajzën. Kisha braktisur një dashuri për një tjetër, që s'po më përgjigjej. Ti, jo se s'më doje, por s'të dilja unë. Kërkoje, provoje, gjersa zhgënjeheshe dhe ktheheshe sërish tek unë. Une nuk i shijoja më dritat e qyteteve më të bukur të Europës. Vallëzimet, netët e modës, pasarelat, sepse mungesat e tua të shpeshta më kujtuan se ishte një dashuri tjetër që më priste, një dashuri pa mungesa, ime bijë. Dhe atë e kam me ty. Nuk e mbaj dot të fshehtë. Ajo është bija jote.

Kjo ishte ajo që më priste. Ishte një gjendje e paprovuar ndonjëherë. Pata një si errësim të çastit, një humbje të vetëdijes dhe një mendim që me erdhi befas; mirë të bëhet, këlysh kurve! Bëre qejf sa deshe? Ja dhe fundi! Ishte një vajzë që e gëzonte një tjetër, një grua gjithashtu, që e gëzonte një tjetër. Ç'shpërblim kisha marrë!

Për Lizën kisha menduar se duhej të shkruaja një tregim të realizmit socialist. Ajo kishte qenë kooperativiste e dalluar në një fshat të jugut të Shqipërisë dhe rrëfimin për të nuk mund ta bëja ndryshe, përveçse si nostalgji për atë kohë të lumtur dhe për bëma njerëzish gjithashtu të lumtur. Por nuk ndodhi ashtu. Socializmi u rrënua shpejt dhe metoda e realizmit socialist u thye në mënyrë të pariparueshme. Kjo ndodhi pikërisht në rrëfimin për Lizën.

Kur e pash Lizën për herë të parë, më ngjau me një Nurien e katundit tonë, për të cilën një herë kam rrëfyer kalimthi, atë Nurien me zë të trashë, të cilën seç e pash një herë në ahur duke u larë, mandej iu tregova shokëve të mi për këtë, mandej shkuaam të gjithë me e pa nga vrimat e derës së ahurit, mandej ajo... Por, le t'i kthehem Lizës së realizmit socialist, Lizës vithegjere dhe këmbëfyllake, dhe kooperativiste e dalluar. Një ditë asaj Lizës iu qep në mendje të bëhej grua dhe kuturisi dhe ra në dashuri me një oficer të ri të një reparti të afërt. Ishte pranverë e vonë dhe me oficerin e ri, në një nga ato ditë, u futën në shelgjishten pranë, aty bënë dashuri dhe po atë ditë vendosen të martoheshin. Por ndodhi që reparti ushtarak u mbyll krejt befaz një ditë dhe oficeri i ri u zhduk pa gjurmë. Ndërkohë, Lizës që nuk i bënte punë më vrulli revolucionar i kooperativistes së dalluar, atë fillim vere i shkrepri në kokë të mos mbante të linjta, ndërkohë që një fletërrufe mbeti e ngjitur në tabelën e shpalljeve në hyrje të kooperativës, në të cilën thuhej diçka për Lizën që bridhte livadheve duke kënduar. Kjo ishte arsyeja që, atëbotë, Liza të hynte me rrëmbim në zyrën e kryetarit të kooperativës dhe tre burrave që ishin aty ua ngriti fundin prej doku dhe ua tregoi vithet e bardha, pa të linjta.

Kështu ra socializmi në Shqipëri dhe rrëfimi për Lizën nuk mund të vazhdonte më tej sipas metodës së realizmit socialist.

Sapo u mbyll kooperativa, Liza mori ca gjëra të pakta dhe u nis në kërkim të oficerit të ri. Matanë kënetës gjeti një barakë të braktisur të rojave bregdetare, në një shpat të mbuluar me një blerim të gjithmonshëm të larit dhe qarrucës. Atje Liza qëndroi tre muaj. Nga ajo pritje e gjatë iu zmadhuan sytë dhe në dritaren e vogël të barakës deti u bë i trishtë. Një ditë prej ditësh Liza i shkroi një letër oficerit dhe aty i tha çka kishte për t'i thënë, e fërkoj letrën pas trupit të saj, e mbështolli mirë dhe e shpuri në zyrën e postës të një qyteze të afërt. Nuk kishte adresë, por letrën ia la në besë një roje të kotur të bashkisë, pastaj bëri një ditë rrugë për t'u kthyer, me hap të mendueshëm dhe me një brengë djegëse në shpirt. Ende pa arritur te baraka në cep të kënetës, u ndal mbi bregoren e afërt, e shikoi gjatë detin dhe largësitë që përmbyseshin në të. Nuk dinte sa duhej të priste, madje nuk dinte as si ta maste kohën, sepse deri atëherë çdo gjë e kishte bërë për të kooperativa. Madje, edhe shpjegimin se ku shkonte dashuria kur nuk ishte më, e kishte bërë brigadierja, ose dikush i ngjashëm me të.

Së fundi, trokiti në derën e saj një peshkatar i lagunës, një djalë fytyrënjomë dhe truphollë, i cili kërkoi diçka të paqartë, ndoshta një rrjetë peshkimi, ndoshta një grep, ndoshta një



MEHMET KRAJA

Rrëfim për Lizën dhe realizmin socialist

Tregim

fuzhnje, mbase as ai vetë nuk e dinte, por Liza e kapi shpejt vështrimin e tij që iu përshkua nëpër gushë, hetoi një sëmbim të mprehtë nëpër krejt trupin dhe vërejti se ajo brenga e saj e dashurisë së humbur u davarit në çast. E futi djalin brenda, e shtriu në shtratin prej dërrasash dhe bëri me të dashuri një stinë të plotë dhe disa ditë më shumë. Një ditë djali fytyrënjomë doli nga baraka dhe nuk u kthye më.

Vitet kalonin dhe në derë të Lizës trokitën një pas një peshkatarë të rinj e ca më të moshuar, rremtarë lundrash dhe ushtarë pa reparte, roje magazinash të zbrazëta dhe të tjerë kalimtarë rasti. Shkonin dhe vinin, të gjithë duke lënë prapa një njollë mbi rrogozin e vjetër, erën e rëndë të djersës dhe gjakimin e saj të pashuar për vesin perëndishëm të dashurisë. Nuk e ndjente më as brengën dhe as vetminë e dikurshme. Por, një ditë ndodhi që Liza, si krejt papritmas, pas shumë kohësh nisi të mendonte për veten e saj. Në një pasqyrë të vogël varur në mur, pa një ditë vrugun e errët për nën sy dhe pa dy rrudha të zgjatura që i harkoheshin mbi buzën e epërme. Hoqi rrobën që mbante veshur dhe zu

të shikonte pjesë të ndryshme të trupit të vet. Po më atë pasqyrë njëditëzaj shikoi qimet e dendura dhe të zeza të fundbarkut dhe diku, në një vend, si shkumëzim i lehtë vale, pikasi ca qime të bardha, të cilat dukeshin dhe zhdukeshin shpejt. Dhe atëherë Liza u dëshpërua pa masë.

Atëbotë, Liza mbeti disa çaste me sy në dritare, prej nga vinte një dritë e hollë dhe e kaltëreme. Fijet e holla të asaj drite bënë një si napë të tejpushme dhe nën atë napë të hollë si prej krahnezash gjeti një ëndërr të saj vogël, nga ato ëndrrat që tashmë i kishte braktisur dhe shumë rrallë i sillte në kujtesë. Një herë e një kohë kishte ëndërruar të bëhej nuse dhe të vishte një vello të bardhë, pastaj të shkonte në qytet, atje të bënte një foto të madhe sa një kapak dritareje, foton ta vendoste në xham dhe xhamit t'i bënte një kornizë të praruar, tamam prej floriri. U ndal ta shikonte atë foto që nuk e bëri kurrë dhe, ndërsa sodiste herë vellon e herë blejtë e flokëve rrëshqitur anash, herë ballin e gjerë dhe herë mollëzat e faqeve me një të skuqur të lehtë prej purpuri, ndihej çuditërisht e lumtur. Por

ndodhi një herë që, krejt rastësisht, u ndal para asaj fotoje që nuk ishte dhe atje iu duk vetja e vetmuar. Iu duk sikur shikimi i gruas përtej xhamit ishte disi i huaj, i largët, brengëndjellës dhe i pakapshëm.

Pra, një ditë Liza hetoi se ajo vello e ëndërrës së saj nuk e shpinte drejt lumturisë, si një herë e një kohë, por drejt dhembjes dhe roitjes. U mendua gjatë dhe e kuptoi përse ndodhte kështu. Në atë foto nusërie që nuk e kishte bërë kurrë, ishte vetëm ajo dhe vetmia që e rrethonte, kishte filluar ta moliste. Bëri përpjekje që në përfytyrimet e saj foton ta bënte me të gjerë dhe pranë vetes të vinte një burrë, ta bënte të ngjashme me fotografitë që gratë i vendosnin te koka e shtratit në dhomën e fjetjes, që atje të rrinin përgjithmonë, të mbuluara me një harresë të trishtë. Qëndroi e stepur. Nuk diti cili burrë t'i bënte vend në krah dhe nuk diti cili prej tyre ta linte në atë harresën e urtë e të ftohtë, e të lumtur njëkohësisht. Në atë pamje të ëndërruar, sado që me mendjen e saj i rrethonte me kornizë të praruar, ata bëheshin të ajërt, të papeshë. Vetëm një çast rrinin aty, që ta shikonin me qesëndi dhe pastaj iknin pa kthim. Mendoi se në socializëm jeta e saj do të ishte ndryshe dhe rrëfimi për një kooperativiste do të duhej të kishte përfundim të lumtur. Këtë ide e kishte ndjekur nga fillimi.

Më pas Liza u mësua të shikonte detin, i cili shtrihej atje përtej, i kaltër dhe i pakuptimtë. Kishte dëgjuar të thuhej se nëpër atë det mund të shkohej diku larg, në një botë tjetër, që ajo nuk e dinte ku gjendej. Një natë e pa hënën e plotë mbi det, teksa krejt pamja kridhej ngadalë në një shkëlqim argjendi. Sekush i kishte thënë një herë se dashuria është një dhe e përjetshme, si hëna, se vetëm netët ishin ato që e ndërronin pamjen e saj. Disa nga burrat kishin ikur nëpër natë dhe ajo kishte ndjekur hijet e tyre që largoheshin, që zhdukeshin në errësirë. I kishte ardhur të qante për ato hije që dvareshin në atë mënyrë. Në të vërtetë, ajo nuk dëshironte asgjë të qartë, asgjë që mund të shihej, asgjë nga ato që kishte dëgjuar të thuheshin: donte të merrte një fluturim të shpejtë, të largohej, të ikte, të mos ishte aty, të mos mendonte për asgjë, të mos e ndjente peshën e trupit të vet dhe të kujtimeve që e lidhnin me të, t'i ngjate një flurome, një ajri, një kaltërsie, një asgjëje që nuk dinte ku mund të ishte.

Po atë natë, në pjerrinën matanë lagunës, atje ku deti merrte një harkim të lehtë anës tokës së papërmbytur; atje ku kishte qenë një herë e një kohë baraka e rojeve bregdetare, u pa një zjarr që digjej në mes të natës, duke hedhur anash shkëndija të vogla, që shuheshin pa gjurmë. Pak më andej, i kredhur në errësirën e natës, deti e pa zjarrin që përfshiu barakën me flakët e mëdha dhe me dëshirën e fshehtë ta zhdukte pa gjurmë, por vazhdoi të qëndronte i heshtur në pellgun e tij, krejt i qetë, indiferent dhe i patrazuar.

Po të mos kishte rënë socializmi në Shqipëri dhe bashkë me të mos të binte edhe realizmi socialist, Liza do të duhej të vdiste duke mbushur kova uji, për të fikur zjarrin, që mund të kishte përfshirë stallat e kooperativës, por nuk do ta digjte veten nga dashuria e munguar.

Mbase edhe asaj mund t'i pëlqente më shumë një vdekje e tillë.

Do t'ju tregoj rreth një nate të përcjellë në një atmosferë krejt të veçantë në Parisin e vitit 1910, në një pallat të bulevardit të rrallë të Fushave - Elysees, në shoqërinë më pretenduese të metropolit, me dukë, markezë, njerëz të politikës, financierë të mëdhenj, diplomatë dhe aktore të shquara.

Ishim tre të rinj rumunë. Unë isha më i riu, rreth njëzet vjet.

Dy të tjerët, disa vite më të mëdhenj, ishin djem parallinjsh, studentë në Drejtësi, shefa të ardhshëm të kabinetit të ndonjë xhaxhai ministër, parlamentarë të ardhshëm dhe dhëndurë pasanikësh, bankierësh dhe personalitetesh politike. Nuk para i hapnin librat. Paratë e dërguara nga familja i shpenzonin ditët e para të muajit, ndërsa javët e tjera rronin nga lekë të gjetura me vështirësi. Sidoqoftë, ishin djem të mirë. Moskokëçarës simpatikë, të shkathët që s'e vrisnin mendjen për veprimet e tyre, ata nuk dalloheshin aspak nga studentët e tjerë të pasur rumunë të Lagjes Latine, asaj qëndre të Parisit ku ndodhen shkollat dhe ku qëmoti bridhnin pa fund të huaj, bohemë dhe shitëse të atelieve, lagje: jeta dhe magjia e së cilës janë përshkruar me solemnitet nga shumë shkrimtarë.

I varfër dhe i vetmuar, u miqësova me ata dy bashkëatdhetarë, që të mos mbetesh aq shumë i vetmuar dhe aq shumë i varfër. Në shoqërinë e tyre, i ftuar prej tyre, mund të ushqehesha, herë pas here, në një restorant luksoz dhe mund të kaloja orët e vona të natës në tarracën e kafenesë “Fouquet” në Champs-Elysees.

Në darkë vishnim frakun dhe në kërkim të aventurës, kalonim Senan, drejt qëndrës së Parisit, në bulevardet e mëdha, përreth Operas dhe kabareve të Montmartre.

“Aventurë” ishte takimi me ndonjë rumun të pasur, i porsa pikuar nga atdheu, i cili vinte në Paris të argëtohej, para se të shkonte në Kepin e Kaltër, të luajë letra dhe në ruletë në kazinotë e Nisës, Kanës dhe Monte-Karlos.

Të rinj, elegantë, hynim në lokalet më të dëgjua të natës, duke i parë klientët e tjerë nga sipër, duke patur shprehjen e atij që kërkon dikë që po e pret.

Dhe më se një herë ndeshnim viktimën e kërkuar, pasanikun moldo-vllah, i cili na ftonte në tavolinën e tij.

Më i zhërvjellti nga ne ishte “shefi”, Stelikë Fërkëshanu, pasuesi i disa latifondistëve krajoen, babai i të cilit kishte qënë shumë herë minister. I dyti, Barbu Vukulesku, ishte dhe ai djalë pasanikësh nga Buzau. Përmes prindërve njihnin shumë njerës. Unë, siç ju tregova isha më i riu dhe më i urti.

Frakun e kisha marrë borxh, kapelën cilindrike ma kishte dhuruar një bukureshtean që mori doktoraturën, iku në shtëpi dhe nuk kishte si të merrte në bagazhe kapelen e papërthyeshme.

Siç e dimë, Fërkëshanu dhe Vukulesku e prishnin bursën mujore që javën e parë, duke shpenzuar budallallëkshe dhe duke humbur orët e leksioneve. E dinin se nuk do vdisnin urie, pronari kishte besim tek ata, ndërsa ata i besonin yllit të tyre dhe zemërgjërësisë së bashkëatdhetarëve dhe ata ish studentë, të cilët kishin kaluar gati të njëjtën jetë dhe rijetonin rininë e tyre në shoqërinë tonë.

Djemtë e Lagjes Latine na vunë nofkën “Tre musketierët”. Rreth orës 9-10 të mbrëmjes hiqnim armët, domethënë frakun dhe kapelen cilindrike dhe merrnim për nga “Café de Paris”, “Café de la Paix”, “Café Anglais” dhe gjithë atyre restoranteve të quajtura cafes.

Një natë kishim hyrë në një kabare luksoze në Montmartre. Një lokal plot me njerëz, të cilin e kontrollonim me shikime prej shqiponje perandorake dhe prej njerëzish që kërkojnë të ftuarit, ose zotërit e shtëpisë. Në një tavolinë mbretëronte e vetme një zonjë e huaj, mjaft në moshë,



Viktor Eftimiu

TRE MUSKETIERËT

Tregim

Përktheu nga rumanishtja

Pandi Bello

e lyer fort, e ngarkuar me bizhuteri, e cila duke parë se s'kishim vend, na buzëqeshi ëmbël dhe na ftoi në tavolinën e saj. Na ofroi midhje, pëllumba të egër, shampanjë.

Ishte dhe ajo ndoshta në kërkim të “aventurës”. Tre zotërinj, të rinj, të pashëm, shumë të sjellshëm, të huaj edhe ata, i kënaqnin , ndoshta, dashurinë e saj prej bukurie të perënduar. Një çast dallova se vështronte përmbi kokat e klientëve në një tavolinë ku hanin darkë dy zonja, shumë elegante dhe ato, të shoqëruara nga dy zotërinj impozantë dhe të thinjur. Njiheshin ndoshta. Hidhnin buzëqeshje përtej tavolinave. Kisha përshtypjen se zonja jonë mburrej para dy zonjave të huaja duke i u thënë me sy: “Ju jeni dy, me dy pleq, unë jam një me tre të rinj bukuroshë!”.

Na gostiti si një guvernatore e vërtetë, na dha adresën e hotelit ku banonte(“Ritz”) dhe na tha se është vetëm në Paris dhe se do ti pëlqente të shihemi përsëri, të dalim bashkë.

Të zënë me një delegacion ekonomistësh nga vendi, në rolin e ciceronit, të cilët na shpagonin me tavolinat plot, nuk e kërkuam nja 10 ditë.

Një mbrëmje, pas largimit të çetës ministeriale rumune, me që ishim nga fundi i muajit, pra me xhepat bosh, shkuam në hotel “Ritz”, të kërkojmë zonjën mikpritëse. Por ishte larguar, buzëmbremjes përtej oqeanit.

-Ç'do bëjmë vëllezër? – na pyeti “shefi” Stelikë Fërkëshanu.

Pa një qindarkë, fringo dhe me këpucët e lustruara, me këmishë që shkëlqenin, me kapelet mbi vetull, shkuam në Piacca Concordia, pastaj në rrugën paralele me Avenue des Champs-Elysees, një rrugë e kufizuar me pemë plot gjethe, me kopshte dhe “hotele personale” plot pasuri. Ndërmjet këtyre hoteleve luksoze, banesa pasanikësh të mëdhenj, ndodhet pallati

famoz dhe parku i markezes de Pompadour, sot rezidencë e presidentit të Republikës.

Para njërit prej këtyre pallateve qëndronin njerëz me veshje plot shkëlqim, madje edhe disa automobila. Automobila të tjerë dhe pajtona shtëpie, me shambellanë të veshur pa shije, mbërrinin vazhdimisht, duke sjellë një shoqëri elegante, e cila zbriste në platformën me lule dhe përmes një shkalle mermeri, të mbuluar me një qilim të kuq e të trashë, depërtonin në sallonet e gjëra, të ndriçuara nga llampadarë me qindra drita.

Një pritje në stil të lartë.

-Çdo të ishte sikur të merrnim pjesë edhe ne?-tha Stelikë Fërkëshanu dhe u nis drejt shkallës madhështore prej mermeri, i ndjekur nga Barbu Vukulesku, po aq serioz sa ai.

Unë i ndiqja dy hapa larg, duke përjetuar kompleksin e inferioritetit të njeriut që ka veshur një frak që nuk i përket.

Në krye të shkallëve pritëshim nga të zotët e pallatit, një zotëri dhe një zonjë, të dy flokëbardhë, krela-krela dhe me faqen rozë, të rinuar. U përkulëm në mënyrë ceremoniale. Të zotët e shtëpisë na pritën buzagaz dhe pak të çuditur.

Ndodheshim në shtëpinë e një personazhi të rëndësishëm financiar, markez dhe në të njëjtë kohë metalurgjist, i cili kishte uzina të shumta dhe degë të tyre jashtë vendit. Kalum vjedhurazi mes zotërinjve të shumtë me frak dhe zonjave me toalete elegante që shkëlqenin nga diamantet. U gjendëm, kuptohet, tek bufea, ku shërbenin njerëz të veshur me uniformë me shirita, që vezullonte. Byrekë me mëlçi pate, ngjala të prera, trofta të ngjyera në xhelatinë, fazanë dhe pëllumba ishin rradhitur në tava të gjata prej argjendi. Ne nuk dinim çfarë të zgjedhim. Na gostitën si perandorët. Pimë edhe shumë kupa shampanjë.

Ndoshta bëmmë keq, sepse kjo pije fisnike

na dha një gjëndje të mirë dhe një vrull që duhej konsumuar. Shëtitnim në shtëpinë e milionierit si në një çiflig të babait, duke përshëndetur djathtas dhe majtas, sikur të ishim nipërit trashëgimtarë të atij markezi, pasanik i madh i metalurgjisë. Ftonim në vallzim zonjusha bjonde dhe zonja të pjekura, të cilat nuk i njihnim, pastaj i shoqëronim tek bufea, me përkulje e plot sjellje prej xhentëlmeni.

-Ndjehuni si në shtëpinë tuaj!-na inkurajonte shefi, Stelikë Fërkëshanu, Lart zemrat!

Në një moment grupit tonë i afrohet një gjatolli impozant me një shënjë plage në faqen e majtë. Ktheu jakën e frakut, na tregoi stemën e inspektorit policor dhe me shumë edukatë na pyeti :

-Ftesat tuaja?

Me të njëjtën kujdesje kërkuam nëpër xhepa ku, dihet, nuk ekzistonte asnjë ftesë.

-Bëni mirë të zhdukeni me të katra!-na këshilloi në mënyrë autoritare përfaqësuesi i Sigurimit publik.

-Siurdhëroni zotëri!-u përgjigj Fërkëshanu, duke përshëndetur me dy gishtat në tëmtha njeriun e autoriteteve, xhest të cilin e bëmmë edhe ne, dy musketierët e tjerë.

E morrëm me të shpejtë drejt daljes, duke zbritur shkallët prej mermeri ngadalë, me dinjitet, si njerëz të rregullt, të ngopur nga kaq pritje dhe të cilët nuk kanë për të humbur netët në argëtime. Dhe ja, arritëm jashtë.

Gjithë disponim vonoheshim në trotuar pa ditur nga t'ja mbajmë. Kur pamë të vijë drejt nesh inspektori i policisë, i shoqëruar nga dy tipa të tjerë.

-Zotit markez i erdhi keq për largimin tuaj dhe ju lutet me insistim të ktheheni!-na tha me shumë dashamirësi polici.

Kishte diçka të habitshme në këtë ftesë.

-Na vjen keq...por duhet të jemi në shtëpi para mesit të natës!

-Ju lutem!-këmbënguli në mënyrë urdhëruese njeriu me çikatriçe.

Dhe, tre agjentë na morrën për krahu dhe na tërhoqën pas tyre në shkallët e mermerta të mbuluara nga qilimi i kuq. Një heshtje e çuditshme zotëronte tani në pallatin luksoz, me dyert e mbyllura dhe të ruajtura, diçka e pazakonshme. Duket se, disa minuta pas ikjes tonë, zonja me flokët e bardha krela-krela, autorja e pritjes, konstatoi humbjen e varësës së saj të trefishtë me perla të vërteta.

Policia, e pranishme si gjithmonë, me kujdes, në këto pritje, ku shkëlqejnë xhevahire prej miliardash, kontrollonte çdo të ftuar.

Në mes të tyre ishte duka plak i Montmirail, shefi i një prej familjeve më të vjetra të Francës, një aristokrat i rënë, por me prestigj të madh, të cilin fisnikëria dhe borgjezia e pasur ishte shumë e nderuar ta kishte në mbrëmjet e tyre.

-Unë nuk lejoj të më kontrollojnë!-i u përgjigj duka policit që e ftonte të tregojë xhepat.

U bë një rreth përqark të respektuarit plak. Grupi i Sigurimit nuk guxoi të këmbëngulë.

Menjëherë, në gjithë sallonin kaloi një si erë e shurdhuar, prej çtendosjes së frymëmarjes. E zonja e shtëpisë e kishte gjetur varësen me perla, e cila, për shkak të fustanit me dekolte, i kishte rënë në gjoks. Grupet u prishën dhe u formuan grupe të tjera.

Tre musketierët i u afruan shefit të shtëpisë Montmirail.

_Zoti dukë, i u drejtua Stelikë Fërkëshanu, jemi tre të rinj rumunë që guxojmë t'ju përgëzojmë për qëndrimin e denjë prej aristokrati të madh që mbajtët pak më parë.

Miq të mi të rinj nga Rumania-na u përgjigj duka i Montmirail-nuk e bëra për shkak të krenarisë së klasës time, por kisha në xhepin e pantallonave një sanduiç, të cilin e mora te bufeja për mëngjezin e nesërm dhe nuk doja të ma shihnin!

Ti nuk e di se ç'po merr tek unë

Nëse do të doje ta përjetoje temperaturën e
ferrit-
Je në vend të duhur.

Jam në gojën e detit të zi.
Goja ime është reflektuar aty
Një humnerë e frikërave të mia.

Nuk dua të vdes përpara
Se ta shoh paqen.

Për një poet palestinez

I dashur mik,
Ta dhuroj poezinë si një copë mishi të
gjakosur nga skajet
e poezisë sime të grisur.
Mesnata mes nesh shënon një kufi.

Ti thua: "Unë jam prej këtu" dhe me pyet
Prej nga vjen ti? Prej nga vjen
Ti?
A nuk jeton në tokën time?

Një erë m'i bartë larg vitet e rrëmujës në këtë
vend bishe
Që i çon këmbët e mia të ecin nëpër botë, që
thith nga unë
Nga gjoksi i tokës nënë.
Unë? Ti do ta dish se prej vij unë?
Nga këtu.

Po, jam këtu me gjenerata, nga historia e
pluhurosur mbretërore,
Jam prej këtu.
A e njeh historinë?
A e di se çka ka pasë këtu përpara se ti të
shkelje

Mbi këtë tokë?
Para se gjyshi yt ta lëronte
Këtë tokë?
Kjo më lëndon mua dhe e kuptoj plagën. Por
më fal,
Jam e përndjekur dhe kërkoj të kthehem
Në tokën time të sigurt.
Jam hebreje.
Sa më shumë që u enda, eca në sigurinë e
gdhendur,
Tokë e kokës së prerë.
Po, kjo është vendlindja jote, por të miat janë
uji, pluhuri
Shkëmbi dhe gurët ranorë
Për 5000 vite.
Këtu isha e shënjuar. Këtu u vendos fati im.
Nga këtu u përjashtuam. Nga
Këtu u mallëngjeva. E fsheha identitetin tim
në mërgim që të mbijetoja. Të lidhesha
me turmën
E një populli aty ku mbeta.
E mora një vizë për këtu kur në Bashkimin
Sovjetik për vite me thanë
"niet".
Trishtimi yt është
Edhe trishtimi im.

Si fjete? Më pyete në WhatsApp pak para
muzgut, para se dielli të
gurgullojë.

Ëndrra ime bredhte nëpër botë. Kryqëzonte
oqeane, lugina dhe vreshta. Tejkalonte
Mure, kontrata dhe rrënoja të luftërave.
Refuzim të të folurit në gjuhë të huaja.
Vetëm dashuria kishte një gjuhë.
Edhe unë po ashtu jam e përndjekur nga
hijet. Jam një viktimë duke bartë maskën
e fituesit.
Shkruaj, poet. Shkruaji të gjitha!
Lotët e mi i derdha në bojën tënde dhe me
lotët e tu zanorizoj
Shkrimet e mia.
Poezia është e vetmja autonomi që na ka
mbetë në një botë të errësuar.
E vetmja copë e lirisë. Vendi i vetëm. I vetmi
shpëtim.
Ndonëse ti nuk e njeh shëlbimin.
Megjithatë, ti je një anarkist që beson në një
dorë të plagosur dhe kryesisht
të dashuruar.
I gatshëm t'më takosh edhe pse historikisht
jam armiku yt.
Si flenë, miku im?
A ke ngrenë?
Unë luaj piano tani, shiko.
Unë luaj flautin Ney, dëgjo.

LALI MICHAELI

*Cikël poetik***I dashuri im sekret, ti**

Përktheu nga anglishtja Edita Kuçi Ukaj

Lali Michaeli është poete hebreje, autore e shtatë librave me poezi. Librat e saj janë përkthyer dhe botuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusi, Gjeorgji, Francë, Rumani, Turqi, Ukrainë, Itali dhe Indi, etj.

Ndër vite, ajo ka punuar si pedagoge e gjuhës hebraike në disa universitete. Po ashtu, ajo ligjëron gjuhën dhe poezinë hebraike në Universitetin e Studimeve Ndërkombëtare të Shangait.

Ka marrë pjesë në shumë festivali të poezisë nëpër botë dhe është vlerësuar me çmime të shumta.

"Poezia e Lali Michaelit dëshmon edhe njëherë se poezia e shkëlqyer mund të jetë edhe seksi dhe novatore" – thotë shkrimtari dhe përkthyesi hebre, Dory Manor.

Ajo jeton ne Tel Aviv.

**Nuk do ta këpus gjuhën**

Fol si të duash, fol.
Edhe nëse rrugës grindemi dhe ndërpresim,
Fol.

Më dërgon një tekst
Si dikush që humb
Nacionalitetin
Varësinë.

Pa vullnet për arsye të arrakut, duke me
lejuar
Të bëj me ty ashtu si dëshiroj,
Një grua e huaj
Me ndjeshmëri të çuditshme.

Vështrimi yt,
Heqje e vështërimit tim –

Krejt kjo është konflikt.

I dashuri im sekret, ti

Një anarkist që korrekton
Gjuhën me gjuhën time

I cili nuk do t'më shoh
në vendin e tij
Të cilin s'do ta shoh
në vendin tim

Por zërat tanë rrinë pezull
Si digë në tokë

Historia jote është shkruar
Me bojë shkrimi të prodhuar

Në dashurin time

Fabrikë

Tendril

Dhe unë jam një tendril. Një perim-akrobat
i mërzhitur.
Nëse vjen nga vreshtaria jote te vreshtaria
ime

Përmes gardhit
Do ta mbushi një pije të verës heretike,
Një nga to që ti i avullon nga goja jote në
netët e shthurura
Me sy të kuq dhe pikat e farës.
E çka nëse historia jote me bishtnon? Gardhi
është shkelur.
Mos eja. Nuk do ta
Hapi për ty.

Për ju që kërkonin një gjuhë për të qarë

Prit, kam tre pula për t'i ushqyer,

Veze të freskëta për mëngjes
Dhe një hektar trishtimi për ta ajrosur.
Ti ke mbledhur objektet e përditshme
Dhe u zhvendose në shtëpinë e dikujt tjetër
Në një vend të huaj në një qetësi gjarpëruese
qe kafshon jetën.
I mbyll sytë dhe pushon në duart e një libri
që të
ëndërronte ty,
Të mori një fytyrë që nuk e njihje
Prej një vend që ende qëndron.

Dashuria e dy poetëve

Por ne ndërtuam një shtëpi,
Por ne dashuruam,
Por ne zgjodhëm vendet e luleve,
Por ne ishim të gëzuar
Dhe kryqëzuam dete
Dhe përgatitem net
Të shijshme.
Por ne ndërruam një yll,
Por ne festuam,
Por ne u merakosem
Dhe ne u ndamë
Dhe ishim xheloz
Por ne bërtitëm
Dhe u ndamë
Dhe qamë
Por u pajtuam
Dhe u ekspozuam
Dhe u fshehëm,
Por ne treguam fshehtësi,
U mallëngjyem,
Pimë,
Por ne shkruam,
Ne planifikuam,
Mbajtëm duart,
Por ne ecëm
Dhe bëmë foto
Dhe kërkuam vetminë
Por ne i dëbuam shpirtrat tanë
Dhe ishim të munduar
Por u kthyem në shtëpi në paqe,
Dhe u përqafluam
Por ne u betuam
Përgjithmonë
Por e thyem atë
Dhe kërkuam falje
Dhe fale
Por një ditë ti mbarove frymëmarrjen
Ti the të ikim
Dhe unë të tërhoqa në lëkurën tënde
Jo, jo.
Nuk kemi ku të shkojmë
Nuk kemi ku të shkojmë.

Trup dhe shpirt të mbledhur

Kthehem në rrugë pas Pilates.

Gjithë natën zemërthyer e gërvishta murin
tënd.
E pashë se e lavdërova në poezinë tënde
Gjenerozitetin e prostitutave:
Jo jo.

Gruaja e ulur në një stol mban
Një shenjë të vogël me shkrim dore të mezi
lexueshme
Duke kërkuar para për ushqim.
Kthehem
T'ia dhuroj atë që
Do ta bëj të gëzuar dhe unë nuk do të kem
mungesë.

Paraja nuk ka aromë por
Është krimi më i madh
Në historinë e njerëzimit.


Kjo intervistë është fryt i disa takimeve me Milan Kunderën në Paris në vjeshtën e vitit 1983. Takimet tona u zhvilluan në apartamentin e tij të vogël pranë Montparnassit. Punuam në dhomën e vogël që Kundera e përdor si zyrë. Me raftet plot me libra për filozofinë dhe muzikologjinë, një makinë shkrimi të modës së vjetër dhe një tavolinë, ajo duket më shumë si dhoma e një studenti sesa si studio e një autori me famë botërore. Në një nga muret, varen pranë njëra –tjetrës dy fotografi: njëra e babait, një pianist, tjetra e Leoš Janáček-ut, kompozitor çek, të cilin ai e admiron shumë. Patëm disa diskutime të lira dhe të gjata në frëngjisht; në vend të një magnetofoni, kemi përdorur një makinë shkrimi, gërshërë dhe ngjitës. Gradualisht, me copa letrash të hedhura dhe pas disa rishikimeve, u krijuar ky tekst.

Kjo intervistë u realizua menjëherë pasi libri i Kunderës, “Lehtësia e padurueshme e qenies”, ishte bërë menjëherë libër shumë i shitur. Fama e papritur e bën të mos ndihet reha.; Kundera me siguri do të pajtohej me Malcolm Lowry-n se “suksesi është si një fatkeqësi e tmerrshme, më e keqe se kur bie zjarr në shtëpinë e dikujt. Fama e rrënon shtëpinë e shpirtit”. Një herë, kur e pyeta për disa nga komentet në shtyp për romanin e tij, ai u përgjigj: “Jam ngopur me një mbidozë me veten!” Dëshira e Kunderës për të mos folur për veten duket të jetë një reagim instinktiv ndaj prirjes së shumicës së kritikëve për të studiuar shkrimtarin dhe personalitetin, politikën dhe jetën private, në vend të veprave të shkrimtarit. “Nëveria ndaj të folurit për veten është ajo që e dallon talentin romanor nga talenti lirik”, tha Kundera për Le Nouvel Observateur. Prandaj, refuzimi për të folur për veten është një mënyrë për t’i vendosur veprat dhe format letrare në qendër të vëmendjes dhe për t’u përqendruar te vetë romani. Ky është qëllimi i këtij diskutimi për artin e krijimit.

CHRISTIAN SALMON: Keni thënë se ndiheni më afër me romancierët vjenez Robert Musil dhe Hermann Broch se sa me çdo autor tjetër në letërsinë moderne. Broch mendonte ashtu si ju, se epoka e romanit psikologjik kishte marrë fund. Ai besonte, në vend të kësaj, në atë që ai e quajti romanin “polihistorik”.

MILAN KUNDERA: Musil dhe Broch e ngarkuan romanin me përgjegjësi të mëdha. E panë si sintezën sipërane intelektuale, vendin e fundit ku njeriu ende mund të vinte në dyshim botën në tërësi. Ata ishin të bindur se romani kishte fuqi të jashtëzakonshme sintetike, se mund të ishte poezi, fantazi, filozofi, aforizëm dhe ese, të gjitha në një. Në letrat e tij, Broch bën disa vëzhgime të thella për këtë çështje. Megjithatë, më duket s i bën të paqarta qëllimet e tij duke përdorur termin e keqzgjedhur “roman polihistorik”. Ishte në fakt bashkatdhetari i Broch-ut, Adalbert Stifter, një klasik i prozës austriake, i cili krijoi një roman vërtet polihistorik me *Der Nachsommer* [Vera indiane], botuar në vitin 1857. Romani është i famshëm: Nietzsche e konsideroi si një nga katër veprat më të mëdha të letërsisë gjermane. Sot është e palexueshme. Është e mbushur me informacione rreth gjeologjisë, botanikës, zoologjisë, artizanatit, pikturës dhe arkitekturës; por kjo enciklopedi gjigante, lartësuese praktikisht e lë jashtë vetë njeriun dhe gjendjen e tij. Përkundrazi, duhet të përkufizohet si “ajo që bashkon çdo mjet dhe çdo formë dijeje për të hedhur dritë mbi ekzistencën”. Po, ndihem afër një qasjeje të tillë.

Një ese e gjatë që ju botuat në revistën Le Nouvel Observateur bëri që francezët të rrezbulonin Broch-un. Ju flisni me shumë vlerësim për të, por jeni edhe kritik ndaj tij. Në fund të esesë, shkruani: “Të gjitha veprat



MILAN KUNDERA

Arti i të shkruarit roman polifonik

Intervistë për Paris Review
Përktheu Granit Zela

e mëdha (vetëm sepse janë të shkëlqyera) janë pjesërisht të paplota”.

Broch është një frymëzim për ne jo vetëm për shkak të asaj që ai arriti, por edhe për të gjitha ato që synonte dhe nuk mundi të arrinte. Vetë paplotësia e veprës së tij mund të na ndihmojë të kuptojmë nevojën për forma të reja arti, duke përfshirë: 1. një zhveshje radikale nga gjërat e panevojshme (në mënyrë që të kapim ndërlukueshmërinë e ekzistencës në botën moderne pa humbje të qartësisë arkitektonike); 2. Një “kontrapunkt romanor” (për të bashkuar filozofinë, narrativën dhe ëndrrën në një muzikë të vetme); 3. eseja në mënyrë specifike romanore (me fjalë të tjera, në vend që të mëtohet të përçojë një mesazh të pakundërshtueshëm, të mbetet hipotetike, lojcake ose ironike).

Këto tre pika duket se rrokin të gjithë programin tuaj artistik.

Për ta shndërruar romanin në një ndriçim polihistorik të ekzistencës, duhet të zotërosh teknikën e elipsës, artin e kondensimit. Përndryshe, bie në grackën e gjatësisë së pafund. “Njeriu pa cilësi” i Musilit është një nga dy ose tre romanet që më pëlqejnë më shumë. Por mos më kërkoni të admiroj hapësirën e saj gjigante të papërfunduar! Imagjinoni një kështjellë kaq të madhe sa syri nuk mund t’i rrok të gjitha me një shikim. Imagjinoni një kuartet harqesh që zgjat nëntë orë. Ka kufij antropologjikë - përmasa njerëzore - që nuk duhen shkelur, siç janë kufijtë e kujtesës. Kur të kesh mbaruar së lexuari, duhet të jesh ende në gjendje të mbash mend fillimin. Nëse jo, romani humbet formën e tij, “qartësia e tij arkitektonike” bëhet e errët.

“Libri i të qeshurit dhe harresës” përbëhet nga shtatë pjesë. Nëse do t’i kishit trajtuar në një mënyrë më pak eliptike, mund të kishit shkruar shtatë romane të ndryshme me gjatësi të plotë.

Por nëse do të kisha shkruar shtatë romane të pavarura, do të kisha humbur gjënë më të rëndësishme: nuk do të kisha qenë në gjendje të kapja “ndërlukueshmërinë e ekzistencës njerëzore në botën moderne” në një libër të vetëm. Arti i elipsës është absolutisht thelbësor. Kërkon që njeriu të shkojë gjithmonë drejtpërdrejt në thelbin e

gjërave. Në lidhje me këtë, gjithmonë mendoj për një kompozitor çek që e kam admiruar me pasion që nga fëmijëria: Leoš Janáček-un. Është një nga mjeshtrit më të mëdhenj të muzikës moderne. Vendosmëria e tij për të zhveshur muzikën në thelbin e saj ishte revolucionare. Sigurisht, çdo kompozim muzikor përfshin një pjesë të madhe të teknikës: ekspozimin e temave, zhvillimin e tyre, variacionet, punën polifonike (shpesh shumë automatike), plotësimin e orkestrimit, kalimet etj. Sot mund të kompozohet muzikë me një kompjuter, por kompjuteri ka ekzistuar gjithmonë në kokat e kompozitorëve - nëse do të duhej, kompozitorët mund të shkruanin sonata pa një ide të vetme origjinale, thjesht duke u zgjeruar në mënyrë “kibernetike” mbi rregullat e kompozimit. Qëllimi i Janáček-ut ishte të shkatërronte këtë kompjuter! Krahasimi brutal në vend të kalimit; përsëritje në vend të variacionit, dhe gjithmonë drejt e në zemër: vetëm nota me diçka thelbësore për të thënë ka të drejtë të ekzistojë. Është pothuajse e njëjta gjë me romanin; edhe ai është i rënduar nga “teknika”, nga rregullat që bëjnë punën e autorit për të: paraqitni një personazh, përshkruani një mjedis, sillni veprimin në mjedisin e tij historik, mbushni jetën e personazheve me episode të kota. Çdo ndryshim i skenës kërkon ekspozime, përshkrime, shpjegime të reja. Qëllimi im është si ai i Janáček-ut: të shpëtoj romanin nga automatizmi i teknikës, dhe nga tjerria e fjalëve.

Forma e dytë e artit që përmendët ishte “kontrapunti romanor”.

Ideja e romanit si një sintezë e madhe intelektuale ngre pothuajse automatikisht problemin e “polifonisë”. Ky problem duhet të zgjidhet. Merrni pjesën e tretë të romanit të Broch “Somnambulët”; përbëhet nga pesë elementë heterogjenë: 1. rrëfim “romanor” i mbështetur në tre personazhet kryesore: Pasenow, Esch, Huguenau; (2) historia personale e Hanna Wendling-ut; (3) përshkrim faktik i jetës në një spital ushtarak; (4) një tregim (pjesërisht në vargje) i një vajze protestante të “Ushtirisë së shpëtimit”; (5) një ese filozofike (e shkruar në gjuhë shkencore) për zhdukjen e vlerave. Çdo pjesë është madhështore. Megjithatë, përkundër faktit

se të gjitha trajtohen njëkohësisht, në një alternim të vazhdueshëm (me fjalë të tjera, në një mënyrë polifonike), pesë elementët mbeten të pabashkuar - me fjalë të tjera, ato nuk përbëjnë një polifoni të vërtetë.

Duke përdorur metaforën e polifonisë dhe duke e zbatuar në letërsi, a nuk i parashtroi para romanit kritere që ai në fakt nuk mund t’i përmbushë?

Romani mund të përfshijë elementë të jashtëm në dy mënyra. Gjatë udhëtimeve të tij, Don Kishoti takon personazhe të ndryshëm që i tregojnë përrallat e tyre. Në këtë mënyrë, tregimet e pavarura futen në tërësi, futen në kornizën e romanit. Ky lloj kompozimi gjendet shpesh në romanet e shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë. Broch, megjithatë, në vend që ta përshtasë historinë e Hanna Wendling-ut në historinë kryesore të Esch dhe Huguenau, i lë të dyja të shpalosen njëkohësisht. Sartri (në “Pritja”), dhe Dos Pasosi para tij, përdorën gjithashtu këtë teknikë të njëkohshmërisë. Megjithatë, synimi i tyre ishte të bashkonin histori të ndryshme romanore, me fjalë të tjera, elemente homogjene dhe jo heterogjene si në rastin e Broch-ut. Për më tepër, përdorimi i tyre i kësaj teknike më duket shumë mekanik dhe pa poezi. Nuk mund të mendoj për terma më të mirë se “polifonia” ose “kontrapunkti” për të përshkruar këtë formë kompozimi dhe, për më tepër, analogjia muzikore është e dobishme. Për shembull, gjëja e parë që më shqetëson për pjesën e tretë të “Somnambulët” është se pesë elementët nuk janë të gjithë të barabartë. Ndërsa barazia e të gjithë zërave në kontrapunkt muzikor është rregulli bazë themelor, sine qua non. Në veprën e Broch-ut, elementi i parë (rrëfimi romanor i Esch-it dhe Huguenaut-it) zë shumë më tepër hapësirë fizike sesa elementët e tjerë dhe, edhe më e rëndësishmja, është i privilegjuar për aq sa lidhet me dy pjesët e mëparshme të romanit dhe prandaj merr përsipër detyrën e unifikimit të tij. Prandaj tërheq më shumë vëmendje dhe kërcënon t’i kthejë elementët e tjerë në element thjesht shoqëruar. Gjëja e dytë që më shqetëson është se megjithëse një fugë e Bahut nuk mund të bëjë pa as edhe njërin prej zërave të saj, historia e Hanna Wendling-ut ose eseja për zhdukjen e vlerave mund të qëndrojnë shumë mirë si një vepër e pavarur. Veçmas, ato nuk do të humbnin asgjë nga kuptimi apo cilësia e tyre.

Sipas mendimit tim, kërkesat themelore të kontrapuntit romanor janë: 1. barazia e elementeve të ndryshme; 2. pandashmëria e së tërës. Mbaj mend që ditën kur mbarova “Engjëjt”, pjesa e tretë e “Librit i të qeshurit dhe harresës”, isha shumë krenar për veten. Isha i sigurt se kisha zbuluar çelësin e një mënyre të re për të bashkuar një rrëfim. Teksti përbëhej nga elementët e mëposhtëm: 1. një histori për dy studente dhe ngritjen e tyre në lartësi; 2. një rrëfim autobiografik; 3. një ese kritike mbi një libër feminist; 4. një përrallë për një engjëll dhe djall; 5. një rrëfim ëndëror i Paul Eluard-it duke fluturuar mbi Pragë. Asnjë nga këta elementë nuk mund të ekzistonte pa të tjerët, secili ndriçon dhe shpjegon të tjerët ndërsa të gjithë eksplorojnë një temë të vetme dhe bëjnë një pyetje të vetme: “Çfarë është një engjëll?”

Pjesa e gjashtë, e titulluar gjithashtu “Engjëjt”, përbëhet nga: 1. një rrëfim ëndëror i vdekjes së Taminës; 2. një rrëfim autobiografik i vdekjes së babait tim; 3. reflektimet muzikologjike; 4. reflektime mbi epideminë e harresës që po shkatërron Pragën. Cila është lidhja midis babait tim dhe torturimit të Taminës nga fëmijët? Është “takimi i një makine qepëse dhe një ombrellë” në tryezën e një teme, po të huazojmë imazhin e famshëm të Lautréamont-it. Polifonia e romanit është poezi shumë më tepër se teknikë. Nuk mund të gjej asnjë shembull të një poezie të tillë polifonike gjetkë në letërsi, por jam habitur shumë nga filmat e fundit të Alain Resnais-it. Përdorimi i tij i artit të kontrapunktit është i admirueshëm.

(Vijon në faqen 22)

(Vijon nga faqja 21)

Kontrapunkti është më pak i dukshëm në “Lehtësia e padurueshme e qenies”.

Ky ishte qëllimi im. Doja që ëndrra, rrëfimi dhe reflektimi të rrjedhin së bashku në një rrjedhë të pandashme dhe krejtësisht të natyrshme. Por karakteri polifonik i romanit është shumë i mrekullueshëm në pjesën e gjashtë: historia e djalit të Stalinit, reflektimet teologjike, një ngjarje politike në Azi, vdekja e Franzit në Bangkok dhe funerali i Tomasit në Bohemi janë të gjitha të lidhura me të njëjtën pyetje të përrjetshme: “Çfarë është kicë?” Ku udhëtim polifonik është shtylla ku mbështetet e gjithë struktura e romanit. Është çelësi i sekretit të arkitekturës së saj.

Duke e quajtur “një ese posaçërisht romanore”, keni shprehur disa rezerva në lidhje me esenë mbi zhukjen e vlerave të “Somnambulët”.

Është një ese e mrekullueshme!

Ju keni dyshime për mënyrën se si është përfshirë në roman. Broch-u nuk heq dorë nga nga gjuha e tij shkencore, i shpreh pikëpamjet në një mënyrë të drejtpërdrejtë pa u fshehur pas personazheve – siç do të bënin Man ose Musil. A nuk është ky kontributi i vërtetë i Broch, sfida e tij e re?

Kjo është e vërtetë dhe ai ishte i vetëdijshëm për guximin e treguar. Por ka edhe një rrezik: esesa mund të lexohet dhe kuptohet si çelësi ideologjik i romanit, si “e vërteta” e tij, dhe kjo mund ta shndërrojë pjesën tjetër të romanit në një ilustrim të thjeshtë të një mendimi. Atëherë ekuilibri i romanit prishet; e vërteta e esesë bëhet shumë e rëndë dhe arkitektura delikate e romanit rrezikon të shembet. Një roman që nuk kishte ndërmend të shprehte një tezë filozofike (Broch e urrente atë lloj romani!) mund të përfundojë duke u lexuar pikërisht në atë mënyrë. Si mund të përfshihet një ese në roman? Është e rëndësishme të kemi parasysh një fakt themelor: vetë thelbi i reflektimit ndryshon në momentin kur përfshihet në trupin e një romani. Jashtë romanit, njeriu është në sferën e pohimeve: filozofi, politikani, recepsionisti është i sigurt për atë që thotë. Megjithatë, romani është një territor ku nuk bëhen pohime; është një territor loje dhe hipotezash. Reflektimi brenda romanit është hipotetik nga vetë thelbi i tij.

Por pse një romancier do të donte t’i privonte vetes të drejtën për të shprehur hapur dhe me vendosmëri filozofinë e tij në romanin e vet?

Sepse ai nuk ka asnjë filozofi! Njerëzit shpesh flasin për filozofinë e Çehovit, ose të Kafkës, ose të Musilit. Por thjesht përpikuni të gjeni një filozofi koherente në shkrimet e tyre! Edhe kur shprehin idetë e tyre në blloqet e shënimeve, idetë janë më shumë ushtrime intelektuale, lojëra me paradokse ose improvizime sesa pohime të një filozofie. Dhe filozofët që shkruajnë romane nuk janë gjë tjetër veçse pseudoromancier që përdorin formën e romanit për të ilustruar idetë e tyre. As Voltaire e as Camus nuk e zbuluan kurrë “atë që vetëm romani mund ta zbulojë”. Unë di vetëm një përjashtim, dhe ai është Diderot i “Zhak fatalistit”. Çfarë mrekullie! Pasi ka kaluar kufirin e romanit, filozofi serioz bëhet një mendimtar lojçak. Nuk ka asnjë fjali serioze në roman - gjithçka në të është lojë. Kjo është arsyeja pse ky roman është nënvlerësuar jashtëzakonisht shumë në Francë. Në të vërtetë, “Zhak fatalisti” përmban gjithçka që Franca ka humbur dhe refuzon të rigjejë. Në Francë, idetë parapëlqehen sesa veprat. “Zhak fatalisti” nuk mund të përkthehet në gjuhën e ideve, prandaj nuk mund të kuptohet në atdheun e ideve.

Te “Shakaja”, është Jaroslavi ai që zhvillon një teori muzikologjike. Karakteri hipotetik i të menduarit të tij është i dukshëm. Por meditimet muzikologjike te “Libri i të qeshurit dhe harresës” janë të autorit, tuajat. Si mund të kuptoj atëherë nëse ato janë hipotetike apo pohuese?

E gjitha varet nga toni. Që në fjalët e para, synimi im është t’u jap këtyre reflektimeve një ton lojçak, ironik, provokues, eksperimental ose pyetës. E gjithë pjesa e gjashtë e “Lehtësia e padurueshme e qenies” (“Marshi i madh”) është një ese mbi kicin, i cili shpjegon një tezë kryesore: kicë është mohimi absolut i ekzistencës së të ndyrës. Ky meditim mbi kicin është i një rëndësie jetike për mua. Ai mbështetet në një pjesë të madhe të mendimit, përvojës, studimit dhe madje edhe pasionit. Megjithatë toni nuk është kurrë serioz; është provokues. Kjo ese është e paimagjinueshme jashtë romanit, është një meditim thjesht romanor.

Polifonia e romaneve tuaja përfshin edhe një element tjetër, narrativën ëndërrorë. Ai përfshin të gjithë pjesën e dytë të “Jeta është gjetkë”, është baza e pjesës së gjashtë të “Libri i të qeshurës dhe harresës” dhe kalon përmes “Lehtësisë së padurueshme të qenies” përmes ëndrrave të Terezës.

Këto pjesë janë gjithashtu më të lehtat për t’u keqkuptuar, sepse njerëzit duan të gjejnë një mesazh simbolik në to. Nuk ka asgjë për të deshifruar në ëndrrat e Terezës. Janë poezi për vdekjen. Kuptimi i tyre qëndron në bukurinë e tyre, e cila e hipnotizon Terezën. Meqë ra fjala, a e kuptoni se njerëzit nuk dinë ta lexojnë Kafkën thjesht sepse duan ta deshifrojnë? Në vend që ta lënë veten të magjepsen nga imagjinata e tij e pashoqe, ata kërkojnë alegori dhe nuk nxjerrin asgjë tjetër veç klishe: jeta është absurde (ose nuk është absurde), Zoti është i paarritshëm (ose i arritshëm), etj. Nuk mund të kuptosh asgjë për artin, veçanërisht artin modern, nëse nuk kupton se imagjinata është një vlerë më vete. Novalisi e dinte këtë kur lavdëronte ëndrrat. Ato “na mbrojnë nga monotonia e jetës”, tha ai, “na çlirojnë nga serioziteti me kënaqësinë e lojërave të tyre”. Ishte i pari që kuptoi rolin që mund të luain ëndrrat dhe një imagjinatë ëndërrimtare në roman. Ai kishte plan të shkruante vëllimin e dytë të Heinrich von Ofterdingen-it tsi një

rrëfim në të cilin ëndrra dhe realiteti do të ishin aq të ndërthurura sa nuk do të ishte më në gjendje t’i dallonte. Fatkeqësisht, gjithçka që ka mbetur nga ai vëllim i dytë janë shënimet në të cilat Novalisi përshkruan qëllimin e tij estetik. Njëqind vjet më vonë, ambicia e tij u përmbush nga Kafka. Romanet e Kafkës janë një shkrimje e ëndrrës dhe realitetit; domethënë nuk janë as ëndërr e as realitet. Më shumë se çdo gjë, Kafka bëri një revolucion estetik. Një mrekulli estetike. Sigurisht, askush nuk mund ta përsërisë atë që ai bëri. Por unë ndaj me të, dhe me Novalisin, dëshirën për të sjellë ëndrrat dhe imagjinatën e ëndrrave në roman. Mënyra ime për ta bërë këtë është me përballje polifonike dhe më shumë se sa me një shkrimje të ëndrrës dhe realitetit. Rrëfimi i ëndrrave është një nga elementët e kontrapunkteve.

Nuk ka asgjë polifonike në pjesën e fundit të “Librit i të qeshurës dhe harresës”, dhe megjithatë kjo është ndoshta pjesa më interesante e librit. Ai përbëhet nga katërmbëdhjetë kapituj që tregojnë situata erotike në jetën e një njeriu.

Një tjetër term muzikor: ky rrëfim është një “temë me variacione”. Tema është kufiri përtej të cilit gjërat humbasin kuptimin e tyre. Jeta jonë shpалoset në afërsi të atij kufiri dhe ne rrezikojmë ta kalojmë atë në çdo moment. Katërmbëdhjetë kapitujt janë katërmbëdhjetë variacione të erotizmit të së njëjtës situatë në kufirin mes kuptimit dhe pakuptimësisë.

Ju e keni përshkruar “Librin i të qeshurës dhe harresës” si një “roman në formën e variacioneve”. Por a është ende një roman?

Nuk ka unitet veprimi, prandaj nuk duket si një roman. Njerëzit nuk mund ta imagjinojnë një roman pa unitet. Edhe eksperimentet e romanit të ri mbështeteshin në unitetin e veprimit (ose të mosveprimit). Sterne dhe Diderot u argëtuan duke e bërë unitetin jashtëzakonisht të brishtë. Udhëtimi i Zhakut dhe të zotit përfshin pjesën më të vogël të “Zhak fatalistit”; nuk është gjë tjetër


veçse një pretekst komik për të përfshirë anekdota, histori, mendime. Megjithatë, ky pretekst, kjo “kornizë” është e nevojshme për ta bërë romanin të ndihet si një roman. Në “Libri i të qeshurës dhe harresës” nuk ka më asnjë pretekst të tillë. Është uniteti i temave dhe variacioneve të tyre që krijon vijimësi të së tërës. A është roman? Po. Një roman është një meditim mbi ekzistencën, i parë përmes personazheve imagjinarë. Forma është liri e pakufizuar. Gjatë gjithë historisë së tij, romani nuk ka ditur kurrë të përfitojë nga mundësitë e tij të pafundme. E humbi shansin.

Por përveç “Libri i të qeshurës dhe harresës”, romanet tuaja mbështeten edhe në unitetin e veprimit, megjithëse është i një larmie shumë më të çlirët në “Lehtësia e padurueshme e qenies”.

Po, por llojet e tjera më të rëndësishme të unitetit i plotësojnë ato: uniteti i të njëjtave pyetje metafizike, të të njëjtave motive dhe më pas variacione (motivi i atësisë në “Festa e lamtumirës”, për shembull). Por do të doja të theksoja para së gjithash se romani është kujuar kryesisht duke u mbështetur në një numër fjalësh themelore, si seria e shënimeve të Schoenberg-ut. Në “Librin e të qeshurës dhe harresës”, seria është si vijon: harresa, e qeshura, engjëjt, pengu, kufiri. Në rrjedhën e romanit këto pesë fjalë kyçe analizohen, studiohen, përcaktohen, ripërcaktohen dhe shndërrohen në kategori të ekzistencës. Ajo është ndërtuar mbi këto pak kategori në të njëjtën mënyrë si një shtëpi është ndërtuar mbi kolonat e saj. Kolonat e “Lehtësia e padurueshme e qenies” janë: pesha, lehtësia, shpirti, trupi, Marshi i Madh, ndyrësia, kicë, dhembshuria, marramendja, forca dhe dobësia. Për shkak të karakterit të tyre kategorizues, këto fjalë nuk mund të zëvendësohen me sinonime. Kjo gjithmonë duhet t’u shpjegohet vazhdimisht përkthyesve, të cilët – në shqetësimin e tyre për “stilin e mirë” – përpiqen të shmangin përsëritjen.

Për sa i përket qartësisë arkitekturore, më bëri përshtypje fakti që të gjitha romanet tuaja, përveç njërit, janë të ndarë në shtatë pjesë.

Kur mbarova romanin tim të parë, “Shakaja”, nuk kishte pse të habitesha që kishte shtatë pjesë. Pastaj shkrova “Jeta është gjetkë”. Romani ishte pothuajse i mbaruar dhe kishte gjashtë pjesë. Nuk u ndjeva i kënaqur. Papritur më lindi ideja të përfshija një histori që zhvillohet tre vjet pas vdekjes së heroit - me fjalë të tjera, jashtë kornizës kohore të romanit. Kjo tani u bë pjesa e gjashtë e shtatë, e titulluar: “Njeriu i moshës së mesme”. Menjëherë, arkitektura e romanit ishte bërë e përsosur. Më vonë, kuptova se kjo pjesë e gjashtë ishte çuditërisht analoge me pjesën e gjashtë të *Shakasë* (“Kostka”), e cila gjithashtu paraqet një personazh të jashtëm dhe gjithashtu hap një dritare të fshehtë në murin e romanit. “Dashuritë gazmore” nisën si dhjetë tregime të shkurtra. Duke bashkuar versionin përfundimtar, hoqa tre prej tyre. Përmbledhja ishte bërë shumë koherente, duke paralajmëruar përbërjen e “Librit të së qeshurës dhe harresës”. Një personazh, Doktor Havel, lidh historinë e katërt dhe të gjashtë. Në “Libri i të qeshurës dhe harresës, pjesa e katërt dhe e gjashtë lidhen gjithashtu nga i njëjti person: Tamina. Kur shkrova “Lehtësia e padurueshme e qenies”, isha i vendosur të thyeja magjinë e numrit shtatë. Prej kohësh kisha vendosur për një skicë me gjashtë pjesë. Por pjesa e parë më dukej gjithmonë si pa formë. Më në fund, kuptova se ishte me të vërtetë i përbërë nga dy pjesë. Ashtu si binjakët siamezë, ata duhej të ndaheshin me një operacion delikat. Arsyeja e vetme që i përmend të gjitha këto është për të treguar se nuk jam duke u dhënë pas ndonjë prirjeje besëtyte për numrat magjikë, dhe as duke bërë një llogaritje racionale. Përkundrazi, më shtyn një nevojë e thellë, e pavetëdijshme, e pakuptueshme, një arketip formal nga i cili nuk mund të shpëtoj. Të gjitha romanet e mia janë variante të një arkitekture të mbështetur në numrin shtatë.



Përdorimi i shtatë pjesëve të ndara mjeshtërisht lidhet sigurisht me qëllimin tuaj për të sintetizuar elementët më heterogjenë në një tërësi të unifikuar. Çdo pjesë e romanit është gjithmonë një botë më vete dhe e dallueshme nga të tjerat për shkak të formës së veçantë. Por nëse romani ndahet në pjesë me numra, pse duhet të ndahen edhe vetë pjesët në kapituj me numra?

Vetë kapitujt duhet gjithashtu të krijojnë një botë të vogël të tyre; ato duhet të jenë relativisht të pavarur. Kjo është arsyeja pse unë vazhdoj t'i shqetësoj botuesit e mi për t'u siguruar që numrat janë qartë të dukshëm dhe se kapitujt janë të ndarë mirë. Kapitujt janë si masat e një partiture muzikore! Ka pjesë ku masat (kapitujt) janë të gjata, të tjera ku janë të shkurtra, të tjera ku janë me gjatësi të çrregullt. Çdo pjesë mund të ketë një tregues të ritmit muzikor: moderato, presto, andante, etj. Pjesa e gjashtë e “Jeta është gjetkë” është andante: në një mënyrë të qetë dhe melankolike, ajo tregon për takimin e shkurtër mes një mesoburri dhe një vajze të re që sapo ka dalë nga burgu. Pjesa e fundit është prestissimo; është shkruar në kapituj shumë të shkurtër dhe kalon nga Jaromili që po vdes te Rimbaud, Lermontovi dhe Pushkini. Fillimisht mendova për “Lehtësinë e padurueshme të qenies” në një mënyrë muzikore. E dija që pjesa e fundit duhej të ishte pianissimo dhe lento: përqendrohet në një periudhë mjaft të shkurtër, pa ngjarje, në një vend të vetëm dhe toni është i qetë. E dija edhe u se kësaj pjesë duhej t'i paraprinte një prestisimo: kjo është pjesa e titulluar “Marshi i madh”.

Ekziston një përjashtim nga rregulli i numrit shtatë. Ka vetëm pesë pjesë në “Festa e lamtumirës”.

“Festa e lamtumirës” mbështetet në një arketip tjetër formal: është absolutisht homogjen, trajton një temë, tregohet në një ritëm; është shumë teatral, i stilizuar dhe e merr formën nga farsa. Te “Dashuritë gazmore”, tregimi i titulluar “Simpoziumi” është ndërtuar saktësisht në të njëjtën mënyrë - një farsë në pesë akte.

Çfarë kuptoni me farsë?

E kam fjalën për theksimin e subjektit dhe para së gjithash rastësitë e papritura dhe të pabesueshme. Asgjë nuk është bërë aq e dyshimtë, qesharake, e modës së vjetër, e zakonshme dhe pa shije në një roman sa subjekti dhe teprimet e farsës. Që nga Floberi e më pas, romancierët janë përpjekur të heqin dorë nga artificet e subjektit. Dhe kështu romani është bërë më i mërzitshëm se jeta më e mërzitshme. Megjithatë, ekziston një mënyrë tjetër për të kapërcyer aspektin e dyshuar dhe të rraskapitur të subjektit, dhe kjo është ta çlirosh nga kërkesa e gjasave që të ketë ndodhur. Ti tregon një histori të pamundur që zgjedh të jetë e pamundur! Pikërisht kështu e konceptoi Kafka “Amerikën”. Mënyra se si Karli takohet me xhaxhain e tij në kreun e parë ndodh përmes një vargu rastësish më të pamundshme. Kafka hyri në universin e tij të parë “surreal”, në “bashkimin e tij të parë të ëndrrës dhe realitetit”, me një parodi të subjektit, përmes derës së farsës.

Por pse zgjodhët formën e farsës për një roman që nuk synon aspak të jetë argëtues?

Por është argëtues! Nuk e kuptoj përbuzjen që kanë francezët për argëtimin, pse u vjen kaq turp nga fjala “divertissement”. Ata rrezikojnë më pak të jenë argëtues sesa të mërzitshëm. Dhe rrezikojnë edhe të venë pas kicit, atij zbukurimi të ëmbël, gënjeshtar të gjërave, dritës ngjyrë trëndafil që lanë edhe vepra të tilla moderniste si poezia e Eluard-it apo filmi i fundit i Ettore Scola-s “Le Bal”, nëntitulli i të cilit mund të jetë: “Historia franceze si kic”. Po, kici, jo argëtimi, është sëmundja e vërtetë estetike! Romani i madh evropian filloi si argëtim dhe çdo romancier i vërtetë është nostalgjik për të. Në fakt, temat e atyre argëtimeve të shkëlqyera janë tmerrësisht serioze, mendoni për Servantesin! Në “Festa e lamtumirës”, pyetja është, a e meriton njeriu të jetojë në këtë tokë? A nuk duhet “të çlirojë planetin nga kthetrat e njeriut”? Ambicia ime e jetës ka qenë të bashkoj seriozitetin më të madh të pyetjes me lehtësinë më të madhe të formës. As kjo nuk është një thjesht ambicie artistike. Kombinimi i një forme joserioze dhe një teme serioze demaskon menjëherë të vërtetën për dramën tona (ato që ndodhin në shtretërit tanë si dhe ato që luajmë në skenën e madhe të Historisë) dhe parëndësinë e tyre të tmerrshme. Ne përjetojmë lehtësinë e padurueshme të qenies.

Pra, ju mund ta kishit përdorur po aq mirë titullin e romanit tuaj të fundit për “Festa e lamtumirës”?

Secili nga romanet e mia mund të titullohet “Lehtësia e padurueshme e qenies” ose “Shakaja” ose “Dashuri gazmore”; titujt janë të këmbyeshëm, pasqyrojnë numrin e vogël të temave pas të cilave jam i dhënë, më përcaktojnë dhe, për fat të keq, më kufizojnë. Përtej këtyre temave, nuk kam asgjë tjetër për të thënë apo për të shkruar.

Ka, atëherë, dy arketipe formale kompozimi në romanet tuaja: 1. polifonia, e cila bashkon elemente heterogjene në një arkitekturë të mbështetur në numrin shtatë; 2. farsa, e cila është homogjene, teatrale dhe e pagjasë. A mund të ketë një Kundera jashtë këtyre dy arketipeve?

Unë gjithmonë ëndërroj për një pabesi të madhe të papritur ndaj tyre. Por ende nuk kam mundur t'i shpëtoj gjendjes sime bigame.



Poezi nga
Shqiponja Axhami

Qyteti fle
si elefant i lodhur;
ti e di sa kam dashur t'i njoh elefantët,
por kurrë s'i njoha:
vështrimi im i uritur u tejngop
me kukulla të hirta
që m'i qepte ime më
me fustanin e saj të vjetër.
Shshshtttt, mos fol,
karboni i lapsit damkoste në buzë
një formë ylli xhuxh,
duke pikturuar në fletore
gjithmonë kokën e një mbretëreshë;
tani ato fletushka flenë
nën qeramikë tjegullash,
fosilet e të cilave
më kujtojnë sytë e të vdekurve..

Baba,
shuahe tani çibukun e më shih:
ti e di që e dua Zotin,
që e urrej deri në dashuri...

Më ndje, Baba,
ndjej të të them
se ke bërë mirë që ke vdekur,
ndryshe s'do kisha
si të shfajësohesha para teje.
Beso, i fundmi i Pellazgëve
me del çdo natë në ëndërr
duke më lyer fytyrën
me kreshtë të një fisi të huaj,
që më thotë: “vdekja është shpëtim”;
unë zgjohe më ankh duke bërtitur;
mbi gjoks më rrjedhin dy pika djerse
si sy kukuvajke.

Kridhem si thupra e tutorit
mbi shpinën e skllavit
dhe shoh rreth meje
gjëmën e rradhës.

Por s'ka radhë, baba.
Besomë,
asnjëherë s'ka radhë;
ka vetëm rastësi.
Tatimorët këtë herë janë bërë të vrazhdë...
Po bëhemi shtet, baba,
e shtetet janë të rreptë,
popujt janë të butë, por të pabindur.
Kështu funksionon e tëra:
epërsia e të kundërtave në një revoltë
në udhnajë...përmes pemëve ...
Ekuilibri në ikje
është i pamëshirshëm.

Në gravurën ku kishim shtëpinë e vjetër,
po ndërtohet një uzinë riciklimi baba;
në kohën e sodit edhe plehrat kanë vlera,
kurse lumin tënd të shtrenjtë
anash të cilit lexoje
“Nën terrorin nazist”

e kanë mbushur qentë e ngordhur;
vijnë nga të gjitha fshatrat,
ka dhe foshnja dymuajshe aty.
Janë shtuar kurvat...
po, po, mos qesh baba:
kam filluar edhe unë të flas fjalë të pista;
duhet të jesh pak i pistë, baba,
ndryshe nuk je imum...

Kodrinën me ullinj, në fund të qyetit, e dogjën:
ishte mbjellë me marihuanë.
Populli ynë s'ka para të blejë mariohanë, baba,
por populli ynë është naiv,
mashtrohet së fëmijë cigani pas monedhës;
e sa për ne, baba,
ne jemi statuja bio të një sistemi hormonal:
s'dimë më as të dashurojmë, as të urrejmë.

Mos u trishto, baba,
të thërras shpesh në netët e brymta
ku dhomat tona kthehen në kërpudha
dhe na duhet një qasje prej begonje
që ta presim mëngjesin.
Por jemi, baba,
akoma flirtet e tua
poshtë atllasin të kuq
të të vetmit jorgan që kishe;
me gotën e vogël të rakisë së kumbullës
dhe me mezen e varfër....
dhe si duket kemi akoma
pakëz “Ti” përbrenda
që na lëvrin si krimb
mëndafshi mbi pëlthurë;
zbret mbi këtë natë të brymtë
një fjollëz malli
dhe bindemi, që e gjitha kjo rrrëmujë
e ka dhe të bukurën:
mjafton ta duash dhe rastësinë.

Dhe rastësisht edhe këtë natë frymoj.
Pambuku i jastëkut bëhet deve,
më çon në lëndinë e virgjër
ku palma s'do t'ia dijë për druvarët,
ku fletushka ime me kokë mbretëreshë
vjen nga një frymë e marrë,
për të mbretëruar vetëm një çast Sherezadeje...

Shko tani, Baba.... Ferri ose Parajasa jote
janë, padyshim, dy guacke arre
dhe gishtëza - ai Zot që ti kurrë s'e besove -
do të të bëjë pak vend....
Shko, s'do të qaj,
u bë kohë që s'di të qaj,
di vetëm të vështroj si fajkua
gjahun e huaj. Shko, merre me vete
këngën e krisur që nisi cigani.
Po shtrihem...
Në luginën ku xhelatët e një arsyeje të dehur
i zë gjumi siltës i bindjes;
kushedi, në ndonjë ëndërr mashtruese
do ta gdhend drurin e një Harpe.

Karikaturë nga Arben Mexsi

